

Procesverbal

Nga mbledhja e II - (dytë) e rregullt e Kuvendit Komunal në Dragash, e mbajtur më datë: 02.03.2023 dhe 03.03.2023

Rend Dite

- 1) Miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,
- 2) Vendim për barjten e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023,
- 3) Raporti i Punës së KKSB-së për 6 mujorin e II-të 2022,
- 4) Raporti i Punës së Ekzekutivit për vitin 2022 dhe Plani i Punës për vitin 2023, dhe
- 5) Eventuale.

Uran Halimi: Të nderuar delegatë, mirë se keni ardhë në mbledhjen e dytë të rregullt për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës së Dragashit, ku njëherit është propozuar ky rend dite, e keni pas edhe në materiale të cilat janë servue nga shërbimi i Kuvendit; në pikë të parë e kemi miratimin e procesverbalit nga seanca e kaluar, pika e dytë e rendit të ditës parasheh vendimin për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023, pika e tretë është Raporti i Punës së KKSB-së për gjashtëmujorin e dytë për vitin 2022, pika e katërt me radhë ka të bëjë me Raportin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2022 dhe Planin e Punës për vitin 2023, dhe e fundit është eventuale.

Përpara se ta hedhim në votim, unë ju ftoj që nëse keni nevojë me e marrë fjalën edhe me diskutue diçka në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës. Fjalën e ka kërkue zoti Nedzmidin Sejdilar nga Pokret za Gora.

Nedzmidin Sejdilar: Përshëndetje të gjithëve, dua t'ju pyes dy gjëra, e para ka të bëjë me raportin dhe me këtë vendim për transferimin e mjeteve vetanaka. Materiali që kemi marrë në formë fizike dhe ky material që kemi në formë elektronike nuk përputhen. Nuk e di se cilin t'i ndjek këta të dy. Edhe ky ne tavolin nuk janë të njëjta. Kërkoj që kjo pikë të shtyhet për në seancën e ardhshme. Materialet e raportit te organet ekzekutive e kemi marrë nga drejtorë dhe janë 177 faqe, pyes veten se kur do të raportojnë drejtorët dhe kryetari, nëse do t'i vendosim të gjitha këto në një pikë. A ka delegati kohë të mjaftueshme për të diskutuar dhe komentuar për punën e organeve ekzekutive në vetëm 10 minuta.

Uran Halimi: Faleminderit, zotëri Sejdilar! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën. Atëherë i kemi dy propozime, ni propozim për shtyrjen e këtyre dy pikave të rendit të ditës, e hedhim në votim propozimin e zotit Sejdilar...po, unë ju pyeta për atë.

Shpetim Hajredini: Përshëndetje për të gjithë pjesëmarrësit! Unë personalisht, edhe po besoj të gjithë kolegët e PDK-së e mbështesin propozimin tim, nuk kisha thonë që të bëhet shtyrje komplet e pikës së katërt siç propozoi kolega ma herët. Kisha propozue që ta bëjmë ni ndarje, nëse është e mundshme, ligjërisht nuk besoj që paraqet problem dhe ne mund të vendosim për një pjesë të drejtorive apo ta ndajmë Raportin dhe Planin e Punës, ta kemi në këtë seancë raportin e në seancën e ardhshme Planin e Punës ndarazi, që të kemi mundësi të diskutojmë pak më gjerësisht, pasi që është shumë i rëndësishëm. Prandaj unë propozoj që të bëhet ndarja. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, zoti Hajredini! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën. Fjalën e ka kërkuar zoti Samidin Xheladini.

Samidin Xheladini: Të nderuar të pranishëm, ju përshëndes të gjithëve! Edhe unë mendoj se duhet të ndahet Plani me Raportin, për shkak se është ni material voluminoz, mbi 138 faqe, dhe duhet të trajtohet ndaras. A do ta trajtojmë sot apo në mbledhje të ardhshme, na mund të merremi vesh, po në bazë të përvojës të mëhershme, gjithnjë e kemi trajtue Plani e Punës edhe Raportin me të njëjtën mbledhje, mund ta ndajmë edhe sot t'i trajtomë të dyjat. Faleminderit!

Uran Halimi: Falemindertit, zoti Xheladini! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën. Atëherë i kemi, dy propozime tash u bënë. Propozimi i parë është propozimi i zotit Sejdlar i cili kërkon që të shtyhet pika e dytë edhe pika e katërt. Atëherë, po që unë ta sqaroj. Kopja fizike duhet të jetë ajo që është në rregull, për shkak që në materialin e dërguar në mënyrë elektronike janë evidentue disa lëshime. Domethënë ne duhet të bazohemi te kopja fizike të cilëm e kemi pranue. Fjalën e ka kërkuar zoti Jonuzi.

Munir Jonuzi: Kopja fizike është materiali që duhet diskutuar, dje kam përjetuar një shqetësim sepse jam udhëzuar dhe lexoj materialin elektronik, ndaj dje në komitet për politikë dhe financa diskutova për versionin elektronik të materialit. Mendoj se ky propozim është i mirë dhe se këtë pikë të rendit të ditës duhet ta shtyjmë për kuvendin e ardhshëm. Sepse në të njëjtën kohë nga Drejtoria e Financave tha se afati i fundit për dorëzimin e dinamikës financiare të punës është muaji prill.

Uran Halimi: Faleminderit, zoti Jonuzi! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën. Realisht tash ekzistojnë dy propozime, nëse edhe Nedžmidini i qëndron asaj kërkesës për shtyrje edhe të pikës së dytë. Po, mundesh me e marrë fjalën, ni minutë të lutem.

Nedžmidin Sejdlar: Kjo nuk ka të bëjë me mua dhe nëse jam gati ta komentoj apo jo, kjo ka të bëjë me faktin se ne kemi dy dokumente të ndryshme. E keni parë vetë që kemi kolegë që nuk e lexojnë kopjen fizike. Është normale që kur është vënë re ky gabim, duhet të kishit ndikuar dhe shtyrë me autoritetin tuaj këtë pikë të rendit të ditës.

Uran Halimi: Faleminderit! Sa i përket asaj që disa s'e lexojnë materialin, unë nuk mundi me paragjykie, se ka mundësi që edhe e lexojnë. Edhe s'mundi me paragjykie me thonë që ti s'je i përgatitet për këtë pikë të rendit të ditës, se ka mundësi që je i përgatitur, kështu që këto janë veç hamendësime, edhe nuk funksionojmë na me hamendësime. Fjalën e ka kërkuar zoti Mejzini nga LDK.

Sefidin Mejzini: Kryesues, faleminderit për fjalën! Përshëndetje për të gjithë! Sa i përket kolegës, domethënë është shumë e thjeshtë, kur nuk don me bo problem, don me bo zgjidhje, i kemi të dyjat, na vendosim se me cilin kemi m'u marrë. Domethënë nuk ka diçka, a nëse ke naj qëllim tjetër, është diçka tjetër, po përderisa i kemi të dyjat, edhe elektronikin edhe fizikin, na këtu vendosim cilin kemi me shqyrtue. Domethënë është shumë e thjeshtë.

Uran Halimi: Faleminderit, zoti Mjezini! Fjalën e ka kërkuar kryetari i Komunës, zoti Bexhet Xheladini.

Bexhet Xheladini: I nderuar kryesues, i nderuar zëvendëskryesues, të nderuar delegatë, ju përshëndes të gjithëve! Sa i përket propozim-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023, dhe mjeteve që janë grumbullue jashtë planifikimit, këtu unë mora vesh që paskan dalë dy propozime, ni propozim që me vazhdue edhe ni propozim me u shty. Mendimi im është që, kopjen fizike të cilën e keni marrë është kopje origjinale, edhe ju vetë e dini se kur kemi dashtë ne me jau dërgue vetëm kopjen elektronike, ju keni reague, keni lyp edhe kopje origjinal, kopje fizike. Kështu që kopja fizike është kopje origjinale, edhe unë mendoj që ne duhet të bazohemi në këtë kopje fizike, edhe nuk ka nevojë me u shty vendimi, për arsye se do të shkaktohet vonesë një mujore e shpenzimit të mjeteve. Pse me shkaktue vonesë, kur ka mundësi kjo me u krye sot. Propozimi im është që kjo të miratohet sot. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, kryetar! Fjalën e ka zoti Artan Loshaj nga PDK.

Artan Loshaj: Përshëndetje për të gjithë! Zotni kryetar, ju po thoni që kopja fizike është origjinal. Në rregull. Qekjo kopja fizike që është origjinal, qekjo printohet edhe çohet me e-mail, se s'pe kuptoj. Edhe nuk është e drejtë që sot mos të shtyhet kjo. Nuk bohet shumë e madhe për me shty muajin tjetër. Ëshë mirë, herave tjera mos boni kësi shkelje. Qajo kopje fizike çohet në e-mail, unë s'e di që kopjen fizike e ke pru origjinal, e qat e-mailin ku e more. Çfarë dokumente more me na çue me e-mail. Gabimet e juaja që p'i boni, qetash po duhet m'i bart na. Herën tjetër venja mendën, hapni sytë ma shumë, keni kohë ni muaj ditë, përgatitne mirë edhe bine në seancën tjetër. Unë s'i Artan edhe si grup parlamentar jemi kundër kësaj, na jemi për t'u shtyrë.

Uran Halimi: Faleminderit, zoti Loshaj! Mu më duhet veç me ju sqarue që na mundim me diskutue për atë pikë të rendit të ditës, mirëpo nënshkrimin që unë e boj në vendim kam me bo sipas kësaj kopjes fizike, unë s'kam me nënshkrue atë që është në e-mail. Nëse janë gabime

teknike, nuk besoj që për gabime teknike na duhet me shty ni pikë të rendit të ditës, mirëpo prapë se prapë jeni ju ata që vendosni. Gabimi teknik po besoj që evitohet, domethënë kur ta marrim na vendimin, unë kam me nënshkrue kopjen fizike. Ju e dini çka boni, po sa i përket gabimit teknik, unë ju siguroj që e evitojmë këtë gabim, edhe e përmirësojmë, se ky është ni gabim teknik. Mundim me dhonë propozime për ndryshime, nëse e parashihni ju, mirëpo gabimin fizik, meqenëse i përket Zyrës së Kuvendit, atëherë me plot përgjegjësi unë thomë që, unë personalisht e evitoj, se unë nënshkruaj diçka fizike, nuk mundi me nënshkrue në mënyrë elektronike. Ni minutë replikë, Nedžmidin.

Nedžmidin Sejdilar: Imagjinoni që një nxënës të shkojë në shkollë dhe të ketë një mësim në tekst, por kur punon online në shtëpi, ka një mësim tjetër. Si do ta vlerësojë mësuesi përparimin e nxënësit. Sa herë që përfshihen para, gjithmonë keni disa gabime teknike. Si do të hyjë dikush në një diskutim kur nuk ka lexuar një kopje fizike. Unë nuk mendoj se është e drejtë që ta paraqes këtë në kongregacion sot. Ne nuk jemi të përgatitur ta shqyrtojmë këtë duke pasur parasysh se kemi dy dokumente të ndryshme. Unë do të mbështes mocionin për ndarjen e raporteve.

Uran Halimi: Kjo është arsyeja që ne i diskutojmë pikat e rendit të ditës përpara se me i hedhë në votim, propozohen ndryshime...veç pak zotëri Samidin, prej vendit jo me folë, ju lutem. Patjetër që bon.

Samidin Xheladini: Kuevendi është organi ma i naltë, në bazë të ligjit na vendosim për çështje me shumicë votash. Problemi është që neve kemi raste kur i debatojmë edhe çështjet kur në mënyrë urgjente, domethënë prioritete ose diçka të ngjashme, edhe i bina këtu edhe na i miratojmë ose s'i miratojmë. Unë edhe Nedžmidini jemi konë ithtarë të raporteve fizike, edhe bindshëm kam qenë fizike, edhe elektronike, po fizike domethënë gjithmonë duhet ta kemi raportin, edhe çdo raport që na vjen në Kuvend, unë me ngulm kam kërkue edhe kërkuj prapë që ta kemi në mënyrë fizike. Raporti në mënyrë fizike është raport që trajtohet shumë ma mirë se në mënyrë elektronike. Edhe Nedžmidini ka insistue me ngulm shumë herë, edhe e kam përkrah, edhe sot nuk mundim me dalë na kundër asaj që kemi kërkue. E dyta, për mjetet na tash duhet me qit në votim, kryesuesit p'i lutem me qit në votim, most ë hupim kohë pa nevojë, se s'është nevoja na me e zgjat. P'e qesim në votim, me shumicë votash, nëse ka nevojë. Ndërsa raporti, ndamja e raportit në mes të kësaj planit edhe raportit, domethënë edhe na jemi të pajtimit që kjo me u nda. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, zotëri Xheladini! Nëse jemi gati edhe e kemi shterue diskutimin, mundim me e i hedhë në votim propozimet. Domethënë jemi për shtyrjen e dy pikave të rendit të ditës, nëse doni i qesim veç e veç. Atëhereë e kemi propozimin e parë, pra zoti Sejdilar është për shtyrje të kësaj pike...jo, Nedžmidini e ka për të dy pikat me i shty, a po? Domethënë ti e ke kërkue veç propozimin për shtyrje të pikës së dytë? Okej, e hedhim në votim propozimin e zotit Sejdilar, kush është pro që pika e dytë të shtyhet për një seancë të ardhshme, kush është pro kësaj pike, kush është pro që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një seancë të ardhshme, edhe të evitohen

defektet ose lëshimet të cilat kanë mund me ndodhë realisht? Kush është kundër, që kjo pikë të mos shtyhet? Abstenim? Atëherë konstatoj që me 9 vota pro, me 13 kundër edhe me 2 abstenime, nuk shtyhet, nuk kalon propozimi i zotit Sejdlar për shtyrjen e kësaj pike. Vazhdojmë edhe e hedhim në votim propozimin e zotit Shpetim Hajredini, domethënë e kemi propozimin për ndarjen në pjesë të Raportit të Punës së Ekzekutivit, pika numër katër. Nëse mendoni që ka nevojë për debat, mundeni me e marrë fjalën, sa i përket propozimin për shtyrjen e pikës së katërt, si ta bëjmë ndarjen, nëse ka ndonjë propozim që është i duhur edhe i mirëseardhur, mundeni me e diskutue. Kryetari e ka lyp fjalën.

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, është e drejtë e juaja me kërkue edhe me vendos me e nda raportin, apo me e trajtue te përbashkët, ama mendimi im është që nuk ka nevojë, po prapë ju vendosni. Nëse vendosni për ndarje, material tjetër nuk ju çohet, e keni materialin edhe seancën e ardhshme e boni, mirëpo mendimi im është s'ka nevojë me u nda, e kryjmë sot.

Uran Halimi: Faleminderit, zoti kryetar! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim, edhe unë mendoj që, sa i përket raportit, është e pamundur me trajtue na komplet raportin me 10 minuta, unë propozoj që ky për një seancë të radhës të ndahet në dy pjesë të paktën, nëse jeni pro edhe ju. Atëherë e hedhim në votim propozimin e...Artani e ka kërkue fjalën. Po.

Artan Loshaj: Kryesues, shumë shkurt, në qoftë se e ndajmë, si do ta ndajmë, a do t'i ndajmë katër me katër drejtori, apo do ta ndajmë raportin veç e seancën tjetër plani me qenë veç. Mundësisht me na shpjepue.

Uran Halimi: Faleminderit, zotëri Loshaj! Për q'atë unë thashë a ka nevojë me diskutue edhe me dhonë sqarime, ose propozime, si mendoni ju që ta ndajmë, a po kupton. Edhe unë po due me bashkëpunue, mundim m'i dhonë propozimet, edhe këqyrim cilat janë mundësitë ma të mira edhe ma të dhura që ne ta trajtojmë sa më mirë edhe më lehtë këtë raport. Nëse ka dikush ndonjë propozim se si duhet ta bëjmë, atëherë urdhëroni, fjalën e keni. Shpetim, m'u dok se e lype fjalën a po, mundish me e marrë.

Shpetim Hajredini: Atëherë edhe një herë - përshëndetje i nderuar kryetar, se nuk ishe në fjalimin tim të parë – propozimi im ke shumë i qartë, ta ndajmë raportin nga plani i punës. Raporti të shqyrtohet, të diskutohet sot, plani i punës të diskutohet në seancën e ardhshme. Mbështetet apo jo, mbetet nga vota e asambleistëve. Kaq.

Uran Halimi: Më fal, zoti Shpetim, nëse na sot diskutojmë, atëherë i bjer që s'un e shtyjmë këtë pikë të rendit të ditës, a po kupton, këtu është esenca, nëse ka propozim për me e shty, edhe me diskutue, është pa logjikë. Propozimi, më falni, propozimi është që me u shty si pikë, me u hek si pikë e rendit të ditës. Me diskutue ndaras? Okej, Nedzmidin, na jep ni propozim, cili është, qysh duhet të trajtojmë? Po, mundesh.

Nedžmidin Sejdilar: Populli më dha mandat të flas këtu dhe të paraqes gjithçka që vërej në foltore. Unë do t'i kërkoja kryesuesit të mos lejojë të përsëritet një incident i tillë. Propozimi ishte i qartë, për të ndarë pikën e rendit të ditës në raporte dhe plane. Le të diskutojmë sot raportet dhe planet në asamblenë e ardhshme.

Uran Halimi: Faleminderit, e kemi ni propozim për ndarje të planit nga raporti. Ndonjë propozim tjetër a ka? Sot domethënë kemi me diskutue për Raportin e Punës, ndërsa për seancën e radhës kemi me diskutue për Planin e Punës. A jeni dakord për këtë? Po.

Mehmet Spahiu: Përshëndetje për të gjithë! Ne, në bashkëpunim edhe me kryetarin, edhe me grupin parlamentar të LDK-së, ne pajtohemi që raporti të ndahet, domethënë sot të debatohet për Raportin e Punës për vitin 2022, ndërkaq në seancën e radhës të bisedohet për Planin e Punës. Pajtohna me diskutuesit e mëhershëm që e dhanë këtë propozim. Faleminderit!

Uran Halimi: Në rregull, faleminderit! Atëherë propozimi është që pika e katërt të ndahet dhe sot do të flasim për Raportin e Punës së Ekzekutivit, ndërsa në një seancë të ardhshme do të flasim për Planin e Punës për vitin 2023. Kush është pro propozimeve që sot të diskutohet vetëm Raporti i Punës se Ekzekutivit? Kush është kundër këtij propozimi? Abstenim? Atëherë i kemi 21 vota pro, zero kundër edhe zero abstenim, pika e katërt sot do të diskutohet vetëm Raporti i Punës së Ekzekutivit për vitin 2022, ndërsa Plani i Punës për vitin 2023 do të diskutohet në një seancë të ardhshme, kurdo që e parasheh Zyra e Kuvendit. Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, duke përfshirë edhe ndryshimin të cilin sapo e miratuam. Domethënë, ndryshimi i vetëm është që Raporti i Punës për Ekzekutivin dhe Plani i Punës të ndahen. Nuk kemi largim të pikës së dytë, vetëm e kemi ndarjen e pikës së katërt në plan edhe në raport. Kush është pro këtij rendi të ditës, duke përfshirë edhe ndryshimet e propozuara? Kush është kundër këtij rendi të ditës? Abstenim? Atëherë i kemi 19 vota pro, 1 kundër edhe 2 abstenime. Kalon ky rend i ditës. Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës, miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar. Nëse ka ndonjë vërejtje ose nëse do dikush me e marrë fjalën në lidhje me miratimin e procesverbalit të seancës së kaluar, mundeni me e diskutue. Nëse jo, e hedhim në votim, kush është pro kësaj pike të rendit të ditës, është fjala për miratimin e procesverbalit të seancës së kaluar? Kush është kundër? Abstenim? Atëherë konstatoj që me 23 vota pro, me zero kundër edhe zero abstenim, miratohet pika e parë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e dytë, këtu ka të bëjë me Vendimin për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023. Fjalën e ka kërkuar kryetari i Komunës, zotëri Bexhet Xheladini.

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, ju keni marrë formën fizike të propozim-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuar nga viti 2022 në vitin 2023, edhe mjeteve vetanake të cilat janë grumbulluar jashtë planifikimit. Ndërkohë, nga momenti kur e keni marrë kopjen fizike, unë propozoj, si kryetar i Komunës, që të bëhen tri ndryshime të këtij propozimi. Te pozicioni

‘Shërbime kulturore – Dragash, subvencione’ kanë qenë të parapame 30 mijë euro, i shtohen edhe 31 mijë, do të thotë bëhen 61 mijë euro. Arseyeja pse, është se arsimit nga Qeveria e Kosovës i janë marrë 50 mijë euro për bursa, për shkak të vendimit të gjykatës për t’i paguar arsimtarët për shujtën edhe kontratën kolektive. Kështu që na, për mos me na mbet studentët pa bursa, ia kemi marrë kulturës. Tash duhet t’ia kthejmë ato mjete kulturës. Te ndërtimi dhe mbuloja e stadionit në fshatin Bresanë kanë qenë 45 mijë, i shtohen edhe 5 mijë. Ndërsa te shërbimet e shëndetësisë primare, i lihen vetëm 20 mijë euro, kanë qenë 56 mijë...

Uran Halimi: Më fal kryetar për ndërprerjen, nëse ke nevojë ta bëjmë ni kopje të këtij materialit. Jo, jo, asnjë fjalë të lutem, nëse kie nevojë veç mundesh me thonë a po e duesh ni kopje të këtij plani që e kemi na a jo? Unë s’jem t’u të bërtit, veç më kallxo p’e due edhe s’pe due. Të lutem mos ndërhyj asnjë fjalë prej vendit. Nëse ke nevojë, veç mundesh me thonë p’e due një kopje. Prej vendit s’ke të drejtë me folë. S’jem t’u të bërtit, jem t’u të pyet në mënyrën ma të mirë të mundshme, a ke nevojë për ni kopje të këtij materiali, nëse ti e kie gabim? Në rregull, e marrish fjalën mandej folish për këtë punë.

Bexhet Xheladini: ...do të thotë te shërbimet shëndetësore kanë qenë 56,483.46, tash duhet me qenë 20 mijë.

Uran Halimi: Faleminderit! Fjalën e ka zotëri Nedzmidin Sejdilar.

Nedzmidin Sejdilar: Trego mirësjelljen tënde dhe mos më bërtas. Kryetari tha se 56 mijë janë lënë mënjanë për kujdesin shëndetësor dhe te unë thotë 30 mijë. Kopja në gjuhën shqipe, kopja në gjuhën time dhe kopja në versionin elektronik nuk janë të njëjta. Ne po luajmë fshehurazi këtu, dhe pastaj kur kërkoj që të shtyhet kjo pikë e frikshme, është faji ynë. Lërimi qytetarët të shohin se çfarë dokumentesh na dorëzoni. Gjithçka në këtë material është e ndryshme. Kodet janë të ndryshme, shifra janë të ndryshme. Dhe ti kryesues, më thoni, a do që të të printojmë një version, ndaj nuk kërkova sanduic këtu që ta ha menjëherë. Këtu janë në lojë paratë e qytetarëve të komunës sonë. Në këtë kopje që kam marrë, janë ndarë rreth 91,100 euro për investime kapitale për Opoje, kur t’i shtojmë këto 5,000 euro, do të kemi rreth 96,000 euro, ndërsa ju keni ndarë 46,000 euro për Gorën, a është kjo një shpërndarja e drejtë?. Nëse është respektuar përqindja e ndarjes së mjeteve. Çfarë mendoni ju zoti Rahte për këtë? Meqenëse ju jeni kryetar i komitetit të komunitetit. A e keni lexuar këtë në dokumente. A e keni pyetur veten se shpërndarja e fondeve nuk është 60% me 40%, por 68 % me 32% dhe dëshironi që ne të kemi parasysh macen në thes këtu. Paratë janë një çështje serioze. Kërkoj që t’i kushtoni vëmendje kësaj çështjeje. Unë kërkoj një ndryshim në këtë buxhet të çuditshëm, duke pasur parasysh që ka ndodhur një tërmet në Turqi dhe duke pasur parasysh që komuna jonë është e binjakëzuar me disa komuna në Turqi, turqit po na hapin rrugë të ndryshme në të gjitha drejtimet, po na ndihmojnë shumë. Unë mendoj se këtu në këtë raport në këtë plan për të transferuar fonde, të ndahen të paktën 10 mijë euro për ndihmë për Turqinë. Kërkoj që ky propozim i imi, të vendoset në kuadër të vendimit për ndarje buxhetore.

Uran Halimi: Faleminderit, zoti Sejdilar! Veç pak ju lutem, fjalën mas meje e ka kryetari, edhe pastaj zoti Rahte...Edin Kurt, më falni. Problemi është që na e votuam këtë rend të ditës, edhe është qeshtu siç është mo, është i pandryshueshëm. Të kallxova cilit m'i besue, po ti s'po dësh m'i besue. A p'e dësh ni kopje të njëjtë? Unë nuk e di ku e ke marrë, s'marr përgjegjësi për atë pjesë. Okej, u krye debate, fjalën e ka zotëri Edin Kurt.

Edin Kurt: Pershendetje te gjithëve dua te them qe nuk e kam pare as versionin elektronik, kam ndjekur versionin fizik. Pra nuk kishte asnjë problem deri pak kohë më parë. Kryetari doli në foltore dhe kur paraqiti propozimet e tij dhe kur fliste për numrat rendorë, ai lexoi një vendim, dhe unë kisha një vendim krejtësisht të ndryshëm në material. Unë lexova sipas kopjes fizike dhe gjithashtu në versionin tim për shërbimet parësore shëndetësore kemi rreth 30,000 euro. Po ashtu nën numrin 12 Kryetari lexoi një tjetër artikull, dhe në material është krejtësisht ndryshe. Gjithashtu, për mua, shërbimet kulturore nuk janë numër dy, por bujqësia.

Uran Halimi: Faleminderit, zoti Kurt! Fjalën e kërkoi kryetari më herët, nëse i qëndron prapë asaj kërkesës.

Bexhet Xheladini: Sa i përket ndarjes së drejtë, nuk shikohet buxheti parcial sa po ndahet, po shikohet buxheti total. Unë ju garantoj që buxheti total është mbi 41.3% për minoritet. Edhe këtu te bujqësia, subvencione janë mjete të përbashkëta, te shërbimet kulturore janë mjete të përbashkëta. Në arsim, subvencione 31 mijë euro janë bursat e studentëve mjete të përbashkëta. Te Radesha janë mjete të komunitetit joshumicë, Rapçë janë të komunitetit joshumicë, Gllloboqicë janë të komunitetit joshumicë, edhe te shërbimet shëndetësore janë të komunitetit joshumicë, dhe do të blihet ni minibus i cili do t'i transportojë nxënësat e komunitetit joshumicë. Unë nuk e kam mbledhë, po sigurisht që edhe këtu është përqindja e njëjtë, do të thotë 41%, po megjithatë përqindja e përgjithshme e ndarjes buxhetore është mbi 41.3%. Kush nuk beson, ky Kuvend mundën me e formue ni komision edhe me e vërtetue, edhe në seancën e ardhshme mundin me raportue. Edhe ju garantoj që edhe me buxhetin e vitit të kaluem, shpenzimet kapitale për komunitetin joshumicë kanë qenë mbi 41%.

Uran Halimi: Faleminderit, kryetar! Fjalën e ka kërkue zotëri Agron Gashi.

Agron Gashi: Së pari i përshëndes të pranishmit, përshëndetje kryetar, kryesues, asambleistë! Po sikur të vështrojmë ni këndvështrim statistikor, do të shohim diçka se lyp të ketë korrigjim te këto ndarje buxhetore. Në çfarë aspekti? Aty shoh se në pikën e katërt thotë se kemi të bëjme me ndërtimin e pllakës dhe kulmit të shkollës në Bresanë që kap një buxhet prej 12 mijë e ca, më poshtë kemi në pikën e dhjetë thotë ndërtimi dhe mbuloja e stadiumit në fshatin Bresanë. Këto dy pika marrin një kosto mbi 60 mijë euro. 60 mijë euro kur të përpjestohen me shumën totale që e kemi vetëm 254 mijë euro, i bjer 25% të buxhetit është i dedikuar në fshatin Bresanë. Dhe ne duhet

të llogarisim se komuna jonë disponon 35 fshatra, dhe kjo ndarje unë po konsideroj se kërkon një analizë më të mirëfilltë, sepse ni stadium dhe me mbulojë në një fshat, e diku tjetër mos të ketë as një kënd më elementar lojtrash, më duket ndarje joprofesionale dhe kërkon një korrigjim. Kaq pata, faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, zoti Gashi! Fjalën e kërkoi zoti Mejjini, nëse mundesh me dalë, pas tij mundesh me e marrë fjalën.

Sefidin Mejjini: Kryesues, edhe ni herë faleminderit! Agron, qetu e kam bo ni listim të projekteve të nisura prej komunitetit ku vij unë, po s'është nda asnjë cent. Domethënë, këto që i përmende në fshatin Bresanë edhe krejt tjerat janë projekte ekzistuese. Nëse do me t'i lexue, asfaltimi i rrugës në Kuklibeg, projekte ekzistuese, nuk është që është bo projekt i ri, edhe unë nuk due me diskutue për këto pikat, domethënë, tash qeto nuk e di pse ka arsye për me e pengue qet pikën e rendit të ditës. Kam respekt për profin, shumë herë ka hargjue energji për subvencione për bujqësi, edhe tash dolën këta e votuen kundër. Janë mjete që po shpërndahen në të gjithë komunitetin e trevës së Opojës edhe të Gorës. Nuk e di pse, tash na nuk jemi këtu veç për vete, kemi qit edhe pleq për dore me na votue, se iu kemi thënë kemi me bo diçka mirë, e tash nuk është arsyeja veç me pengue, me pengue, me pengue. Te lutem, të jemi ma korrekt të gjithë, se nuk është non-stop me e bart atë ngjyrën politike, jo, duhesh me e bart edhe atë ngjyrën e njerëzillëkut edhe m'u konë shumë ma fer. Janë mjetet që po shpërndahen, tash insistimi është prej sekondës së parë veç me bllokue, me bllokue, me bllokue. Çka po bllokojsh? Mjetet që po dona me i shpërnda komuniteteve. Faleminderit.

Uran Halimi: Faleminderit! Po, po prit se krejt kemi me u sqarue, pa problem. Faleminderit zotëri Mejjini, fjalën...replica i takon zotit Nexhat Selaj, se iu përmend emir. Okej, hajde drejtor, hajde drejtor. Okej, ama bone praktikë prej vendit mos me folë. Qysh s'po ta jap fjalën, krejtve jau jap fjalën, ama me rend shkon kjo.

Qamil Kolloni: Përshëndetje kryetar, përshëndetje kryesues, përshëndetje delegatë dhe të gjithë juve të pranishmëve! Dëgjo, në këtë listën ku është bë shpërndarja, janë numrat, kodi, që kanë qenë projekte të vitit të kaluar. Një pjesë e këtyre projekteve vazhdojnë edhe këtë vit edhe duhet të përfundojnë si projekte të tilla. Nuk kanë mund të mbulohen vitin e kaluet, kryhen sivjet. Projekti i shkollës ka qenë vitin e kaluar 45 mijë euro të cilat kanë shkue në OSHP dhe OSHP e ka kthye vendimin prapë këtë vit, dhe paret na kanë shkue prapë, kurse operatori ekonomik e ka fitue të drejtën që ta kryejë punën këtë vit, dhe kemi qenë të obliguar të rezervojmë mjete, se operatori ekonomik fillon punën edhe i lypën mjetet. Të gjitha projektet, shumica e projekteve të investimeve kapitale janë të ndara nëpër projekte të cilat na kanë mbet. Është stadioni në Gllloboqicë, e keni këtu, e kemi nëpër projekte, qe shifrat ku ju shkruajnë. Këto projekte që kanë shifra janë projekte të vitit të kaluem që kryhen sivjet edhe përfundojnë. Prandaj, kemi qenë të detyrueshëm m'i përfundue këto projekte me këto mjete. Dhe, subvencionet janë subvencione të

përbashkëta. Edhe, në fund kemi dy projekte të reja që njëri është 5 mijë euro në Zym edhe tjetri është 10 mijë euro për komunitetin për me e bo nifarë bilanci. Unë po ju them me shumë përgjegjësi, pasqyrat financiare mbyllen me 31 mars, dhe raportin përfundimtar të investimeve kapitale mos e politizoni edhe mos e boni problem politik, se nuk ka të bëjë. Ju garantoj që pasqyrat financiare kur të dalin prej SIMFK do ta keni raportin këtu, dhe s'keni nevojë me e diskutue tash, kur ai raport ju vjen në mënyrë të... Prandaj, unë mendoj se në qoftë se dëshironi me i dhënë kahje, është mirë me qenë të sqaruet pse keni dhënë. Dhe këto mjete ndojëherë punët t'i ndajnë kah duhet m'i çue. Unë mendoj se as projektet e komunitetit goran nuk kanë me mbet të dëmtume, as të komunitetit shumicë.

Uran Halimi: Faleminderit, drejtor! Unë po besoj që thelbi edhe esenca e kësaj pike të rendit të ditës është me u bart mjetet e jo me u gjujt edhe m'i lonë të pashfrytëzume. Kjo është esenca, prandaj mënyra si ndahen le t'bëjmë propozime bre, unë s'pe kuptoj qeto. Këtu vetëm akuzojnë për mosndarje në proporcion, mirëpo propozim se si duhet s'e bon kërkush. Kjo mu po më shqetëson. Esenca e pikës së rendit të ditës është bartja e mjeteve. Mënyra qysh ndahen po propozojmë bre, jemi këtu për me propozue, për me votue propozime, në demokraci jemi. Ni minutë, Nedzmidin.

Nedzmidin Sejdilar: Ne jemi këtu për të propozuar dhe për të votuar në përputhje me propozimet. Por për të propozuar dhe për të qenë gati duhet të respektojmë kushtetutën dhe ligjet e shtetit. Sot kemi 10 dokumente të ndryshme. Mund të shikoni në procesverbal kur Kryetari tha se ne do t'i ndajmë paratë nga shëndetësia për komunitetin jo-shumicë dhe me këtë do të blejmë një autobus për nxënës nga komuniteti jo shumicë. Një minibus për nxënës, nuk e di çfarë lidhje ka me shëndetësinë. Gjithashtu zoti Kolloni paraqet fakte që nuk i kemi në këtë dokument tonën. E treta, subvencionet për kulturën, arsimin, të gjitha këto i lashë jashtë kësaj tabele, numërova shifra vetëm për renovimin e kulmit, asfaltimin e rrugëve e të ngjashme. Ne morëm rezultatin që ju në Opojë keni rreth 90,000 euro dhe ne në Gorë 46,000 euro, pjesën tjetër të parave nuk i kam llogaritur në ndarjen e drejtë.

Uran Halimi: U krye koha, ni minutë e ke pas kohë për replikë, fjalën e ka zotëri Nexhat Selaj. Faleminderit shumë!

Nexhat Selaj: Përshëndetje kryetar, kolegë! Te kjo shpërndarja e parave vetanake, po duket që prej fillimit është ni mos harmonizim edhe po duket si mosndarje e barabartë, e cila po vjen deri te kjo polemikë, e cila po diskutohet qe sa kohë. Në radhë të parë, veç kryetari i largoi tri pika, i barti disa subvencione prej ni pozicioni në një pozicion tjetër, edhe kolega pak më parë në një formë më akuzoi se gjithmonë e kam mbrojtur sektorin e bujqësisë, e tash e kundërshtova. Edhe tash do t'ia kundërshtoj, se e kam në pikë të diskutimit, të cilën e kam punue pak më parë, kolegë. Nuk është e drejtë që në numrin rendor 1, po flas me numra për hir të, që mos të preken pak edhe votuesit, e kam te bujqësia të ndahen 21 mijë euro, e në pikën 10 të ndahen 45 mijë euro plus 5

mijë euro të shtohen. A është e drejtë, se në Komunën e Dragashit, pikërisht në qytezën e Dragashit, kemi mbi 2 mijë banorë, edhe kryetari është këtu, ne të cilët jetojmë këtu, deshta veç t'jau bëj një pyetje; a pi ujë dikush në këtë qytezë? Ne shpërndajmë para 254 mijë euro, keni mujt edhe këto m'i hargjue me qit zero-zero, sa që na keni lonë këtë telashe me këto shpërndarjet. Ne akoma përdorim ujin e viteve 50-ta, sistemin e ujit të gypave të azbestit. Këtu është Qamili, nëse nuk është këtu, le të thotë jo, këtu është Artani që banojmë, le të thotë jo, këtu është Nuhija Tairovci, i cili pjesë më të madhe të kohës e kalon këtu, le të thotë që s'është e vërtetë, nuk po shoh të tjerë të cilët banojnë këtu. Edhe këto para të derdhen në pikën 10, që të shkojnë 50 mijë euro të grumbullohen, e ne mos të kemi ujë të pijes. Veç po due ta pyes kryetarin a e pi ujin qetu në Dragash apo jo. Për këtë arsye, unë e shoh se shpërndarja nuk ka tregue ni transparencë, nuk po hi me e diskutue pak më tepër, për hir të votuesit, se na preken votuesit, kemi votues nëpër të gjitha fshatrat dhe nuk po due që të flas. Dalim edhe te pika e gjashtë, 14 mijë, 15 mijë euro që të ndërtohet asfalt nëpër bjeshkët e sharrit, në Komunën e Dragashit mos të kemi ujë të pijes, unë nuk di çka të flas më tepër. Prapë po nisem te një propozim i imi, i cili kishte me qenë ndoshta më i mirë se t'i kishit hargjue këto pare të gjitha, ashtu siç edhe ia niset në fund të dhjetorit, deri në nëntor e keni pas 65% të buxhetit të mbuluar, prej shtatorit, tetor, nëntor edhe nëpër dimër, kryetar, shtruet asfalt. I hargjojshit edhe qeto, e nuk na lishit këto telashe. Një pyetje për Qamilin e kam; thaje, drejtor, kemi qenë të detyruar që këto para t'i shpenzojmë. Po mos të kishin qenë që t'i mbulojmë projektet paraprake, të vitit 2022, po mos të kishin qenë këto para, ku do t'i merrshit këto para për m'i shpenzue? E gjithë kjo tollovi po vjen, unë po mendoj, për hir të asaj se nuk po organizojmë një organizim të punës që qeverisja t'i mbledhë nga një anëtar të grupeve parlamentare dhe bashkërisht ta bëje shpërndarjen. Bashkërisht po ta kishit bë këtë shpërndarje, nuk do të kishim ardhë deri te kjo rrëmujë. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, zotëri Selaj! Fjalën e ka kërkue zotëri Bexhet Xheladini.

Bexhet Xheladini: Deshta vetëm të dal t'ia jap një sqarim Agronit. Asfaltimi i rrugës për fshatin Kuklibeg, ndërtimi i pllakës dhe kulmit dhe renovimi i shkollës fillore "28 Nëntori", dhe mbuloja e stadionit në fshatin Bresanë, janë projekte të cilat janë propozue kur ka qenë kryetar Shaban Shabani. Mirëpo, buxheti nuk ka qenë adekuat do të thotë, edhe ka ndikue edhe kriza ekonomike, edhe këto janë projekte 2-3 vjeçare, edhe na me kompanitë kemi të lidhura kontrata, edhe këto, për me i mbulue kontratën është bo bartja e këtyre mjeteve, për arsye se ne patjetër këto projekte duhet t'i kryjmë. Nuk është puna që këto mjete janë orientue pse jam unë kryetar i Bresanës, po mjetet janë orientuë për m'i krye projektet të cilat kanë qenë të propozuara nga qeveria e kalume. Buxheti nuk ka qenë i përshtatur me projektin, thashë edhe ni herë, edhe kriza ekonomike vitin e kaluem që është bo rritja e çmimeve ka ndikue, edhe kjo ka ardhë deri te lidhja e kontratës me kompanitë me ni çmim ma të madh sesa planifikimi. Për atë qëllim janë bo këto propozime, ndërsa balancin e ndarjes së mjeteve financiare nëpër fshatra, na e kemi bo në shtator-tetor. Këto janë mjete të cilat është dashtë patjetër m'u mbulue projektet që kanë qenë të parapame. Faleminderit! Është në dorën e juaj, doni me e votue a jo, është diçka tjetër, po edhe ju kur keni qenë në pushtet, keni ardhë me

ni propozim, pavarësisht a u konë i mirë, po u konë propozim i juaji. Propozimi ynë është ky, po delegatët kanë të drejtë me dhënë vërejtje, sugjerime të ndryshme. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, kryetar! Unë besoj që është çështje e hapur, edhe për propozimet, edhe ju ftoj që ku ka mospajtime, ku mendoni që mundemi me ndikue diçka për të mirë, jepni ni propozim edhe e hedhim në votim. Kryetari i ka propozimet e veta, aty ku mendoni që bëhet ma mirë me ni propozim të mundshëm të juajin, munden me u hedhë në votim, nëse ka dikush ndonjë propozim, munden me e bo, për shembull ni bartje të mjeteve edhe arsyen pse po mendon qashtu. S'ka. Atëherë e hedhim në votim, e kemi vendimin për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023, duke përfshirë edhe propozimet për ndryshime që i bëri i kryetari i Komunës. Kush është...në fakt tri ndryshime, po unë i shënova këto tri ndryshime, po e hedhim në votim propozimin-vendimin me ndryshime. E patëm te pika e dytë shumë prej 30 mijë euro t'shtohen edhe 31 mijë euro, e patëm pikën 10, nga 45 u bo 50 mijë euro, edhe e patëm pikë 12-të ku nga vlera 56,433.46 euro të zbritet në vlerën 20 mijë euro. Atëherë e hedhim në votim këtë pikë të rendit të ditës me propozimet...cili ishte propozimi yt?

Nedžmidin Sejdilar: Pak më parë kam bërë një propozim që nga fondet vetanake të ndahen fonde për ndihmë për Turqinë dhe Sirinë. Do t'i marrim këto mjete prej 8933 eurosh për asfaltimin e rrugës Globoçicë-Baçkë-Dikance dhe do t'i transferojmë për të ndihmuar të prekurit nga tërmeti, ndihmë për popullin turk që rregullisht na ndihmojke. Unë sugjeroj t'i transferoni këto fonde tek ata në llogari, faleminderit.

Uran Halimi: Faleminderit për propozimin, e hedhim në votim së pari propozimin e zotit Sejdilar...qysh edhe ni herë? Se qashtu po më pëlqen. Kryetar, e hedhim në votim këtë pikë të rendit të ditës me propozimin tënd. Fjalën e ka kërkue zoti Edin Kurt.

Edin Kurt: Ju po e vendosni këtë dokument në votim dhe ne delegatët e komunitetit joshumicë nuk e kemi të qartë se për çfarë po votojmë, Kryetari bëri disa propozime por ne nuk i kuptuam ato propozime, duke pasur parasysh se ai i bëri ato propozime me numra rendor dhe versioni fizik që kemi marrë nuk është dakord dhe nuk ia dalim dot. Kërkoj nga Kryetari të lexojë me emër propozimet që ka bërë, që ta dinë se ku po transferohen fondet.

Uran Halimi: Faleminderit, zotëri Edin Kurt! Unë ta jap sqarimin saktësisht, jo me numra rendor qysh ju po kërkoni, e kemi qysh thashë edhe ma herët, edhe për shkak të përkthimit po foli ma kadalës, e kemi te shërbimet kulturore – Dragash kodi 850/85009, ku vlera e paraparë prej 30 mijë euro, i shtohet edhe 31 mijë euro, totali është 61 mijë euro. Mandej e kemi te planifikimi urban dhe inspekcioni, kodi është 660/66350, këtu është paraparë që kësaj vlere t'i shtohen edhe 5 mijë euro, është propozuar po mendoj. E kemi edhe një ndryshim të fundit, shërbimet e shëndetësisë primare, kodi është 730/37550, ku është paraparë që nga 56 mijë euro, vlera e saj të jetë 20 mijë euro. Ma konfirmo nëse e ke të qartë. Po, mundesh me e marrë fjalën.

Edin Kurt: Në këtë tabelën tonë thuhet se vlera e shërbimeve të kujdesit primar shëndetësor është 30 mijë euro. Dhe jo 61 1000 euro Ky është ndryshimi. E kuptova se ku duhet të investonim, por nuk e kuptoja se nga cilat burime apo projekte do të merren ato fonde.

Uran Halimi: Faleminderit! Unë po besoj që sado që ka qenë vlera aty, u propozue që m'u konë 20 mijë euro. Në rregull, është propozimi ma i mirë i mundshëm. I kemi dhjetë minuta pauzë, shihemi mas dhjetë minutave.

Vazhdojmë aty ku mbetem, edhe është mirë pak a shumë me na sqarue çka ka ndryshue.

Bexhet Xheladini: Atëherë, të nderuar delegatë, e keni marrë verzionin përfundimtar të propozim-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023, kështu që është në dorën tuaj tash të votoni për këtë propozim. Unë do ta jap edhe ni sqarim. Me anëtarët e kabinetit tim, ne kemi biseduar për mundësinë e dhënies së mjeteve financiare për tërmetin në Turqi, dhe na kemi mendue që këto mjete të merren jo nga komuniteti joshumicë, por nga mjetet e përbashkëta, nga pozicioni subvencione dhe transfere të kulturës. Mirëpo, duke marrë parasysh se mjetet të cilat i kemi nda në seancën e kaluar për Skënderajin, Qeveria e Kosovës nuk i ka ekzekutue, Ministria e Financave, na i ka kthye prapë, me arsyetimin se na nuk kemi të drejtë me iu dhënë mjete atyre. Na këtë punën e ndihmës së Turqisë e kemi lënë m'u konsultue me ministrinë, nëse ata na lejojnë, na mundim me e marrë ni qëndrim që unë si kryetar, prej pozicionit subvencione dhe transfere të kulturës, munda me i nda 10 mijë euro për Turqi. Nëse na lejon qeveria, mos ta bojmë edhe ni gabim. Mirëpo, ato mjete na që i kemi nda për Skënderaj, unë do ta kem një takim me kryetarin e Skënderajt, edhe do të kërkoj nga ai që të na paraqet kërkesat çka ka nevojë ai, me mall, do të thotë me ble a llap-topa për shkolla, apo karrika, banka që janë dëmtue ose diçka tjetër, edhe me ato mjete na që i kemi nda atyre do t'jau çojmë në formë jo të mjeteve, po në formë të ndihmave materiale. Kështu që, unë për atë dola me e dhënë ni sqarim, nëse qeveria na lejon që t'i ndihmojmë Turqisë, është mirë m'u ndihmue, nëse qeveria thotë kjo është çështje e shtetit edhe shteti do të ndajë mjete për m'i ndihmue Turqisë, atëherë na s'kemi nevojë m'u marrë. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, kryetar! Meqë u përmendën llap-topat, m'u rikujtue edhe mu që edhe na si Kuvend nuk kemi llap-topa, duhet me na i servue llap-topat, si kuvendet e mëhershme, edhe ka mundësi që këto telashet që na dalin në Kuvend është edhe mungesa e llap-topave. Unë e di që shumica prej neve kanë nevojë për m'u pajis me llap-topa, mirëpo po besoj që drejtori për Administratë – që po e lypën edhe fjalën – besoj që ka me e mbështet këtë kërkesën e Kuvendit tonë. Po, mundesh me e marrë fjalën.

Vetim Ramadani: Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, të nderuar asambleistë, kolegë drejtorë! Për çështjen të cilën e ngrite, na këtë vit do të bëjmë furnizimin me llap-top, ashtu siç kemi bisedue edhe në seancën e fundit të vitit paraprak. Tashmë është në kontratë-kornizë e

vendosur, të gjithë e dimë se ndryshimi i çmimeve ka pasue me prishjen e të gjitha kontratave-kornizë që kanë qenë të lidhura mes qeverisë së Kosovës dhe operatorëve ekonomikë. Si pasojë e kësaj ne nuk kemi arrit me zhvillue procedura të tjera, na kemi mungesa edhe sa i përket stafit civil i cili punon në komunë, kemi probleme zakonisht me pajisje të IT-së. Mirëpo, këtë vit është nënshkrue kontrata e re edhe na kemi mundësi që t'i porosisim për të gjithë asambleistët. Shpresoj edhe uroj që me këtë rast, në momentin kur pajiseni me llap-top të gjithë asambleistët, tashmë të na largohet edhe kjo problematika e materialit, meqenëse kemi shumë problem, si komunë, që ta printojmë materialin. Po flas për seancat si kjo e sotit, që kanë material voluminoz, për raportet e punës, planet e punës e gjëra të ngjashme. Shpresoj që ky problem do të zgjidhet në të ardhmen, përndryshe, sa i përket llaptopëve, do ta zgjidhim shumë shpejt. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, drejtor! Tash, Nedzmidin, kemi diskutue për pikat e rendit të ditës. Në lidhje me çka? Okej, ni minutë replikë.

Nedžmidin Sejdilar: Këtu po marrim përsëri një version të ri të këtij materiali. Ju thatë që do të shtojmë 50 mijë euro dhe sërish në këtë listë kemi 45 mijë euro. Në të njëjtën mënyrë hoqët edhe projektin e asfaltimit të rrugës Globoçicë-Baçkë-Dikancë dhe ne nuk ia dhamë ato mjete turqve. Ju hoqët asfaltin nga ajo rrugë. Si do ta zgjidhim këtë problem? Ky është dokumenti i fundit që keni dorëzuar, projekti i asfaltimit të rrugës prej rreth 8000 euro nuk është në listë. Nuk mund t'ju them numrin serial të projektit sepse nuk është më në material. Këtu nuk ka më fonde për asfaltimin e rrugës Globoçicë-Baçkë-Dikancë, ka qenë rreth 8900 euro, tani ikën. Dhe sugjerova që paratë të jepeshin për të ndihmuar turqit edhe në Siri. Kryetari tha se nuk mundemi, por paratë u zhdukën. Ku janë ato para? A do të më shpjegojë dikush.

Uran Halimi: Faleminderit, zoti Sejdilar! E patëm propozimin e kryetarit për me e subvencionue Turqinë për shkak të tërmetit që ka ndodhë atje. Unë e kontrollova edhe verzionin e mëhershëm...okej, ju lutem, po vazhdojmë me e votue këtë pikë të rendit të ditës me propozimet e mëhershme. E kemi propozimin e kryetarit qe propozoi për me ndihmue financiarisht Turqinë, nga subvencionet e kulturës në vlerë prej 10 mijë eurove, a po? Në rregull, atëherë kjo jetë si propozim për ndonjë seancë në të ardhmen. Atëhere, ndryshime tjera nuk ka, përveç këtij dokumenti final të cilin sapo e morët nga shërbimi i Kuvendit. Është koha që me e hedhë në votim, për shkak të mënyrës së përgjithshme, është mirë që me e mbështet këtë bartje të mjeteve, se është diçka që na përket neve, andaj ju ftoj që ta votojmë. Kush është pro kësaj pike, pikës së dytë, vendimi për bartjen e mjeteve? Kush është kundër kësaj pike të rendit të ditës? Edhe abstenim? I kemi 16 vota pro, 1 kundër edhe 6 abstenime, kalon pika e dytë e rendit të ditës. Propozimin e zotit Sejdilar mundim me e lonë edhe te eventuale, nëse nuk prish punë. Nëse jo, atëhërë e hedhim në votim edhe qetash, po ta bëjmë renditjen e pikave. Atëherë, Nedzmidin, propozimin tënd do ta hedhim në votim te pika eventuale.

Nedžmidin Sejdilar: Zoti Kryesues, mendoj se ju duhet urgjentisht një lloj kursi, për t'ju trajnuar sadopak që të dini se vendimet nuk merren në pika të ndryshme.

Uran Halimi: Faleminderit, zoti Sejdilar! E kam parasysh këtë këshillën që ma dhaje, e respektoj maksimalisht, po krahas punës jam t'u bo edhe praktikën. Ma herët që thashë unë dhjetë minuta pauzë, shumica s'e respektuan këtë dhjetë minuta, shkuen me u ushqye, na do tjerë mbetëm pa u ushqye, p'e kryejmë edhe pikën e tretë të rendit të ditës, edhe vazhdojmë me pauzën, të cilën na s'e kemi shfrytëzue. E kemi raportin e punës së KKS-së për gjashtëmuajorin e dytë. Kjo nuk është diçka që na duhet me e hedhë në votim, është ni raport i punës, edhe është mirë që kryetari me dalë me na dhonë nifarë informacioni se çka përmban ky raport. Nëse nuk kie dëshirë, mundesh edhe mos me dalë kryetar. Na materialin e kemi pranue.

Bexhet Xheladini: E falënderoj kryesuesin, ndoshta edhe s'ka pas nevojë me dalë, po masi kërkoi që të dal, unë dola. Ju raportin e keni marrë, Ju e dini që me ligj, çdo gjashtë muaj duhet në Asamble Komunale të raportohet për punën e KKS-së. Ju e keni marrë raportin, e keni lexue, nëse dikush ka ndonjë pyetje eventuale për këtë raport, unë jam këtu, mundi me dhënë përgjigje. Përndryshe, gjatë vitit të kaluar kemi mbajt gjashtë takime të KKS-së, këtë vit kemi mbajt dy takime dhe, në bazë të ligjit, na këtë vit planifikojmë t'i mbajmë gjashtë takime. Unë sa i përket këtij raporti më shumë s'due me e zgjat.

Uran Halimi: Faleminderit, kryetar! Nëse do dikush ndonjë pyetje në lidhje me këtë raport? Po, Nedzmidin Sejdilar e ka kërkuë fjalën.

Nedžmidin Sejdilar: E kam lexuar disa herë këtë raport, thotë se situata është stabile në të gjitha fushat, duke filluar nga siguria, jo nga siguria në komunikacion e më gjerë. Ajo që më tërhoqi vëmendjen është kjo tabelë këtu. Kur të mbledh numrin e krimeve nga statistikat, do të arrijmë në përfundimin se çdo i dyti qytetar i komunës sonë është delikuent. Pra, si e shpjegoni situatën e sigurisë kur statistikat ju thonë krejtësisht ndryshe. Këtu e shoh numrin e rasteve të iniciuara, por ju nuk e keni bazuar raportin se sa dhe në sa mënyra i keni zgjidhur rastet. Jo ju, por të na jepni një raport nga komandanti i policisë. Ju thoni se siguria në komunikacion është në nivele të lakmueshme dhe këtu në komunën tonë janë shqiptuar mbi 3820 gjoba. Kjo është rreth 37% e qytetarëve të komunës sonë. Teksti me statistikat thjesht nuk pajtohet me ju, kështu që nëse mund ta shpjegoni më mirë këtë çështje.

Uran Halimi: Faleminderit, zotëri Sejdilar! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Fjalën e ka zotëri Samidin Xheladini.

Samidin Xheladini: Raporti gjashtëmujor i KKSB-së është një raport i cili paraqet punën e KKSB-së në kuadër të dispozitave ligjore dhe ka shqyrtuar një mori çështjesh me rëndësi, si vlerëimi i gjendjes së përgjithshme të sigurisë në komunën tonë, planin operativ, sigurinë në trafik, monitorimin dhe raportimin e sigurisë nëpër shkolla, zbatimin e planit të sigurisë, raportimin dhe marrjen e masave për shkelësit e ligjit në komunë, themelimin e këshillit për siguri në bashkësi në terren, mbrojtjen pyjore nga prerjet ilegale, sigurinë në trafik, parandalimin e dhunës në familje, raportin e komandantit të policisë dhe policisë kufitare, raportin e Drejtoratit të Arsimit, raportin e Zyrës për Barazi Gjinore, kujdesin për përdorim të mjeteve piroteknike. Të gjitha këto edhe të tjera, do të ishte mirë dhe kërkoj nga përpiluesi i këtij raporti, në të ardhmen që nëse kam mundësi të na paraqet edhe një gjendje të periudhës 3-5 vjeçare, të bëjë krahasimin për të parë gjendjen ndër vite, se a ka pasur përkeqësim apo përmirësim të gjendjes. Unë mendoj se, falë Zotit, viti i kaluar ka qenë dhe pa ndonjë rast që mund të theksohet, dhe kjo meritë i atribuohet qytetarëve të komunës sonë në përgjithësi dhe organeve komunale në veçanti. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, zotëri Xheladini! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën. Nëse jo, mirë është me u konsultue për një pauzë, për ne që s'e kemi krye drekën. Andaj ju ftoj që kjo seancë të vazhdojë në ora 13:30.

Të nderuar të pranishëm, mirë se u rikthyet për vazhdimin e seancës aty ku e lamë, është fjala për pikën e katërt të rendit të ditës, siç ishte edhe e propozuar për ndarje, e kemi pikën e katërt të ndarë, e kemi vetëm Raportin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2022. Meqenëse ky është veç raport edhe plani ka mbet për një seancë të ardhshme, nuk është kjo një pikë të cilën duhet ta votojmë, thjesht kanë me raportue drejtorët ose kushdoqoftë nga ekzekutivi në lidhje me punën e tyre për vitin 2022. Atëherë fjalën e ka kërkuar kryetari edhe të vazhdojmë më tej.

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, masi u bo ndarja e raportit prej planit të punës, atëherë unë si kryetar i komunës, ju e dini që Raporti i Punës është raporti i kryetarit të komunës me ekzekutivin bashkë, dhe unë do ta lexoj në tërësi vetëm raportin tim, ndërsa tabelat nuk do t'i lexoj, ndërsa drejtorat do të dalin secili dhe do të raportojnë për raportin e vet në pika të shkurta, maksimumi pesë minuta, kështu që pastaj do të ju lë më shumë kohë juve asambleistëve që të bëni pyetje, edhe të merrni përgjigj.

Qytetarë të Komunës së Dragashit,

Të nderuar asambleistë,

Bazuar në Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale Nr. 03/L-040 dhe statutin e Komunës së Dragashit 01 Nr.06-103/1, të datës 11.09.2008, kam nderin dhe kënaqësinë që para jush të paraqes Raportin Vjetor Janar-Dhjetor 2022, për të arriturat, sukseset, angazhimet, por edhe sfidat dhe vështirësitë me të cilat është përballur Komuna e Dragashit gjatë vitit 2022.

Pas certifikimit të rezultateve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për raundin e tretë – përsëritja e votimit nga diaspora – filluam procedurat e konstituimit të Asamblesë Komunale. Me

datën 28.12.2021 zhvilluam seancën e betimit të Kryetarit të Komunës, me ç'rast iu hap rrugë konstituimit të organeve tjera përcjellëse, siç janë zgjedhja e Nënkyetarit, zgjedhja e Nënkyetarit për Komunitete, si dhe Drejtorët e Drejtorive Komunale.

Meqenëse Komuna e Dragashit në përbërjen e saj ka pjesëtarë të komuniteteve shqiptar, goran dhe boshnjak, me qëllim të përfaqësimit sa më korrekt dhe të drejtë të qytetarëve në institucionet komunale, edhe përbërja e Drejtorëve të Drejtorive Komunale reflekton përfaqësimin e të gjitha komuniteteve. Nga tetë drejtori komunale, katër prej tyre drejtohen nga komuniteti shumicë (Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport) dhe katër të tjera nga komunitetet joshumicë (Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike dhe Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Inspekcione).

Si rezultat i punës së përbashkët dhe bashkëpunimit të mirë brenda dhe jashtë institucionit, kemi arritur që të kryejmë pjesën më të madhe të objektivave programore. Që të jetë sa më transparente për publikun, Komuna e Dragashit përmes këtij dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'u dhënë mundësi qytetarëve që të njohin dhe vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Gjatë këtij viti kalendarik, organet ekzekutive të komunës janë angazhuar për një qeverisje komunale transparente, efikase, llogaridhënëse, gjithëpërfshirëse, me shërbime të shpejta për të gjithë qytetarët e komunës sonë, pa dallim.

Puna e Kryetarit të komunës është zhvilluar përmes tetë drejtorive dhe shërbimeve përcjellëse të komunës, si Zyra Lokale për Komunitete dhe Kthim, shërbimi i Kuvendit, Zyra e Prokurimit, Zyra për Barazi Gjinore, Auditori i Brendshëm etj. Në harmoni me legjislacionin në fuqi, udhëzimeve administrative dhe statutit të komunës, Kryetari i Komunës ka mbajtur 11 takime të bordit të drejtorëve dhe vazhdimisht ka përcjellur punën e drejtorëve, duke vlerësuar performancën e tyre dhe, përmes tyre, edhe të shërbyesve civilë në të gjitha nivelet në komunë.

Është siguruar nja ambient i qetë, tolerant, demokratik dhe bashkëpunues në mes të drejtorive dhe stafit, duke eliminuar çdo pakënaqësi apo pabarazi individuale dhe kolektive. Dialogu me palët dhe qytetarët ka qenë prioritet i imi. Përveç që janë pritur me qindra palë në zyrë të Kryetarit, gjithashtu janë mbajtur edhe takime me qytetarë në të gjitha lokalitetet, ku jemi njoftuar për së afërmi me kërkesat dhe prioritetet e tyre.

Planifikimi i buxhetit për vitin 2023 është bërë pas debateve që kemi pasur me qytetarë dhe, si rezultat i kësaj, buxheti është miratuar në mënyrë unanime, me votat e asambleistëve të të gjitha partive politike në Kuvend.

Një kujdes i veçantë i është kushtuar transparencës së punës së organeve të komunës, ku të gjitha vendimet kërkesat, shpalljet, thirrjet, raportet periodike të realizimit të buxhetit, janë publikuar në uebfaqen e komunës në të dy gjuhët.

Organet komunale janë angazhuar fuqishëm në rritjen e efikasitetit të shërbimeve komunale, si ato administrative, po ashtu edhe shërbimet e furnizimit, siç është uji i pijshëm. Pastaj investimet e ndryshme kapitale, ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit, rrugëve, transporti, menaxhimi i mbeturinave, ndriçimi publik, mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve etj. Sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve gjatë sezonit të dimrit, mbrojtjes së natyrës dhe ofrimit të shërbimeve sa më efikase shëndetësore, komuna ka shpallur thirrje publike për realizimin e këtyre shërbimeve.

Buxheti i aprovuar për vitin 2022 është realizuar në masën 95%. Sfidë ka qenë realizimi i buxhetit për investime kapitale, për shkak të problemeve të trashëguara nga qeveria e kaluar, siç janë projektet 2-3 vjeçare dhe mungesa e kompanisë për hartimin e projekteve.

Komuna, përmes Zyrës së Prokurimit, ka realizuar me sukses 168 projekte kapitale dhe furnizime. Si rrjedhojë e punës efikase të Drejtorisë së Urbanizmit, procedurave ligjore të tenderimit nga ana e Zyrës së Prokurimit, mbikëqyrjes profesionale të punimeve, vizitave të shpeshta të Kryetarit të Komunës nëpër vendpunishte, komisioneve profesionale për pranimin teknik të punimeve etj., është bërë një punë kualitative dhe e qëndrueshme.

Kryetari i Komunës ka vazhduar praktikën e takimeve, vizitave dhe bashkëpunimit me të gjithë, me qëllimin e vetëm që të bëjë diçka të mirë për komunën tonë. Së bashku me kryetarët e komunave të Kosovës kanë qenë në Turqi për të parë praktikën e avancuar të menaxhimit të mbeturinave. Në kuadër të programit për bashkëpunim ndërkuftar IPA, kemi vizituar Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe kemi nënshkruar memorandumimin e bashkëpunimit, ku ne si komunë lidere kemi konkuruar për projektin në programin IPA.

Kryetari i Komunës ka marrë pjesë në të gjitha takimet që i kanë organizuar organet qendrore, ministritë, institucionet ndërkombëtare, Asociacioni i Komunave etj. Zyrën e Kryetarit e kanë vizituar shumë investitorë të huaj, të cilët janë të interesuar që të investojnë në energji të ripërtëritshme, në blegtori dhe turizëm, por sfida ka qenë mungesa e tokës. Siç jeni në dijeni, 57% e territorit tonë është park nacional, pjesën më të mirë të tokës e menaxhon AKP-ja, ku lënda është në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Po ashtu, pjesën tjetër të tokës e menaxhon Agjencioni Pyjor i Kosovës.

Sfida më e madhe për ne është papunësia dhe rritja e kërkesave për ndihma sociale, ndihma për mjekim, barëra etj. Zyra e Kryetarit ka pasur të planifikuara 100 mijë euro për raste të tilla, të cilat kanë qenë të pamjaftueshme. Për bujqit dhe blegtorët viti që po e lëmë pas ka qenë sfidues, për shkak të dimrit të gjatë, krizës ekonomike, ngritjes së çmimeve të ushqimit për kafshët etj. Nga kategoria buxhetore e subvencioneve dhe transfereve, kemi ndarë mjete financiare në vlerë prej 90 mijë euro për të gjithë blegtorët e regjistruar, bletarët dhe kultivuesit e shpezëve. Gjithashtu, nga kjo kategori buxhetore kemi ndarë 10 mijë euro për organizimin e panairit të prodhimeve vendore – lokale.

Gjatë vitit të parë kalendarik në fokus ka qenë realizimi i programit qeverisës dhe në këtë drejtim janë bërë shumë investime në arsim, kulturë, rini dhe sport, në shëndetësi, infrastrukturë etj. Janë organizuar shumë manifestime kulturore, ngjarje sportive, janë bërë shumë shpallje publike, nga të cilat kanë përfituar shoqatat, klubet, organizatat joqeveritare, shoqëritë kulturore-artistike, shoqatat e veteranëve, pensionistëve, të gjitha lokale. Është mbajtur Festivali Folklorik-Burimor "Opoja Vallëzon" dhe për herë të parë në historikun e komunës janë mbajtur dy manifestime "Ditët e Diasporës", njëri në Brod dhe njëri te Liqeni i Breznes. Kemi ndarë 114 bursa për studentët e komunës sonë. Për Shoqatën "Jetimat e Ballkanit" kemi ndarë 40 mijë euro për ndërtimin e shtëpive të banimit për skamnorët.

Nën patronatin e Kryetarit të Komunës është bërë shënimi i të gjitha datave të rëndësishme: dita e shpalljes së Pavarësisë, Epopeja e UÇK-së, Dita e Dëshmorëve, Dita e Çlirimit dhe Dita e Flamurit. Kryetari i Komunës ka marrë pjesë në të gjitha manifestimet e organizuara me rastin e shënimit të ditës së shkollave. Gjithashtu janë vizituar në vazhdimësi të gjitha institucionet komunale, si qendrat mjekësore, shkollat, QPS, kompanitë regjionale, Policia e Kosovës etj. Me propozimin e kryetarit të Komunës, Asambleja Komunale me vota unanime ka shpallur qytetare nderi të Komunës së Dragashit zonjën Janet Reineck.

Sa i përket çështjes së sigurisë, komuna jonë ka qenë komunë e qetë dhe stabile, pa probleme të theksuara në aspektin e sigurisë së përgjithshme. Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës ka qenë në nivel, në kuadër të kompetencave dhe ligjeve në fuqi. Gjatë këtij viti kalendarik janë mbajtur 6 takime të KKSB-së, ku të gjithë akterët relevantë për çështje të sigurisë në komunën tonë kanë raportuar me shkrim.

Të gjitha aktivitetet dhe e gjithë puna e organeve komunale është përfshirë në raportin e tetë drejtorive, Zyrës për Komunitete dhe Kthim, Zyrës së Prokurimit, Zyrës për Barazi Gjinore, dhe janë pjesë përbërëse e punës së Kryetarit të Komunës.

Për prioritetet nuk do të flas, për arsye se është shty kjo pikë, dhe ekziston tabela e vendimeve të kryetarit, janë nëntë faqe, unë s'po i lexoj, ju i keni lexue të gjitha. Faleminderit!

Masi jam këtu edhe drejtori i Drejtoratit për Bujqësi nuk është kërtu, i nderuar kryesues më lejo që për një minutë ta lexoj edhe raportin e Drejtoratit për Bujqësi.

Në mungesë të drejtorit, i cili është në një udhëtim zyrtar, në pika shumë të shkurta, ky Drejtorat, përveç punëve rutinë që i ka bërë në nivel të bujqësisë, blegtorisë, inspektionit, pylltarisë, turizmit dhe zhvillimit rural, ky Drejtorat vitin e kaluar, për herë të parë nga buxheti komunal ka ndarë subvencione në vlerë 90 mijë euro për blegtorët. Gjithashtu, për herë të parë është mbajtur panairi i prodhimeve lokale vendore, i cili ka kushtuar diku 10 mijë euro. Unë, përveç punëve rutinore të cilat i keni në raport, i thashë vetëm dy punë të rëndësishme, dhe ata asambleistë të cilët duan t'i parashtrajnë pyetje drejtorit të Bujqësisë, mundeni përmes e-mailit të ia drejtoni pyetjet edhe ai ose ka me ju përgjigj në mënyrë të shkruar, ose në seancën e ardhshme ka me ju përgjigj. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, kryetar! Është mirë që mas këtyre dy raporteve na me e marrë ndonjë pyetje eventuale, ndonjë diskutim. Pas raportimit të kryetarit edhe pas çdo raportimi, ju të nderuar delegatë keni të drejtë me e shfrytëzue kohën e juaj për ndonjë pyetje të mundshme. Kush do me e marrë fjalën prej delegatëve?

Nedžmidin Sejdilar: Faleminderit për raportin gjithëpërfshirës, jam pjesërisht dakord me ju, megjithëse ka pasur disa gjëra ku më është dashur t'ju kritikoj për të stabilizuar disa gjëra. Si një takim me qytetarët. Ti ke një gjashtë nga unë, e ke kaluar këtë provim. Një fakt, drejtori i bujqësisë nuk është i pranishëm. Ju raportuat në emër të tij dhe thatë se ai do t'u përgjigjej pyetjeve tona me email. Kjo më vjen si një mashtrim. Sepse raporti i tij nuk përputhet me subvencionet e aplikuara me paratë e shpenzuara. Në faqen e parë thuhet se kanë aplikuar për 9796 lopë, 9724 dele dhe në faqen e dytë kemi subvencione shumë më të mëdha. Sa i përket pulave, janë aplikuar 4700 pula dhe janë paguar subvencione për rreth 8000 pula. Kur e llogarisim këtë fillimisht, del se dikush ka përvetësuar para këtu. Si mund të paguante subvencione për pulat që nuk ekzistojnë dhe nuk janë aplikuar. Unë insisto që kjo pyetje të përgjigjet nga kjo foltore ose ndoshta problemi është sërish në versionin e printuar. Ju keni 9796 dele dhe keni subvencionuar 9724. Vetëm dhitë e tij janë të sakta se është një numër dyshifror. Dikush hyri në garë me 82 dhi. Dhe u dhanë kaq shumë subvencione. Asgjë në thelb nuk pajtohet këtu. Ka përvetësim parash dhe dikush duhet t'i raportojë qytetarëve. Nuk mund të lejoj që paratë e qytetarëve tanë të shpenzohen në këtë mënyrë.

Uran Halimi: Faleminderit, zoti Sejdilar! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën. Fjalën e ka kërkuë zotëri Munir Jonuzi.

Munir Jonuzi: Është vërtet e lavdërueshme kur sheh që 95% e projekteve janë realizuar. Kur shihet se janë realizuar 168 projekte kapitale dhe prokurime. Mund të shihet se keni punuar shumë vitin e kaluar. Një konstatim, ndryshe nga viti i kaluar, këtë vit jeni shumë më të vigjilent sa i përket realizimit të projekteve kapitale. U nisët me punë në kohë. Shihet se keni organizuar ekipet tuaja dhe po dërgoni ekipe në terren, të cilat bëjnë matje dhe përgatiten për investime kapitale. Në këtë mënyrë nuk do të ndodhë situata si vitin e kaluar kur realizuam projektet në dhjetor. Një nga prioritetet që keni vendosur është transparenca, shpresoj që këtë vit të jemi shumë më mirë sa i përket transparencës krahasuar me vitin e kaluar. Ju përmendët edhe ndriçimin publik, pyetja ime është: a planifikoni të financoni ndriçimin publik edhe në fshatrat tona, jo vetëm në qendrën administrative. Sepse nuk është e drejtë me qytetarët e tjerë. Prioriteti tjetër që përmendët është zhvillimi i turizmit. Shpresoj që këtë vit më në fund të bëhet diçka për këtë dhe të krijojmë një zyrë apo departament turistik. Ne si komunë kemi vërtet diçka për të ofruar sa i përket turizmit, na duhet vetëm një strategji serioze. Si prioritet përmendët edhe krijimin e një plani zhvillimor. Pika kryesore e këtij viti është plani i zhvillimit që kemi, si dhe krijimi i hartave zonale. Shpresoj që më

në fund të bëjmë hartat zonale për komunën tonë. Në fund thatë se të gjitha materialet janë dorëzuar në dy gjuhë, zoti kryetar, në bazë të Statutit të komunës sonë, ne kemi tri gjuhë zyrtare në këtë komunë, shqip, serbisht dhe boshnjakisht. Ju lutemi përdorni termin tre gjuhë në të ardhmen. Faleminderit.

Uran Halimi: Faleminderit, zotëri Jonuzi! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën në lidhje me raportimin e kryetarit. Fjalën e ka kërkuë Shpetim Hajredini nga PDK.

Shpetim Hajredini: Faleminderit kryesues, përshëndetje i nderuar kryetar, të nderuar kolegë asambleistë, qytetarë të Komunës së Dragashit! Sa i përket raportimit të kryetarit, unë personalisht nuk do të kyçem fare, pasi besoj se ka qenë ajo që e raportoi kryetari, dhe e dimë se si ka arritur dhe ku është, do të thotë në përfundim të këtij viti. Personalisht i kam thënë edhe në fillim të mandatit që nëse arrin të punon dhe ta shpenzon buxhetin dhe ta merr grantin e performancës, unë do të jam i pari që do të uroj, prandaj unë fjalën e mbaj dhe për vitin e parë me të vërtetë ka arritur maksimumin e mundshëm të shpenzimit të buxhetit, shpresoj që kështu të vazhdojë edhe vitin e ardhshëm dhe qytetarët ta ndjejnë dorën ma afër edhe të arrijnë edhe ato mangësitë të cilat i kanë nëpër fshatra t’i evitojnë. Ajo për të cilën dua të diskutoj, pasi që e mori edhe përgjegjësinë kryetari, është Drejtoria e Bujqësisë. Pasi që drejtori nuk është tani, dua të ia parashtoj këto pyetje, nëse kие mundësi kryetar ti të përgjigjesh mirë, nëse jo, atëherë mbetet përgjegjësia dhe barra e drejtorit të Bujqësisë, Turizmit dhe Zhvillimit Rural që në seancën e ardhshme të kthejë përgjigjen. Unë tani do të kyçem pak te plani i punës i vitit 2022 dhe në kriteret – është mirë me më dëgjue pak çka po potencoj unë edhe jo me ndërhy, thashë plani i punës i vitit 2022 – dhe kriteret apo ato katër premtimet për të cilat ka dhënë premtime drejtori që do t’i realizojë apo do t’i ketë si primare; krijimi i kushteve të volitshme për investime në bujqësi dhe përpunim, përgatitjet për shfrytëzim sa më të mirë të mjeteve të ministrisë, fondeve të BE-së apo donatorëve, përmirësimi i kapaciteteve lokale të qeverisjes për t’i përgjigjur kompetencave që ka komuna në mënyrë sa më cilësore, sigurimi i përkrahjes direkte të bujqve në kuadër të mundësive vetanake. Mu ajo që po më intereson është e katërta, sigurimi i përkrahjes direkte të bujqve në kuadër të mundësive vetanake. Kjo në këtë plan të punës ka qenë si primare, tek raporti i punës nuk kam arrit ta identifikoj që është punuar diçka në këtë drejtim. Po shpresoj që tani prapë në planin e punës 2023 e ka si synim, besoj që këtë vit do punojë diçka në këtë drejtim dhe fermerët do ta marrin atë të cilën e meritojnë edhe nga buxheti komunal dhe jo vetëm nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë. Do të kaloj pak edhe te inspekcioni, ku besoj që vitin e kaluar, po besoj që është kompetencë e inspekcionit, keni pas një ankesë, në bazë të dhënave që i kam nga një bashkfshatar ii mi për problemin i cili është paraqitur këto vitet e fundit në bletari, apo më saktë bartja e familjeve nga qytetet tjera në qytetin tonë, ma konkretisht në fshatin tim, ku po bëhet bartja e një numri mbi 70 koshere bletësh, pa marrë leje – në bazë të informacioneve që i kam shumë të sakta – nga komuna, e që realisht një gjë të tillë nuk e lejon. Edhe patjetër ai person duhet ta marrë lejen nga komuna, nëse e lejon apo jo që ta bëjë bartjen e koshereve nga një qytet në qytetin tjetër. Ai këto vitet e

fundit nuk e ka bërë një gjë të tillë, pres që inspekcioni këtë vit të ndërmarrë masa, dhe nëse ndodh që ai person prapë ta bëjë një gjë të tillë, duhet të sanksionohet, përndryshe po detyrohem i ne si qytetarë të ndërmarrim masa, pasi që ato bletë të cilat sillen nga qytetet tjera janë shumë më të fuqishme se familjet e bletëve të cilat janë në rajonin tonë, për shkak të kushteve klimatike. Mbetet detyrë e ekzekutivit që të diskutojë me inspektionin, ta shoh ligjin në fuqi dhe të marrë masa nëse ndodh një gjë e tillë apo edhe të merret ndonjë vendim apo informim që, ata persona të cilët dëshirojnë të bëjnë një gjë të tillë, të marrin së paku leje në komunë dhe pastaj, nëse e lejoni ju, atëherë ne qytetarët s'kemi çka të ndërmarrim hapa të tjerë. Kaq kisha sa i përket Drejtorisë së Bujqësisë. Ju falemnderit!

Artan Loshaj: Përsëritet për të gjithë! S'po di tash a me fillue, se me kryetarin e pata, raportin i kryetarit. Kryetari edhe nënkryetari s'konguan këtu. Po presim.

Kryetar, të dëgjova me vëmendje për raportin, edhe pak a shumë më pëlqeu. Po unë i kam disa vërejtje shumë të vogla, për shembull, kur keni shtue këtu "është siguruar një ambient i qetë", ta kam thënë edhe dje, "tolerant, demokratik dhe bashkëpunues në mes të drejtorive dhe stafit". Kryetar, për ni vjet s'ke mund me e bo ti këtë siguri, këtë ambient të qetë, thuaj ma burrash pak, e kam gjet, se ja me PDK-në ka pas qetësi këtu ja me tjetër kënd s'ka mund me pas qetësi. E dyta, këtu me ujin e pijshëm, "organet komunale janë angazhuar fuqishëm në rritjen e efikasitetit të shërbimeve komunale". Profi Nexhë ma herët e tha që ndoshta për ndonjë fshat ke diskutue këtu konkretisht, Komuna e Dragashit, drejtori e shumë njerëz që jetojnë këtu ujin e pijshëm e blejnë. Nashta ke bo ndonjë sanim pak të bazenit, po s'është e mjaftueshme, shpresoj që ni ditë ma seriozisht pak të merrni, edhe qytetarët e qytezës së Dragashit të kemi ujë të pijshëm. Këtu më poshtë keni shkruar që keni realizuar 168 projekte. Më vjen mirë, i keni lavdëruar Zyrën e Prokurimit edhe Zyrën e Urbanizmit, ju e dini shumë mirë që me kauzën e këtyre, në kritikën e këtyre që s'po punohet mirë, e s'po punohet mirë, keni ardhë në pushtet, tash të njëjtit persona, të njëjtit punëtorë, të njëjtit drejtor, p'i livdojsh pak, unë e di që është politikë, veç pak ma javash, se shumë i ke ngrit, prit për ni vjet a dy, të shohim këto investimet që janë bo në dimër, me borë, edhe që janë bo, që jeni ngut mas tetorit m'i bo, të shohim pak ku jemi, domethënë, se për dy-tre muaj ato nuk prishen, të shohim 5-6 muaj a ni vjet a dy, e pastaj kah fundi i mandatit edhe m'u livdue atëherë na ka pak ma hije. Këtu pak më poshtë e ke shkruar që "mungesa e kompanisë për hartimin e projekteve". Është e vërtetë, dy vitet e fundit PDK në pushtet kemi punue me paramasa, kemi punue me...kush kemi mund kemi bo projekte, të njëjtin avaz jeni t'u e vazhdue edhe ju, domethënë këtë vit 2022 nuk keni pas hartues të projekteve. Kam dëgjue që sivjet e keni çelë ni konkurs për me konkurue, po hala nuk e keni bo. Domethënë është viti i dytë që jeni edhe ju me paramasa edhe me sende si PDK. Dhe në fund, keni ndarë mjete për OJQ të ndryshme, keni cekur edhe shumë, unë edhe dje ta kam thënë, ka premtue Zyra e Kuvendit që sot do të ma bjer edhe shumë, të kam pyet, me numër 25 dhe me numër 26, ku i ke mbështet OJQ-të e ndryshme, keni bo shumë mirë, kryetar, edhe është mirë me i mbështet, po për hir të transparencës kam qef me na dhënë ni njoftim, bon vaki sot e keni punë shumë me gabime teknike, e mos është edhe ky ni gabim teknik. Për shembull, në numër 25 thoë "kontratë për ndarjen e mjeteve financiare Komuna e

Dragashit – OJQ QENDRA’’, dhe shuma nuk është cek. Është mirë për hir të transparencës me na tregue sa mjete i janë ndarë kësaj qendre, si dhe me numër 26 ‘kontratë për ndarjen e mjeteve financiare Komuna e Dragashit – OJQ Demokratska Omladina Gora’’, është mirë, në qoftë se keni nda mjete, është mirë këtu me na dhënë një përgjigje përafërsisht sa mjete keni ndarë për këto dy OJQ. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Në lidhje me raportin e bujqësisë, Nedzmidin Sejdilar i lexoi disa mospërputhje në ndarjen e subvencioneve. Është fjala për dy lloj subvencione; subvencionet që i ka nda Qeveria, edhe aty është raportue sa fermerë kanë aplikue, po normal kanë aplikue por nuk i kanë marrë të gjithë, edhe janë konë subvencionet që i kemi nda na, Komuna e Dragashit. Sa i përket, Munir Jonuzi e boni për transparencën, unë mendoj që ka mund të ketë ndonjë lëshim vitin e kaluar, por jo me qëllim, ndonjë harrësë, po megjithatë urdhëri ka qenë që të gjitha punët që kryhen në komunë, të gjitha vendimet të qiten në ëebfaqen e komunës, në Facebook-in e komunës, edhe ato normal në dy apo tri gjuhë, qysh dona mujm me i thonë, edhe unë mendoj që në këtë drejtim ka pas avancim, në fillim ka pas disa lëshime, është e vërtetë që dikush ka reague edhe ka reague me vend, unë e kam thënë çdo herë, kritikën me vend i pranoj. Sa i përket agroturizmit dhe zhvillimit të turizmit, unë e përmenda edhe në raport që kemi konkurue në Programin IPA dhe dje na ka ardhë njoftimi se projekti jonë me të cilin kemi konkurue në IPA, e ka kalue fazën e parë dhe na kanë lënë kohë deri në prill me e përgatit projektin detal edhe me e çue me e dorëzue. Sa i përket ndihmës së bujqve, sigurisht që në plan të punës ka qenë që të ndihmohen bujqit, po bujqit e di që janë kategori tjetër në krahasim me blegtorët, po nuk ka blegtori të ndame apo bujqësi pa blegtori. Kështu që në këtë drejtim, mjete të mjaftueshme për ndihmën e bujqve, na të hyra tonat nuk kemi pas, t’u marrë parasysh se gjendja financiare e fermerëve vitin e kaluem ka qenë shumë e rëndë, na jemi orientue që t’i subvencionojmë fermerët që bartjen e bletëve, sigurisht ju do të merrni me të, dhe është vërtet një propozim me vend, se me ardhjen e atyre bletëve këtu ata mund të bien edhe sëmundje, edhe për atë duhet edhe të merret leja nga komuna. ‘Është siguruar një ambient i qetë’, unë nuk kam thënë se e kam gjet një ambient jo të qetë, po unë kam krijuar një ambient të qetë, si kryetar i komunës, nuk kam ardhë këtu si kryetar i LDK-së, prej partisë, po unë jam sjellë me punëtorët, me stafin që e kam gjet, si kryetar i komunës, i të gjithëve, edhe kam raporte jashtëzakonisht të mira me të gjithë, edhe unë i falënderoj ata, kanë bashkëpunue me kryetarin edhe me të gjithë drejtorët, edhe për atë edhe kemi pas sukses, sukcesi është i përbashkët. Dhe, nashte keni degjuë, po unë edhe po ju them që asnjë masë administrative ndaj asnjë punëtori nuk e kam marrë, asnje largim nga puna, asnje ndryshim të pozitës, në komunë po flas. Sa i përket ujit të pijshëm, unë edhe dje të raportova që në bashkëpunim me ‘Hidroregjionin’ kemi financue, edhe komuna ka marrë pjesë në financim edhe ‘Hidroregjioni’, bashkarisht kemi punue në përmirësimin e kualitetit të ujit të pijshëm në Komunën e Dragashit. Edhe vërtet është bërë një ndryshim i mirë por jo i mjaftueshëm. Unë kam pas disa takime me ‘Hidroregjionin’, edhe jemi marrë vesh që këtë vit ‘Hidroregjioni’ me inxhinierët e vet ta përgatite projektin për ndërrimin e rrjetit të ujësjellësit në Komunën e Dragashit. Posa të bëhet gati projekti, edhe sa të shihet vlera e projektit, atëherë na do të fillojmë me kërkimin dhe gjetjen e investitorëve edhe mjeteve financiare. E njëjta vlen edhe

për 168 projekte, është me rëndësi kush i udhëheq këta njerëz, këta njerëz janë njerëz të mirë, punëtorë, njerëz të kualifikuar, por nëse nuk kërkon punë nga ata, ata nuk punojnë. Unë kam kërkuar punë, kam kërkuar disiplinë, kam gjet bashkëpunim, edhe asnjëri prej këtyre që unë kam kërkuar punë nuk e ka refuzuar asnjë obligim të punës. Sa i përket lëshimit që ka ndodhë në Exel, të 'QENDRA' janë nda 2 mijë euro, kurse të 'Demokratska Omladina Gora' 3,950.00 euro. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Drejtori juaj i bujqësisë shkruan dhe thotë nga buxheti i komunës. Në faqen e dytë të raportit të tij thuhet nga buxheti komunal dhe jo nga ministria. Tjetër gjë, me pulat, pa marrë parasysh buxhetin nga ministria apo nga komuna, nëse një fermer ka aplikuar me 4800 pula, pse subvencionoheni për 7730 pula. Apo është një gabim teknik.

Mehmet Spahiu: Përshëndetje kryetar, përshëndetje kryesues, asambleistë të nderuar! Po i drejtohem kryetarit të komunës. Kryetar, në raportin tuaj të cilin na e keni lexuar, jeni treguar shumë modest edhe shumë i shkurtër në raport me punët të cilat i ke bërë. Nuk po e shprehi opinionin tim, por po e shprehi opinionin e shumë qytetarëve, që gjatë vitit 2022 janë bërë shumë nga ana juaj dhe e stafit tuaj. Ajo që më intereson mu, besoj që edhe qytetarëve u intereson, është çështja e tokës bujqësore, e theksuat edhe vetë që 22 mijë hektarë ka 20 vite të pashfrytëzuara. Kjo çështje është kontestuese në Dhomën e Posaçme në Gjykatën Supreme, nëse ka mundësi sot ose në mbledhjen e ardhshme me ra në kontakt edhe me marrë sqarime deri sa duhet të presë komuna jonë që kjo çështje të zgjidhet, edhe e tërë ajo sipërfaqja e tokës të vihet në shfrytëzim, duke marrë parasysh se blegtorët dhe bujqit tanë kanë shumë kërkesa. Çështje tjetër, në raportin tuaj theksohet çështja e furnizimit të 16 fshatrave me ujë të pijshëm. Ju i keni bërë kërkesë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Ambasadës së Suedisë, nëse ka mundësi na tregoni deri ku ka arrit kjo çështje dhe a pritet sivjet të fillohet realizimi i investimit për furnizimin e 16 fshatrave me ujë të pijshëm. Keni theksuar në raportin tuaj se janë bërë disa kërkesa për asfaltimin e rrugës përreth Lumit Plava, për t'u lidhur komuna jonë me Kukësin, mundësisht ndonjë informacion a keni ndonjë mbështetje nga qeveria dhe ministrinë përkatëse, apo mendohet të realizohet me mjete të komunës. Meqenëse drejtori i Arsimit edhe i Kulturës ende nuk kanë raportuar, po e shfrytëzoj të drejtën t'i parashtoj ni pyetje drejtorit të Arsimit, z.Selim Kryeziu, a ka debatuar dhe a mendon të debatohet ose të analizohet Drejtoria e Arsimit çështjen e funksionimit të shkollës së re, e cila ka mbi 10 vite që ka mbetur pa shfrytëzuar. Ndërsa drejtoreshës së Kulturës dy pyetje: në raport është theksuar ndërtimi i bibliotekës komunale, a do të ndërtohet në vendin ekzistues apo do të caktohet ndonjë lokacion tjetër, dhe, znj.drejtoreshë, a keni ndonjë informacion se a do të vazhdohet me ndërtimin e palestrës sportive, e cila ka mbi 10 vite që ka mbetur pa u realizuar. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, i nderuar! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën? Jo, e kemi zyrtarin e bujqësisë këtu që do me e marrë fjalën, të na jepe ni sqarim.

Flamur Sylejmani: Përshëndetje për të gjithë! Meqë drejtori nuk është këtu, do të mundohem, me sa kam mund me e kuptue pyetjen e deputetit Nedzmidin, sa i përket numrit të pulave vojse që janë subvencionue nga Komuna e Dragashit, na ju njoftojmë se në Ministri të Bujqësisë ka qenë kriteri për aplikim deri në 2 mijë pula vojse, dhe atë kriter fermerët tjerë nuk kanë mund me e arrit, veç ni fermer dhe ai me 4 mijë e 700 pula, dhe ai është Bajram Jahja nga Orqusha, dhe është subvencionue nga Ministria e Bujqësisë, ndërsa tre fermerë të tjerë, Gazmend Tairovci, Syzana Skenderi edhe Arbërie Durmishi janë subvencionue, domethënë të katër këta fermerë, nga Komuna e Dragashit, ku të gjithë kanë 4 mijë e 800 pula, 7,730 pula nga 0.20 cent që i bie 1,546 euro. Kriteri në komunë ka qenë 500 pula vojse, kriter minimal për aplikim, dhe ata e kanë plotësue kriterin minimal, kanë aplikue edhe kanë qenë përfitues të subvencioneve komunale, ndërsa në ministri nuk kanë mund, s'kanë pas numër të mjaftueshëm për me aplikue. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, i nderuar! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e ftojme drejtorin tjetër të radhës, kushdo që munden, që është i gatshëm. Këtu në radhë është drejtori i Administratës, po nëse gjeni mirëkuptim, mundeni me e ndërrue. Okej.

Selim Kryeziu: Faleminderit! Përshëndetje kryetar! Faleminderit kryesues që pate mirëkuptim! Po mundohem të je mi shkurtë. Fillimisht po tregoj sfidat që kemi pas. Në Drejtori të Arsimit kam ardhë në janar të vitit të kaluar, kam pas gjithsej dy punëtorë dhe gjithë puna është dashtë të menaxhohet me këta dy punëtorë. Ka qenë ni prej sfidave. Sfidë tjetër ka qenë greva, e cila e ka çrregulluar krejt Kosovën. Kontrata kolektive na ka nxjerrë dhe vazhdon të na nxjerrë probleme, sepse ju e dini problemin mes qeverisë dhe SBASHK-ut, dhe shpeshherë përmbaruesit privatë normalisht që s'na pyesin fare, i shtin duart në buxhet dhe na i marrin parat, ashtu siç na ka ndodhë edhe me rastin e bursave. Do të na xjerrë prapë vështirësi, sepse nuk kemi ende të dhëna të sakta sa sa lëndë janë krye dhe sa duhet, s'e dimë edhe sa ka borxh në këtë drejtim. Qeveria lokale, as ajo e kaluara as kjo e tanishmja këtu s'ka të bëjë asnjë gjë fare. Problem është, ose së paku deri më tash problem kanë qenë procedurat e rekrutimit të mësimdhënësve, janë të stërzgjatura, deri në tre muaj, nuk mund të punohet me të njëjtin princip si në administratë, si në arsim, sepse aty nxënësit nuk presin. Ligji ka ndryshuar dhe tani e tutje do ta kemi më lehtë në këtë drejtim, procedurat janë të shkurtuara, nuk vlejné ato procedurat që vlejné për punëtorët të cilët punësohen në administratë. Punë janë bërë mjaft, unë po e përmendi të parën që s'kam mundur ta bëjë, në mungesë të stafit, ndoshta edhe si drejtor i ri, se pavarësisht që kam punuar 22 vjet në shkollë, menaxhimi i drejtorisë është një çështje krejt tjetër – krejt tjetër jo normalisht, mu më ka ndihmuar 22 vjet që kam punuar në arsim – nuk kemi mundur të ndikojmë në cilësi, Drejtoria nuk ka mundur të bëjë ndonjë punë në këtë drejtim. Sivjet po, e kemi në plan dhe prej tash po ju them, ju lutem lexone me kujdes planin dhe ta bëjmë një debat konstruktiv lidhur me planin e punës në arsim. Arsimin e kemi në krizë, e ka në krizë krejt Kosova, prandaj ju lutem lexoni me kujdes edhe ta bëjmë një debat konstruktiv. Çështja e raportit, një gjë që është bo është që përfundimisht Drejtoria e Arsimit ka një arkivë të veten, përfundimisht të gjithë mësimdhënësit, punëtorët e arsimit kanë kontrata, kanë dosje, secili mësimdhënës ka dosje, që nuk ka qenë tash, dosje individuale për secilin. Investimet

kapitale, për besë jemi munduar shumë, seriozisht, po të shohim lot 1, lot 2, lot 3, ritenderim etj.etj. Kemi pas shkollë që kemi hy me 20 mijë, kompania ka hyrë me 30 mijë, nuk kemi lënë që ato paret m'u kthye mbrapsht, e kemi shpallë edhe ni herë. Kjo na ka ndodhë në Bellobrad, kjo na ka ndodhë në Restelicë, kjo na ka ndodhë në Pllajnik, na ka ndodhë në Zym, na ka ndodhë pothuajse në të gjitha shkollat. Gati për secilën shkollë. Kryetari me të drejtë tha edhe Zyra e Prokurimit, seriozisht ka punue, këta pastaj të Urbanizmit plotësisht i kënaqur me punimet nuk jam as unë, por që Zyra e Prokurimit ka punuar dhe është për t'u lavdëruar, kjo është absolutisht e saktë, gjithë këto tendere, thashë secila shkollë dy ose tri herë ka shkue në tender. Tash shikoni, të gjitha shkollat të cilat kanë qenë të parapara për investime nga qeveria e kaluar, janë bërë në këtë vit, sepse është normale, sepse ka qenë parashikimi i buxhetit i vitit kaluar. Pa bërë asnjë kapërcim. Dallimi ndoshta mund të jetë në faktin që ne seriozisht kemi qenë pak më aktivë në këtë drejtim, ndoshta edhe si të ri të ardhur në pushtet. Nuk kemi lënë paret me na hup, po ju lutem, projektimet kanë qenë tuajat, të qeverisë kaluar. E vetmja që s'ka qenë e parashikuar dhe që është bërë është shkolla në Pllajnik edhe shkolla në Zym. Këto dy shkolla janë bë duke iu falënderuar donacionit apo grantit nga MZHR, duke iu falënderuar kryetarit Bexhet Xheladini. Këto dyjat kanë ato që s'kanë qenë të parapame, përndryshe renovimi i shkollës në fshatin Brod, histori në vete kjo, pas një tenderi të suksesshëm dhe pas një punimi katastrof ku na është dëmtuar edhe shkolla, Nexha ka shfaq shumë shqetësime për këtë dhe ka qenë shqetësuese situata, sepse përveç se nxënësit kanë mbet keq, përveç se pullazi u dëmtue, na kishim rrezik që të na shkojë krejt shkolla, sepse është hapur. Shkolla e Brodit ka qenë problem, është një diçka shumë e keqe që na ka ndodhë, deri në atë shkatërrimin komplet të shkollës, sepse pa pullaz ju e dini që futen pastaj bora, shiu, megjithëse sivjet ka qenë dimri i mirë, po këtë na s'mund ta parashikojmë. Fatmirësisht, duke iu falënderuar në fillim OSBE-së, ata kanë kontaktuar të parët me mua dhe unë kam kërkuë ndihmë. Përveç presionit politik prej opozitës, ishte vërtet një problem, se po shkon shkolla dëm, na ka ardhur në ndihmë CIMIC-u dhe e ka bërë një punë të mrekullueshme, nga diçka shumë e keqe në fillim, përfundoi jashtëzakonisht mirë. Renovimi në shkollën e Restelicës gjithashtu dy herë, në 'Sezai Surroi' gjithashtu, në Zlipotok, ndërtimi i pllakës dhe kulmit në shkollën fillore '28 nëntori', ndërtimi i fasadës dhe renovimi i shkollës 'Shaban Shabani' në Plavë, renovimi i shkollës fillore në Zaplluxhe – dy herë edhe në Zaplluxhe ka shkue në tender – ndërtimi i ngrohjes qendrore në 'Svetlost' dy herë, ndërtimi i fasadës dhe renovimi i shkollës 'Ulina' Kosavë dy herë, renovimi i shkollës Pllajnik dy herë, MZHR në bashkëpunim me Komunën e Dragashit, e Zymit gjithashtu dy herë, dy tendere për ni punim, lyerja e shkollës 'Shaban Shabani në Brezne, instalimi i kamerave në shkollën 'Shaban Shabani' në Llopushnik, renovimi i shkollës '9 Maji', renovimi i shkollës 'Ilmi Bahtijari', renovimi i shkollës 'Ilmi Bahtijari' Zaplluxhe prapë, ngjyrosja në shkollën 'Ruzhdi Berisha', këtu s'ka pas mjete të ndara, edhe rregullimi i kalldajës gjithashtu s'ka pas mjete të ndara, aty jam jashtëzakonisht i pakënaqur me qeverisjen tuaj zotëri, sepse katër vjet nuk keni investuar asnjë euro në shkollën e mesme, unë kam ndarë 65 mijë por nuk jam të mjaftueshme, nuk mund të reduktojë tani të gjithë buxhetin në 'Ruzhdi Berisha', katër vjet zero euro, nëse është edhe kjo që po bëj politikë, ndoshta pak jam emocional, hallall jau bëftë Zoti. Renovimi i shkollës 'Fetah Sylejmani' në Shajne, Restelica faza e dytë, nxemja qendrore në Krushevë. Të gjitha ato

shkolla që nuk kanë qenë të parapara, të gjitha janë të parapara në planin e punës për vitin i cili po vjen. Me fokus të veçantë do të jetë shkolla në Buqe dhe shkolla në Brrut, edhe shkolla në Zgatar. Do ta kemi shpejt çerdhen. Prej momentit që kam ardhë drejtor kam mendue për atë shkollë. I pari problem në atë shkollë është rruga autobusi i nxënësve nuk futet në atë rrugë, rruga nga Shajnja këtu, ajo atje kah mali harrone, ajo është rrugë verore. Kjo rruga këndeje gjithashtu është e rrezikshme. Ajo që mua më frikëson është numri i nxënësve. Nuk do shumë investime, shkolla është e mirë, po numri i nxënësve po na bjer. Nuk ndërlihet ju lutem, me shkollën e mesme, sepse ne nuk kemi në shkolla fillore, nëse ne nuk kemi nxënës në shkolla fillore, ku po presim. Prandaj po them, deri më tash veç me mendje, nuk kam guximin t'i hyj, e kam bisedue edhe me kryetarin këtë çështje, është pak problematike. Tjetër nuk e di nëse kisha ndonjë pyetje. Okej, faleminderit, po pres.

Uran Halimi: Faleminderit, drejtor! Fjalën e ka kërkue zotëri Nexhat Selaj, pas tij zotëri Nedzmidin Sejdilar.

Nexhat Selaj: Faleminderit edhe ni herë! Desha të kyçem drejtpërdrejt me drejtorin e Drejtorisë për Arsim. Flasim pa rezerva, pavarësisht pozicionit të drejtorit, flasim në atë kuptimin që sa më mirë të punojmë bashkërisht për arsimin. Në faqen 7 te çështjet tjera te paraqitja tabelare e aktiviteteve, keni përfunduar se realizimi i proceurave të përzgjedhjeve të operatorëve të furnizimit me lëndë djegëse dru, thëngjill, breket apo pelet, në muajin e shtatë dhe në muajin e tetë. Drejtor, je i informuar se peleti në shkollën fillore në Dragash ka ardhë në muajin dhjetor, me 15 dhjetor. Furnizimi me dru djegëse, mirë e paske komentue, në muajin e dhjetë dhe në muajin e njëmbëdhjetë. Nëse shiqojmë planin e punës, ju keni pretenduar se në muajin qershor dhe në muajin korrik do të kryhet furnizimi me dru nëpër shkolla. Falë kushteve meteorologjike të cilat na morën këtë vit, ne arritëm të shpëtojmë këtë kohën e vjeshtës, edhe acar nuk kishte, drutë u sollën në muajin e dhjetë dhe në muajin e njëmbëdhjetë. Nuk e di a je në dijeni se parashkollorët në Dragash tri javë, shkak i mungesës së ngrohjes, nuk kanë vazhduar mësimin, kjo si pasojë e ardhjes me vonesë e peletit. Unë po e kuptoj Zyrën e Prokurimit, po i kuptoj të gjitha, por këtu njëfarë informacioni duhet të na japësh. Kemi edhe çështje tjera të cilat ju, ato të cilat i keni arritur, për çfarëdo lavdate, nuk do të hyj në detaje. Investimet të cilat ju i keni bërë edhe jeni munduar t'i bëni, aq sa keni mund t'i arrini, nuk do të kundërshtoj, e mira është e mirë, kurse këto elementet negative duhet t'i luftojmë së bashku. Ditëve të fundit, si pikë tjetër, nëpër shkolla kemi pas pak edhe dhunë. Nuk na raportove për dhunën nëpër shkolla, a ke marrë masa apo ku keni arritur deri te këto procese. Për planin vjetor 2023, masi s'e kemi do të flasim herave të tjera. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, zotëri Selaj! Drejtor, nëse mundesh mbaj shënime për pyetjet, edhe në fund i përfshijsh, t'i shterojmë pyetjet ni herë.

Nedzmidin Sejdilar: Përshëndetje, ju vetë përmendët se kam ngritur shumë pluhur për atë çati në shkollën në Brod dhe thatë se ka pasur vështirësi dhe se falë bashkëpunimit të OSBE-së dhe KFOR-it është rregulluar ajo çati. Mirëpo, shoh që ju keni faturuar qytetarët e komunës sonë për atë çati. Nëse ka qenë donacion i OSBE-së dhe KFOR-it që ka riparuar çatinë e shkollës fillore në

Brod, atëherë pse i keni paguar kompanisë 17,993 euro. Janë para të qytetarëve tanë, ne nuk mund të shpenzojmë para. Nëse kompania nuk e përfundonte punën për të cilën i kemi paguar. Për shkak të asaj kompanie që ka konkurruar në tender dhe ka filluar të bëjë punën e saj nga pakujdesia, asaj objekti është hequr kulmi, pastaj kemi pësuar dëme të tjera materiale dhe në fund KFOR-i na e riparoi çatinë dhe ne e paguajmë kompaninë. Nëse është kështu, atëherë është shumë e lehtë për tenderët. Të gjithë do të konkurrojmë, nuk do të bëjmë asgjë, do të thërrasim KFOR-in për të dhuruar dhe do t'i marrim paratë. Ky është përvetësim i pastër parash. Mendoj se kjo është për prokurorinë. Unë e kam seriozisht këtë çështje, sepse këtu kemi një përgjegjësi serioze, në ditën e gjykimit do të pyetemi se pse lejojmë të keqpërdoren paratë e qytetarëve tanë. Këtu janë shpenzuar 17,993 euro, dhe çatia është në faturë si donacion. Që çatia llogaritet si donacion thuhet edhe në raportin në zyrën e komunitetit, ku kreu i zyrës së komunitetit disi mburret se ai së bashku me kryetarin tonë e kanë siguruar atë donacion. Kjo është e papranueshme. Nëse dikush dhuron një çati dhe ne paguajmë dikë nga Podujeva, mendoj se kjo duket e palogjikshme. Në fund të fundit, duhet të kishit nisur një proces në gjykatë kundër kompanisë që konkurroi në tender dhe fitoi atë tender. Më intereson edhe një informacion, nxënësit që vijnë shkollën fillore nga Krstaci i Rapqe, nëse kanë transport të siguruar nga drejtorja juaj.

Uran Halimi: Faleminderit, zoti Sejdir! Fjalën e ka kërkuar zonja Afrore nga Vetëvendosje.

Afrore Vejseli: Faleminderit, zotëri kryesues, të nderuar kolegë asambleistë, i nderuar drejtor i Arsimit! Do të mundohem që me pak fjalë t'i jap disa mendime për raportin e planit, më konkretisht në lidhje me arsimin. E para, në raportin e këtij plani, u tha që janë mbajtur disa aktivitete apo ligjërata që janë organizuar nga zyra e komitetit të stacionit policor në Dragash, me temën 'vetëdijesimi mbi rreziqet nga lëndët narkotike', që më vjen mirë shumë që mbahen këto ligjërata, sepse normal që janë të nevojshme. Atë që unë dua ta përmendi dhe besoj që është edhe një rrezik tjetër, është ai i komunikacionit. Thuajse se të gjithë shkollat e komunës tonë nuk kanë asnjë shenjë sinjalizuese apo zebra ku mund të kalojnë fëmijët. Prandaj do ishte mirë që komuna apo edhe organet gjegjëse të bëjnë diçka në këtë drejtim. Po në këtë plan janë paraqitur edhe disa sfida që ju jeni përballur gjatë vitit 2022, të cilat janë përfshirë në pesë pika. Është mungesa e stafit të DKA-së, është greva e SBASHK-ut, zëvendësimi i personelit arsimor, rënia e numrit të nxënësve, është edhe problemi i pagesës së shujtave. Unë po mendoj se mungesa e stafit të DKA-së nuk është e kohës së sotme, por ju si drejtor është dashur që t'i jepni një përparësi plotësimit të stafit të DKA-së, po ashtu edhe personelit arsimor, dhe të mundoheni të gjeni procedura që t'i shmangni zvarritjet e plotësimit të stafit. Pra, sipas mendimit tim, kjo po që është sfidë, por është edhe mungesë e punës tuaj. Ndërkaq, sa i përket grevës, unë mund ta kuptoj të drejtën e mësuesve për ngritje pagash, sepse vërtet është një nevojë, mirëpo nuk mund ta kuptoj DKA-në dhe kryetarin që të drejtat e fëmijëve për shkollim të mos marrin asnjë veprim. Greva nuk ka qenë sfidë për ju, sepse nuk keni bërë asgjë në këtë drejtim, greva përfundoi ashtu siç përfundoi, pasojat i barten fëmijët tanë për humbjen e mësimit. Edhe zëvendësimet që i keni bërë pastaj, ato nuk kanë qenë të njëjta në të gjithë shkollat. Ndërkaq, problemin e pagesës së shujtës unë po e them me një fjali: është

mirë që të pritni edhe pak, se edhe një pjesë ka vdekur, kështu që edhe shuma ju zvogëlohet. Ju faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, zonja Afrore! Dikush tjetër, e ka fjalën zotëri Samidin Xheladini.

Samidin Xheladini: Të nderuar të pranishëm! Në mandatet e kaluara kam qenë edhe jam angazhues si në kritika, ashtu edhe në sugjerime, këshilla dhe kemi qenë bashkëpunues në lidhje me raportin. Po dorën në zemër, nuk deshta të dal, po pasi që nuk është kryetari, unë dola. Është mirë të mirën me respektue ndërsa të keqen me e parandalue. Së pari dua ta falënderoj kryetarin e komunës dhe qeverinë komunale për përpilimin e këtij raporti mjaft voluminoz, ku në mënyrë të detajuar shpjegohen hargjimet, investimet, punët, planet, aktivitetet etj. Thuhet se buxheti i vitit 2022 është realizuar në masën 95%, kurse sfidë ka qenë realizimi i buxhetit për investime kapitale, ku janë realizuar 168 projekte. Çka deshta me theksue, ma shumë që më shtini me dalë, ka pasur interesim të madh nga shumë investitorë të huaj, që janë të interesuar të investojnë në energji të ripërtëritshme, në blegtori dhe turizëm. Pikërisht këtu deshta të dal, na si qeveri edhe si komunë edhe mandatet e kaluara i kemi pas disa prioritete, ka qenë blegtorja, bujqësia, turizmi dhe energjetika. Çka na ka ndodhë me ni mandat të kaluet, kemi bo ni gabim shumë fatal, që 57% të territorit e kemi shpallë park nacional. Ia kemi qit lakin vetit. Tash ai park neve mund me na parandalue në zhvillim. Gjithashtu, pjesa tjetër, ni gabim që u bo në ish-sistem, ku edhe ajo duhet të korrigojohet, ku pjesa më e madhe e tokës që ka qenë pronë e komunës, ia kanë dhënë ‘Sharrprodhimit’ dhe pastaj AKP e menaxhon, edhe neve kjo na ka bo ni pengesë shumë të madhe për investime. Atëherë qeky Kuvendi ka vendosë, ka qenë atëherë Salim Jonuzi dhe Lulzim Rifaj kryesues, kemi vendos na me unanimitet që me na kthye pronën, po nuk po na kthejnë dhe fatkeqësisht lënda është në gjykatë. Tash për qeverinë i kam disa sugjerime, që të ketë parasysh transparencën dhe llogaridhënien, minimizimin dhe çrrënjosjen e korrupsionit, realizimin e projekteve me punë kualitative në investime kapitale dhe në masën e filluar si në vitin 2022, edhe mos bini nën 25%, po ma shumë se m’doket po vonoheni, dhe uljen e hargjimeve të panevojshme. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit shumë, zotëri Xheladini! Fjalën e ka zotëri Munir Jonuzi.

Munir Jonuzi: Përshëndetje të gjithëve, ky është një raport shumë gjithëpërfshirës me më shumë ekspozim. Për të mos folur për planin për këtë vit, edhe pse është një drejtori me shumë punë dhe sigurisht që duhet të punohet shumë sepse arsimit duhet të jetë prioritet për të gjithë ne këtu. Arsimit duhet të merret nga njerëz kompetentë me shumë punë dhe përvojë në arsim. Duhet të punësohet numri maksimal i punonjësve në mënyrë që gjithçka të bëhet në kohë. Kur flasim për stafin në arsim, ankesa e vetme është se ende nuk është plotësuar pozita e koordinatorit për mësimin në gjuhët joshumicë. Të gjithë ata që punojnë në arsim pyesin avokatë të ndryshëm për shyajtje. Juristët flasin dhe rekomandojnë në zhargon që të shtrydhim organet ekzekutive apo kryetarin e komunës për të marrë një vakt të ngrohtë.

Dhe gjithçka na tregon se në njëfarë mënyre komuna po bllokton pagesën shlytje, do t'ju lutesha ju drejtorëve para kolektivit të shihni se çfarë po ndodh dhe nëse këto rekomandime kanë bazë. Shpresoj që konkurset e detyrueshme të shpallen në kohë, që të mos përfundojmë në të njëjtën situatë si vitin e kaluar. Në raport kemi mjete të caktuara të ndara për libra në gjuhën shqipe, pasi që tashmë kemi kërkuar tituj në gjuhën boshnjake, më intereson nëse edhe ju jeni përballur me këto probleme dhe nëse kemi mundur të realizoni blerjen e librave në gjuhë boshnjake, faleminderit.

Uran Halimi: Faleminderi, zotëri Jonuzi! Fjalën e ka zotëri Artan Loshaj.

Artan Loshaj: Drejtor, ma herët na shpjegove krejt, të dëgjova me debatet e kolegeëve, unë nuk jam shumë i thirrur në arsim, profi Nexhat e diskutoi ma gjerë e gjatë, po me rëndësi që më detyrova me dalë ishte sfida rënia e nxënësve në shkollat fillore si dhe në shkollat e mesme. Këtu ma herët e pate bo ni premtim por nuk ishte elektoral, që këta nxënës të subvencionohen vitin e parë 50% ndërsa gjatë mandatit të juaj do të subvencionohen 100%, për arsye se pas shkollës fillore mbi 50 % e nxënësve migrojnë për Prizren, disa edhe shkojnë jashtë, dhe sfida ka qenë edhe për neve edhe për ju që këta nxënës më së paku të mund të subvencionohen që me mund me i ndalë në Dragash, se përndryshe shkollat tona, profesorat tonë kanë me mbet pa nxënësia edhe s'kemi nesër edhe çka me diskutue. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, zotëri Loshaj! Dikush tjetër nëse dëshiron me pyet diçka në lidhje me raportin e drejtorit të DKA-së? Nëse jo, atëherë drejtori ka me na dhënë përgjigje në lidhje me pyetjet e parashtruara.

Selim Kryeziu: Faleminderit shumë për pyetjet, po shpresoj se mos të harroj ndonjërin, nëse eventualisht harroj...Furnizimi me dru dhe pelet, absolutisht e saktë, kemi pas vonesa. A kam faj unë, tash dikush mbase edhe ka, po e shpjegoj për të larë veten. E njëjta kompani me çmime të ndryshme ka konkuruar. Pesë furnitorë janë tërhek, o Nexhë. Për besë nuk e kam për m'u la, infarkt po më bëjnë. Ju bëni opozitë, na bëjmë pozitën. Unë veç një gjë po ju them, unë s'kam kurgjë kundër kritikave të juaja. Sejdilari e ka problemin se ai vetë pyeten vetë përgjigjet, fjalën e fundit e thotë të parën. Prandaj nuk më pëlqen, nuk e kam problemin unë me debatue, se gjërat janë kështu si janë. Jemi vonue Nexhë, e peletit absolutisht e saktë, nga 45 euro ka shkuar 500 euro, 200 euro a sa ka qenë. E ka marrë kompania, është tërhek kompania. Kjo lëvizja e çmimeve që ka ardhë si rrjedhojë globale, na ka nxjerrë vështirësi. A kemi mund t'i evitojmë, po. Nuk kam mund me arrit ma shumë, kërkoj falje për këto lëshime, po kaq kam mund. E saktë ajo që the ti, për që kemi kritikue, thashë edhe ju kritikoni tash. Duna nëpër shkolla, na i kemi të evidentume, masat janë marrë, ni masë tjetër është marrë, tash e kemi dhe ni ma të fundit, po s'është e 2022, është e 23-tës. Përveç masave që merr drejtorja, unë s'kam dashtë t'i pasqyroj në raport, ndoshta kam bërë gabim, mund t'i plotësoj, për dhunën që ka ndodhë nëpër shkolla, ka pas, raste ekstreme edhe nuk mund të themi, por gjithsesi ka pas. Prokuroria, policia e kanë bo punën e vet, ne kemi marrë ato masa të cilat mundim na t'i marrim, aq masa sa neve na lejon ligji. Ndërsa fjalën përfundimtare

këtu e ka prokuroria, por masa për çdo rast kemi marrë. Ndoshta po të them gabim, po s'ë di a është e arsyeshme me marrë m'i nxjerrë këto, dhunën, me pas shkruar në raport, se s'është që e fshehim. Okej, mbase do ta përmirësoj herën tjetër. Ka ni moskoordinim këtu me drejtorët. Drejtorët janë të paraprirë që t'i heshtin këto, t'i zvogëlojnë, kam pas rast që drejtori në media thotë na zakonisht i kemi zvogëlue këto probleme, dhe problemet që ndodhin në shkollë zakonisht mësimdhënës-nxënës, drejtori nuk ka nevojë t'i zvogëlojë, po duhet t'i paraqet ashtu siç janë, ai s'është as për m'i rrit as për m'i zvogëlue, po për m'i paraqit ashtu siç janë. Përpiqen për m'u tregue se janë të mirë, që kanë rend nëpër shkollat e veta. Bile kam bë edhe raporte për këtë, kjo s'është për asamble, por është për te vendi atje, sepse më ka ndodhë që policia më ka lajmëruar për rastin dhe nuk më ka lajmëruar drejtori. E saktë, ka lëshime në këtë drejtim. Nexho, Sejdar, po pse more Nexh po i thuesh fjalët e fundit të parat. Sa jemi pajtue, mo tre gishta nuk i ngre. Në Brod situata është kjo, nëse nuk kupton shqip, ta them edhe boshnjakisht. Këto kanë qenë mjetet e parashikuara, 20 mijë euro, kompania e cila ka marrë punimet në shkollën e Brodit ka hyrë me 17,993.20. Paret nuk i ka marrë, ne jemi në procedurë më të. Po të ishte ashtu siç po thu ti, unë jau kisha pru këtë edhe s'kishom ardhë me raportue para jush. Unë jam për me i sqarue këto. 20 mijë euro, për fat të keq, unë jam i interesuar se nuk është se kam ndonjë përvojë të jashtëzakonshme administrative, unë kam shkue në zyrën e prokurimit, te drejtori i Financave, i kam thënë a mund t'i rezervojmë këto mjete, që t'i shfrytëzojmë po për Brod për këtë vit. Edhe 20 mijë janë të ndara për 2023, edhe 20 mijë do të bëheshin 40 mijë. Sepse na i kurseu, kushtimisht, CIMIC-u, duke na ndërtuar, po neve jo që na ka kursye shkollën, na ka kursye nderin, fëmijët, paret kanë shkue në suficit, dhe mu me duhet m'i shkruar këto 20 mijë euro sepse mu me duhet m'i raportue ku janë këto. Paret nuk i kemi ne, s'i ka as kompania. Nëse dikush ka dyshime në këtë drejtim, çka ka ndodhë me to, është zyra e prokurimit. Nuk i ka marrë kompania këto pare dhe kjo punë qenë kështu. Paret kanë shkue në suficit. Kërsteç, ka pak nxënës që udhëtojnë deri në Rapçë, edhe vijnë më shefin e Zyrës për Komunitete, vijnë, kthehen me autobusin i cili i çon nxënësit e shkollës së mesme. Çështjet e transportit i sqaron Vetimi, se s'merrem me transport, nuk jam unë përgjigjësi. Afrore, ma butë bre mësues pak. Dëgjo Afrore, vazhdimisht kemi me policinë bashkëpunim, dhe për Policinë e Kosovës dhe për FSK-në, ata kanë nevojë ni ditë përpara me i lajmëruar që jemi në këtë shkollë për këtë aktivitet. E dini se jo çdo shoqatë dhe çdo organizatë mund t'iu drejtohet nxënësve, sepse duhet të kesh leje të ministrisë, mandej prej ministrisë të vish në Drejtorinë e Arsimit, dhe pastaj të ju qasesh fëmijëve. Policia dhe FSK-ja e kanë ekskluzivitetin që sa herë të do mund t'i qasen, të kenë kontakt me nxënësit. Edhe për narkotikët, edhe kjo ka qenë ni temë të cilën unë kam kërkuar, është luftë shumë e vështirë kjo me narkotikë, është e vështirë sepse ne përpiqemi t'i bindim se është e dëmshme, kurse fëmijët tanë frymëzohen në stilin s'bëj transport nën 100 kile. Nuk është situatë e mirë kjo, pavarësisht se s'kemi raste shumë eklatante, por unë km dyshime, prandaj kemi bashkëpunim me policinë. Policia i përcjell nxënësat prej gjimnazit deri te stacioni, ka pas gjithmonë në shkollën 'Ruzhdi Berisha' sepse është më problematike sa i përket zënkave mes nxënësve, vazhdimisht përcjell nxënësit mes ndërrimeve nga shkolla deri në stacion. Po probleme ka, ndodhin këto. Mungesa e stafit jo, s'kam mund ta bëj stafin jo, se ka procedura. Duhet me muaj me prit, duhet të shpallet një i brenshëm, pastaj një i jashtëm, mandej një muaj ka

pritje, tre muaj i ke minimalisht, edhe paramendoni, unë kam ardhur në janar drejtor, më është dashtë të shkojë në zyrën e personelit të kontaktojë njerëz si ta përshpejtojmë. Në Ministri të Arsimit kam kërkuar ndihmë për këtë punë. Kur kam ardhë unë në janar këtu më kanë thënë se kryeministri e ka ndaluar punësimin. Unë kam shku direkt në Ministrinë e Arsimit, kam kërku, ni zyrtar ligjor atje më ka udhëzu se si duhet të procedohet në këtë drejtim. Por ka zgjat, jo nuk e kam bë unë qëllimisht aspak, se s'ka pas mundësi për më shpejt. Unë jam antisindikalist, unë nuk jam anëtar i sindikatës, as kam qenë kur kam qenë mësues, sepse nëse unë shfaq mendimin tem dhe kam përgjegjësi sepse ky incizohet, kryetarët e këtyre shoqatave, organizatave për mbrojtje të drejtave të mësuesve e kështu me radhë, kanë ditë shpeshherë nga kryetari i sindikatës me përfundue zëvendësministër të arsimit, ne kemi bë grevë të përfitojnë ata. Po, si njeriu që ka jetue në diktaturë edhe që e urren diktaturën, unë nuk e praktikoj atë, edhe s'i marrë mësuesit me zor të shkojnë në shkollë. Nëse dikush di një mësues që unë i kam thënë mos shko në shkollë, ma bini se largohem prej kësaj pozite menjëherë. Kërkuj nuk i kam thënë shko, as nuk i them mos shko. Ndoshta është dashtë me iu thënë shko, mirëpo nuk i kam thënë. Parimisht jam kundër grevave, jo sot që jam drejtor, po edhe kam qenë gjithmonë kundër grevës. Shujta, Afrore, deri në fund s'je e informuar. Nuk ka këtu, tash e kupton si është puna, nuk kemi na qasje, edhe unë kam padi për shujtën, s'e kam marrë. Sepse unë e kam bë padinë kur kam qenë mësues. Nuk kemi qasje. Unë e kam përmend çështjen e shujtës se po na krijon vështirësi, edhe në planin që e kam unë, kërkush nuk garanton e as unë s'mund të ju garantoj se do ta realizoj deri në fund, sepse mund të lëshohen më shumë dënime, të ketë procedura gjyqësore, edhe vijnë t'i marrin 200 mijë euro prej buxhetit. Po të jesh i sigurt që mësuesi nuk pat asnjë qëllim me bë përzierje, jo janë ata atje nalt të këqij e na të mirë, jo jo, nuk ishte ajo ideja. Drejtoria e Arsimit ka pozitën e koordinatorit në gjuhën boshnjake, koordinatori në gjuhën boshnjake e ka vendin e pezulluar, sepse është zëvendësministër, dhe tani për të sjellur ni koordinator të përkohshëm, koordinator i arsimit duhet të jetë ndonjë mësues, nëse Muniri e lënë shkollën le të vjen aty, unë ia hapi konkursin përkohësisht, deri te kthehet zëvendësministri, edhe pse, më duhet t'ia them, asnjë koordinator i mundshëm, të jeni të sigurt, nuk kishte mund me bo ma shumë për arsimin boshnjakisht, shpirti më ka dalë, për shkak të specifikave, e di mirë Muniri edhe të gjithë ata që punojnë në arsim, që punojnë në arsimin e sistemit të Kosovës, se për atë tjetrin s'po flas. Furnizimi me tekste shkollore, këtë problem e kam ngritur edhe në nivele, lirisht munda me thënë kombëtare edhe ndërkombëtare, sepse kam pas nderin të mbaj një ligjeratë ku ka qenë ministria dhe kanë qenë faktorë ndërkombëtarë, ka qenë pikërisht mësimi në gjuhën boshnjake. Problemi me kuadre të mësimin në gjuhën boshnjake dhe problemin e teksteve në gjuhën boshnjake, e kam trajtuar, kam kërkuar që ne Universitetin e Prizrenit, apo të Pejës apo kudo tjetër, të hapen drejtimet për biologji, kimi, fizikë, janë drejtime që nuk ka në gjuhën boshnjake. Prandaj kemi mungesë të kuadrove. Tekstet shkollore, pak është problemi i shtëpive botuese, ministria i ka miratuar, ministria nuk është se ka kursyer në këtë drejtim, drejtoria s'ka pse, sepse i paguan ministria, s'e kemi shumë problem, shtëpitë botuese pak kanë interesim për tekste në gjuhën boshnjake, sepse tirazhi është i vogël, dhe pak ka kompani që shkojnë për të konkuruar për t'i marrë tekstet. Do të mundohemi, unë, përveç teksteve që janë shkollore, edhe literatura nga klasa I deri në XII, unë i kam të gjithë literaturën

shkollore, i kam vetë, me ndihmën e mësuesve të ciklit të ulët fillor apo të mesëm. Kemi bë përpjekje me i qit në tender, përmes Drejtorisë së Kulturës, por ato tekste nuk ekzistojnë, këtu nuk ekzistojnë, po seriozisht po shpresoj që me normalizimin e marrëdhënieve me Bosnjën dhe Hercegovinën, edhe literatura edhe tekstet shkollore në gjuhën boshnjake të kemi pak më shumë. Artan, na kemi thënë 50%, por tenderi ka dalë tash, deri në fund të vitit do t'i paguajmë 100%. Ka probleme le të themi procedurale, por ashtu siç është premtuar, thashë deri në fund 100%. Nuk jemi tërheq prej atij premtimi edhe do të bëhet. Nuk është se po bëjmë namin, në fund të fundit fëmijëve tanë po iu japim, na paret tona po iu japim. Çështja është cila është logjika e ndarjes dhe destinimit të tyre, na kërkush s'japim paret tona. Prandaj po e përsëris, ju lutem, lexoni me kujdes planin, edhe ta bëjmë një debat të mirë, edhe të shohim se çka mund të shtojmë edhe çka mund të heqim, ndane arsimin prej politikës, aq sa ka mundësi, e te politikën e punësimit aty mandej shani kapak, se s'është problem. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdir: Jam dakort me ju që duhet të lexojmë me hollësi dhe pikërisht për këtë po ju bë pyetjen. Këtu në kolonën numër dy thotë vlera e parashikuar 20,000 euro vlera totale e paguar 17990 3 euro, thjesht po bë një pyetje bazuar në atë që është shkruar këtu. Dhe jo në bazë të faktit nëse paratë janë në tepriçë. Paratë nuk mund të jenë tepriçë nëse i keni faturuar këtu. Nuk e di se si mund të përfundonte në tepriçë kur u paguan këto fonde, sepse ju i keni faturuar. Unë kujdesem për paratë publike. Nëse më merrni paratë private, mund t'ju fal, por nuk mund t'ju fal asnjë cent të parave publike, sepse do të kërkoj llogari. Detyra ime është të mbroj paratë publike dhe të mos inatosem fare. Unë po flas sikur është shkruar këtu. Tani e keni ulur pak intensitetin e ofendimeve, tani jam i merzitur dhe deri tani kam qene budalla. Pavarësisht nga të gjitha këto, unë jam ende i interesuar se si keni arritur të paguani këtë shumë të fondeve. Sa i përket transportit të nxënësve nga Krstaci, ata vijnë në shkollë me Uzair dhe kthehen me autobus. Nëse e kuptova mirë, kjo do të thotë se drejtuesi i zyrës së komunitetit transporton studentët.

Selim Kryeziu: Edhe kësaj here nuk do ta injoroj, në të ardhmen do ta injoroj. Faturat, ajo s'është faturë, rubrikat, e ka përshkure, është bërë gabim sepse nuk është specifikuar vetëm ajo, sepse këtu është rubrika e pagave të parashikuara, dhe këtu është rubrika sa është tenderuesi, tash nuk e ka specifikue shkollën e Brodit që në shkollën e Brodit kanë qenë të parapara këto, kaq para, kompania është fut me kaq para, projekti ka dështuar. Ky të çon në burg pa asnjë faturë, ku po sheh faturë bre Nexh, po s'është faturë kjo të lutem. Ni herë të thashë, të lutem, unë nuk jau kam dorëzue kështu edhe me shkue në shpi, jau kam dorëzue këtu dhe jam në gjendje t'jua sqaroj ku ka paqartësi, unë ma shumë se kaq nuk e di. Fatura të papagume, parja e qytetarëve, unë për parë të qytetarëve e jap jetën, janë filozofi të shekullit të shkuar. Mos interveno prej vendit. Mirë, domethënë, po flas për këtë tjerët, për shkollën e Brodit paret janë kështu si thashë. Ka dështuar projekti, paratë shkojnë në suficit në raste të tilla, fatmirësisht që CIMIC-u e ka rregulluar atë shkollë. S'ka faturë. Kaq, faleminderit shumë!

Shpetim Hajredini: Përshëndetje edhe ni herë! Ju kërkoj falje për pengesën, por edhe unë desha të ndërlihem pak të qe ky problemi që u hap prej Nexhës dhe drejtorit të Arsimit, të çështja e renovimit të kulmit të shkollës fillore në fshatin Brod. I nderuar drejtor, mu po më vjen keq që po

duhet tash edhe unë të ju them që është gabim shënimi, pasi që ju është dashur që mos ta shënoni vlera totale e paguar. Në kontabilitet nuk shënohet në konto asnjë cent pa ndodhur, se nëse ti këtu e ke shënuar vlera totale e paguar, për mu është e paguar, se edhe në total përfundimtar po del me këtë shumë, ndërsa kjo ka shkue në suficit. Unë absolutisht nuk po ju them që keni vjedhur, apo keni bo ku me ditë çka, diçka të jashtëligjshme, por duhet të keni kujdes mirë se ekonomia, kontabiliteti këto gjëra nuk i lejon. Ti përderisa ma dërgon mu materialin me këtë shënim, me këto të dhëna, unë i marr si të përfunduara. Pse po e them këtë, sepse kjo shumë, në vitin fiskal me 31 dhjetor 2022 ka përfundue. Edhe duhet të jemi të qartë, o kjo shumë ka shkue në suficit, o shuma 17,993.20 është paguar dhe ka përfunduar. Nëse ju nuk keni bërë ni pagesë të tillë, 20 mijë eurshi, vlera e parashikuar është dashur të mbetet, vlera totale e paguar është dashur të jetë zero. Edhe ne do të ishim shumë të qartë, shumë në rregull, nuk do të bëjshim replikë, s'kemi pse me diskutue, e dijshim që kjo ka shkue në suficit, katë vite jam marrë me projekte, shkojnë në suficit, e di çka ndodhë, si ndodhin këto gjëra, por në momentin që ti e ke shënue, për mu nuk është në rregull. Por, thashë, nuk po ju them që keni bo hajni, keni vjedhë apo gjëra të tilla, por shënimi këtu nuk është dashur të ndodhë. Ju faleminderit!

Selim Kryeziu: Nga DKA është bërë një lëshim që nuk është specifikuar kjo, për këtë kërkoj falje, unë nuk e kam problem kur bëj gabim të kërkoj falje, nuk jam për atë që arsimi fillon me mu e unë jam menjëherë mas Zotit. Problemi fillon te unë kur nis edhe bën paragjykime ose mban fjalime patriotike, të panevojshme. Është bërë gabimi, unë e sqarova, nuk është dashtë të jetë në këtë rubrikë ku janë të gjitha këto, është dashtë të specifikohet që kjo shumë ka qenë e parapame, kanë dështuar, por nuk mund të jetë paguar sepse unë është dashtë të nënshkruaj, dhe unë nuk kam nënshkruar. Thashë unë ju kërkoj falje për këtë hamendësim që mund t'jau krijojë, po për ma shumë se kaq s'kam bërë, edhe nuk ka nevojë të bëhet me aq bujë, thuaj çka ke bo këtu drejtor, çfarë budallaki ke bë këtu, se e sqaroj s'ka problem, po jo të bësh teori konspirative këtu dhe të mbash ligjërata qysh duhet ta bëj. Po lëre se s'më mban kush mu ligjërata se si duhet ta bëjë, as për moralizëm, as për moral, s'mban kërkush ligjërata, as për antikorrupsion mu kush s'më mban ligjërata, 22 vjet kam punue në shkollë, me nxënës, flasin 22 gjenerata të cilët unë i kam mësuar. Mosni , ju lutem! Shiko, çështja është që, më besoni që nuk jam alergjik ndaj kritikave, po ndonjëherë kujdesuni bre për fjalët, se po më shtini edhe m'u hidhëru. Do të mundohem ta përmirësoj, po jo me kësi lloj leksione.

Samidin Xheladini: Të nderuar të pranishëm! Po më vjen keq, na e kemi për detyrë me lyp sqarime, kur të vjen raporti i hargjimeve, asnjë cent nuk guxon me lëvizë jashtë asaj që është realizue edhe që nuk u realizue. Po ju tregoj diçka që na ka ndodhë: qeveria e ka parapa me e bo ni projekt, ni plan të punës, edhe e ka bo copy-paste edhe na ka pru neve. Edhe na e kemi pa në Kuvend këtu, përveç që e ka bo copy-paste, edhe emrin e komunës s'ia ka fshi aty, s'u bë kiameti, na veç e kemi nërrue, u konë plan i mirë, e kemi ndërrue emrin e komunës ia kemi vu tonin aty, edhe u krye muhabeti, se na ka konvenue, edhe s'u bo kaq e madhe. Copy-paste edhe s'kemi bo problem, se e kemi pas qëllimin konstruktiv, me shkue përpara, se mund të ndodhin gabime. Drejtori 20 herë u detyrue me dalë me bo ni sqarim se ai është plani edhe kjo është gabim teknik,

edhe munden për shembull në administratë m'u bo. Kemi plot raste na edhe kanë me na ndodhë këto. Faleminderit!

Artan Loshaj: Ju kërkoj falje, shumë shkurt, a ka mundësi pasi drejtoresha edhe zyrtarja e Barazisë Gjimore janë femra, janë nëna, a ka mundësi në qoftë se keni ndonjë pyetje diçka, të ju japim përparësi atyre të diskutojnë edhe le të shkojnë në shpi.

Liridona Misinaj: I nderuar kryetar, të nderuar të pranishëm! Bazuar në Planin e Punës 2022 të paraqitur dhe të miratuar nga Asambleja Komunale, DKRS gjatë kësaj periudhe raportuese ka bërë përpjekje maksimale në realizimin e të gjithë detyrave dhe objektivave, me qëllim që në tërësi të realizojë planin dinamik të aktiviteteve për këtë viti kalendarik. Marrë në përgjithësi, prioritetet për Drejtorinë kanë qenë shënimi i festave kombëtare, ku gjithashtu rëndësi i është kushtuar edhe aktiviteteve të tjera kulturore, rinore dhe sportive. Në raportin më poshtë i keni të gjitha aktivitetet, investimet dhe subvencionet që për shkak të kohës nuk po i përmendi gjithsecilat, kryetari shumicën prej tyre edhe i tha. Deshta të ndërlihem në pyetjen që e bëri zotëria për çështjen për bibliotekën. Objekti ose pozita në të cilën gjendet biblioteka në vendin aktual ku është, e ka një pozitë jo të favorshme, jo të mirë, jo të standardeve të cilat i kërkojnë ditëve të sotit. Bashkarisht me kryetarin po mundohemi me e gjet ni hapësirë më adekuate dhe për një objekt sa më të përshtatshëm për lexuesit dhe për të gjithë qytetarët e Komunës së Dragashit. Po dal tek palestra sportive, i cili është investim i MKRS-së, e cila ka pezulluar punimet për shkak të pandemisë, nuk e di pse prej atëherit nuk është intervenuar asgjë në atë pjesë, janë vetëm temelet dhe asgjë më shumë. Këtë vit, me sa kam informacion, MKRS ka ndarë 10 mijë euro, dhe po shpresojmë se do të vazhdohet të punohet, po shpresojmë, mbetet të shohim pasi po kalon edhe sezona e dimrit, jemi veç në pranverë, po besoj që kanë me fillue punimet. Krahas realizimit të aktiviteteve të parapara në Planin e Punës, DKRS ka pas ni bashkëpunim të vazhdueshëm me MKRS-në, dhe me shumë organizata të tjera, ku janë dorëzuar edhe shumë kërkesa për mbështetje materiale për të gjithë sektorët, duke përfshirë edhe bibliotekat, muzeun etnografik, dhe restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore-historike. Gjithashtu kemi pasur bashkëpunim të ngushtë me DKA-në në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, si dhe në lidhje me reformat dhe kushtet që mund t'i kenë të rinjtë. Me rastin e organizimit të aktiviteteve, nuk duhet harruar dhe falënderuar policinë e Kosovës, MKRS-në dhe disa OJQ lokale që kanë ndikuar në masë të madhe në numrin e aktiviteteve, realizimin dhe kualitetin sa më të mirë të tyre. Ju faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Unë jam i interesuar për subvencionimin e organizatave joqeveritare, ju subvencionova dy organizata joqeveritare nga Gora. Njëra është "Rinia Demokratike e Gores", me 3950 euro dhe tjetra "Zajedno za Brod" me 4000 euro. Ata promovuan traditën gorane dhe ditët e diasporës. Më intereson se ku i kanë shpenzuar saktësisht ato para. A e keni marrë raportin financiar, pasi i keni financuar, a i keni marrë projektet e tyre, si do t'i realizojnë këto aktivitete dhe a e dini se në cilën datë i kanë realizuar ato projekte. Më saktësisht, për ditët e diasporës, a e dini se projekti filloi të zbatohet kur diaspora filloi të largohej nga këtu në gusht. Nëse organizojmë ditë diaspore, duhet të jetë në muajin qershor. Mos e merrni këtë personalisht, unë e admiroj dhe përgëzoj punën tuaj, thjesht më intereson informacion i detajuar për këtë çështje.

Liridona Misinaj: Nedzmidin, për sa i përket subvencioneve që janë bërë për këto dy organizatat, po mendoj kur e kemi bërë thirrjen publike, këto kanë aplikuar me projektet e tyre, të cilat e kanë bo vlerësimin prej komisionit adekuat që u marrë me atë punë. Gjatë përfundimit të vitit, ato e kanë pru raportin financiar të aktiviteteve të cilat i kanë kryer përgjatë gjithë vitit kalendarik. Kështu që në Drejtori e gjithë procedura ka qenë në kushte ligjore, çdo gjë është bërë me anë të ligjit, nuk është bërë asnjë shkelje ligjore. Faleminderit! Për shkak se është bërë në aktivitet, është organizue për herë të parë në Komunën e Dragashit, është marrë si iniciativë për herë të parë, kështu që ndoshta u konë vonë, po është e rëndësishme që e kemi realizue, këtë vit i kemi parasysht kritikën e tua, edhe po besoj që kemi me arrit me realizue me kohë. Jo, të jesh i sigurt që ka m'u krye me kohë. Esenca e gjithë kësaj, Nedzmidin, ishte që me fillue si aktivitet, m'u bo traditë në Komunën e Dragashit. Faleminderit!

Munir Jonuzi: Kur shikon strukturën e këtij raporti, kupton menjëherë se është bërë nga një person i ri dhe i arsimuar. Megjithatë, kur lexoni përmbajtjen e raportit, duhet të vini në dukje disa gjëra që vërtet nuk janë të mira. Keni pasur shumë aktivitete, të cilat janë për t'u vlerësuar, keni bërë shumë gjëra për promovimin dhe edukimin e të rinjve përmes projekteve të ndryshme. Ju keni subvencionuar shumë OJQ. Ndër to ishte edhe projekti për promovimin e turizmit të komunës së Dragashit për festën e goranëve. Vërtet nuk kam asgjë kundër organizimit të goranëve, është sipas Statutit të komunës sonë dhe kanë punuar në promovimin e kulturës dhe trashëgimisë, që është edhe përkatësia ime etnike, kanë bërë një projekt shumë të mirë. Ajo që nuk keni bërë është, nuk keni bërë asgjë për të promovuar Ditën e Boshnjakëve. Nuk keni organizuar asgjë për 28 shtatorin. Në këtë komunë kemi tre kombe, shqiptar, boshnjak dhe goran. Ne organizuam ditën e shqiptarëve 28 nëntorin, organizuam ditën e goranëve, por nuk e organizuam ditën e boshnjakëve. Populli ynë thotë se fatkeqësia nuk ikën kurrë vetëm. Në këtë raport, na është dhënë edhe një pasqyrë e tabelave të bibliotekës. Aty thua se janë 40 mijë libra në gjuhën shqipe, mbi 20 mijë në gjuhën serbe, 269 libra në gjuhën turke, sa libra keni në gjuhën boshnjake. E kuptoj që nuk mund të bësh dallim mes gjuhës boshnjake dhe serbe, por duhet të kishë bërë njësoj si me tabelën për lexuesit sipas kombësisë. Mund të kishit vënë boshnjak/Goran. Ju mund ta kishit mbuluar atë me këtë kategori. Vërtet, kjo qeveri neglizhon shumë gjuhën boshnjake dhe boshnjakët. Kjo është ajo që më dhemb. Shpresoj se do të përmirësoheni në këtë, shpresoj që vitin e ardhshëm do të na ktheni atë që nuk na e keni dhënë këtë vit.

Nedzmidin Sejdilar: Dua t'ju them se as ditën e Goraneve nuk e ka organizuar administrata komunale. U organizuan ditë të diasporës në Gore. Unë protestova herën e fundit pse presidenti i dha para delegatit të pranishëm këtu. Nuk po kundërshtoj askënd, por as dita e Goraneve dhe as dita e boshnjakëve nuk u organizua. Ndoshta ky vit do të jetë ndryshe, do të shohim deri në fund. Drejtoreshës së kulturës mund t'i them që drejtorët e tjerë mund ta kenë zili, një drejtoresh i qetë dhe profesionist si kjo pranon kritikën.

Munir Jonuzi: Prandaj e lexova emrin e projektit që thotë promovimi i turizmit në komunën e Dragashit për ditën e Goraneve dhe e di që nuk organizohet me 6 maj, por përmend ditën e

Goraneve. Megjithatë, sa shumë komuniteti juaj nuk është lënë pas dore. Komuniteti boshnjak këtu është tërësisht i lënë pas dore.

Lindita Kozmaqi Piraj: Përshëndetje zëvendëskryesues, përshëndetje të nderuar asambleistë dhe të nderuara asambleiste, ju drejtorë dhe gjithë pjesëmarrës! Gjatë vitit 2022 kam realizu aktivitetet e parapara në plan të punës, që disa prej tyre janë mbështet nga donatorë, por edhe nga komuna. Aktivitetet janë të parapame dhe ishin shumë mirë të futura, ashtu qysh i kam raportu edhe kryetarit, me foto edhe me të gjitha, po në vija të trasha, domethënë ka edhe shumë aktivitete të tjera, nënaktivitete, që janë realizu deri te ky aktivitet i cili është paraqitur në vija të trasha. Po filloj me shënimin e ditës së 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, që kemi pas ni aktivitet ditor me anë të një debati të realizum, që qëllimi ka qenë me e promovu rolin e gruas në vendimmarrje, kemi pas promovimin e drejtoreshës së Kulturës, që për herë të parë është thy tabuja me pas grua në vendimmarrje në komunën tonë, për fat të mirë. Deri tash kemi pas temë tabu. Mandej jemi trajtu me problematika me të cilat ne përballemi tash e sa vite, me mosfunksionalizimin e çerdhes dhe mungesën e trajtimeve shëndetësore për gratë dhe vajzat e Dragashit. Kemi pas drejtorë të atyre drejtorive dhe kemi diskutu së bashku me gra pjesëmarrëse të Asamblesë, të administratës dhe gratë familjare të familjeve të dëshmorëve, si gjithmonë që i thërrasim dhe i kemi prezent në shënimin e kësaj dite. Më tej, kemi realizu në bashkëpunim me Partners Kosova, një organizatë që është mbështet nga kryetari, për fuqizimin e rolit të asambleistëve, gratë dhe vajzat brenda Asamblesë, me anë të një trajnimi dyditor por edhe disa aktiviteteve. Me mbështetjen e OSBE-së kemi realizu një punëtori njëditore me gratë asambleiste të komunitetit goran dhe me gra të tjera, me qëllim aktivizimin dhe integrimin në shoqëri të këtyre grave të komunitetit pakicë. Po ashtu, në bashkëpunim me Qendrën e Krimeve dhe Mbrojtjen e Grave është shënu seminari për të luftu stigmat dhe njoftimi me afatin e statusit të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës. Në mbështetjen e UN Eëomen, një organizatë ndërkombëtare, kemi fillu realizimin e buxhetimit gjinor me dy drejtori vitin e kalum, do të vazhdojmë me dy drejtori këtë vit, sepse është projekt trevjeçar. Dhe falë mbështetjes së drejtorit nga Drejtoria e Financave është një fillim i mbarë, shpresoj ta realizojmë dhe do ta keni edhe dokumentin sigurisht me qarkoren buxhetore me ndryshime, por në aspektin e ndjeshmërisë gjinore, duke fillu prej gjuhës, e të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë. Po ashtu, me ndihmën e kësaj organizate është punu draftimi i strategjisë për zhvillim ekonomik të komunës sonë, që unë në këtë dokument e kam dhënë ndihmën teme në aspektin e ndjeshmërisë gjinore. Në qershor të këtij viti, me anë të OSBE-së kemi bë nënshkrimin e memorandumit e mirëkuptimit mes kryetarit dhe të gjithë akterëve të Mekanizmit Komunal Kundër Dhunës. Po ashtu, gjatë këtij viti, me mbështetjen e OSBE-së kemi bo edhe hartimin e Planit të Veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje, që në shtator është kalue nga ju si Asamble me vota unanime. Po ashtu, me mbështetjen e OSBE-së, në nëntor kemi bo edhe ceremoninë e nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit midis kryetarit të komunës dhe drejtoreshës së strehimores në Prizren, ku na ofron edhe neve shërbime si komunë, sepse është strehimorja në regjion. Është vazhdu memorandumit i bashkëpunimit për tri vjet, sepse ka qenë tri vjet, tash është vazhdu edhe për tri vjet tjera. Mirëpo, përveç kësaj, është nënshkru edhe ni memorandum i mirëkuptimit, për herë të parë, midis përfaqësuesit të kompanisë MEKA dhe strehimores, për mbështetjen me

produkte apo edhe me punësim të viktimave dhe çfarëdo nevojë në të ardhmen. Kjo është një e arritur dhe konsideroj se është mjaft e vlefshme kur bëhet fjalë që komuna jonë hynë ndër komunat e para, me komunën e Mamushës, mos gabofsha edhe Prizrenit, me ni memorandum të tillë në Kosovë për herë të parë. Përveç këtyre, kam qenë pjesëmarrëse në konferenca të ndryshme që janë zhvillu, si në konferencën e zyrës për qeverisje të mirë në nivel komunal, ku kam përfaqësu nivelin komunal, në të gjithë Kosovën. Në tetor kemi shënu ditën e vajzave, po ashtu në bashkëpunim me OSBE-në, me aktivitete të ndryshme që nuk po hi me elaboru në vija të shkurta për shkak të kohës. Gjatë këtij viti, në bashkëpunim me zyrtaren nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me Drejtorinë e Departamentit për Siguri në Komunikacion Rrugor, kemi organizu aktivitete me qëllim të vetëdijesimit për siguri në komunikacion, në tri shkolla në bashkëpunim me DKA-në, kemi përzgjedhë ‘Fetah Sylejmanin’, ‘Sezai Surroin’ në Bellobrad dhe ‘Shaban Shabani’ në Llopushnik, ku përveç sesioneve informative për siguri, kanë bo edhe identifikimin e mungesës së sinjalistikës për sigurinë e këtyre nxënësve, që është premtu se do të bëhet diçka në të ardhmen. Uroj edhe shpresoj të na kthejë përgjigje Ministria e Infrastrukturës. Unë përveç si zyrtare për Barazi Gjinore, udhëheq edhe Mekanizmin Komunal Kundër Dhunës në Familje, mekanizëm ky që mban takime të rregullta periodike çdo dy muaj, mbledhim të dhëna dhe statistika. Po ashtu, në kuadër të fushatës ndërkombëtare të dhunës në familje që fillon me 25 nëntor dhe përfundon me 10 dhjetor, së bashku me këtë mekanizëm kemi realizu një mori aktivitete të ndryshme, që i kemi të listume këtu, nuk e di sa ia vlen m’u ndalë për shkak të kohës, i keni edhe me foto të gjitha të sqarume. Shkurt po i përmend që i kemi realizu së bashku me policinë sesione ndërgjegjësu kundër kësaj dukurisë nëpër shkolla, takime me nxënës kemi mbajt realisht në disa shkolla, në 7 shkolla mos gabofsha, s’di a është e paraqitme këtu, sigurisht është në detaje, ni takim vetëm me gra dhe me vajza në fshatin Bresanë, me mbështetje të komunës, një takim vetëm me mësuesit, po ashtu me mbështetje të komunës, kur them të komunës me mbështetje të zyrës së kryetarit, se unë zyrës së kryetarit i takoj si zyrtare për Barazi Gjinore, dhe takimin përmbyllës që e kemi mbajt me 10 dhjetor që kemi shënu përmbylljen e fushatës dhe ditën e të drejtave të njeriut, me mbështetje të OSBE-së. Gjatë këtij viti, në kuadër të fushatës sensibilizuese ‘Gjashtëmbëdhjetë ditët e aktivizimit’ kam qenë pjesëmarrëse në konferencën rajonale kundër dhunës në familje, të organizuar nga UN Women, që është mbajt në Stamboll e që pjesëmarrja ka qenë përmes platformës online. Kam përfaqësu Kosovën si paneliste në atë konferencë mbi rolin tim si koordinatorë e mekanizmit të dhunës në komunë. Gjatë këtij viti kam qenë pjesëmarrëse në takime të ndryshme të cilat janë organizu, si në komunë, po ashtu edhe në Agjencionin për Barazi Gjinore që është e qeverisë, të cilat unë i raportoj në nivelin qendror, ministri të ndryshme, po ashtu edhe trajnime të cilat kanë qenë për ngritje të kapaciteteve. Kam marrë pjesë edhe në komisione të ndryshme, varësisht sipas nevojës të komunës. Më lejoni krejt në fund ta falënderoj kryetarin, të gjithë drejtorët, akterët, juve si asambleistë dhe asambleiste të nderume, për gjithë bashkëpunimin, për gjithë mbështetjen që keni pas, duke mos i harru asnjëherë të gjitha organizatat dhe donatorët që e kanë bo të mundshme realizimin e planit tim dhe të gjitha këtyre aktiviteteve. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, zonja Piraj! Fjlëne ka kërku zoti Nedzmidin Sejdilar.

Nedžmidin Sejdilar: Zonja Piraj, mos u ofendoni kur them se keni folur shumë më tepër se sa keni shkruar në raport. Raporti juaj është si një libër me figura pa asnjë tekst. Vetëm foto komplekse dhe shumë pak tekst. Ju këtu në raportin tuaj keni përdorim të paautorizuar të fjalës suaj për marketing të kompanive të caktuara. Ju keni bërë marketing kompanive private dhe donatorëve tuaj. E treta, nuk na ke dhënë asnjë statistikë. Ju si zyrtare kunder dhunës në familje të paktën duhet të na kishit dhënë statistikat. Sa raste kishte, ku ishin ato raste, si ishin e kështu me radhë. Gjëja e katërt, zyra juaj kapitulloi. Ne jemi këtu ju dhame para për një strategji kundër dhunës në familje dhe të gjithë jemi dëshmitarë këtu që vitin e kaluar keni pasur dhunë në familje me rezultat fatal. Është faji juaj. Ju mburreni këtu se si keni mbajtur seminare dhe keni dhënë leksione për njerëzit, për gratë e emancipuara. Të ftuar në seminarët tuaja ishin delegate dhe gra që punojnë në komunë, pra në zhargon, gra që mund të rrahin burrat e tyre. Çfarë keni bërë për ato amvisat që nuk kanë guximin të raportojnë problemin. Si i qaseni atij problemi? Ky është një problem serioz. Ne e dimë se si në Opolje ashtu edhe në Gore kemi një rritje të dhunës në familje. Dhe çfarë po bën zyra që na mori para me votat tona. Në raportet tuaja nuk keni përmendur as një rast me përfundim fatal. Dhe i gjithë vendi u trondit kur lexuam për të në media. Këtë vit ne do të mbyllim njërin sy dhe do ta shohim me gishta, por vitin e ardhshëm ju kërkojmë që këtë punë ta bëni më me ndërgjegje dhe cilësi më të mirë.

Uran Halimi: Zonja Piraj, ju lutem qëndro deri në fund, mbaj shënime, të kqyrim nëse kemi ndonjë pyetje tjetër, t'i shterojmë të gjitha mundësitë pastaj mund të dilni. Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën në lidhje me raportimin e zonjës Piraj? Atëherë mundeni zonja Piraj me e marrë fjalën.

Lindita Kozmaqi Piraj: Faleminderit Nedzmidin për vullnetin që e ki, vullnetin e çmoj. Prej fillimit deri tash me dalë çdo herë me bo pyetje, kjo është energji full. Të përgëzoj. Për informim, më vjen keq, për informim je larg bre, qysh po thu të kemi dhënë mjete për strategji? Strategjinë e ke pas përpara zotëri, strategjia është e komunës, e keni plotësu ni kriter ligjor që duhet me e pas si çdo komunë. Strategjia i ka pas të gjitha aktivitetet e përfshime, me mbështetjen e donatorëve 20-30%, në qoftë se na ofrojnë donatorët neve me bo aktivitete konkrete për me pa edhe që jemi për ata m'u thirrë si mekanizëm. Po thu t'i kemi dhënë mjetet, ku janë ato mjetet, ato janë faktikisht të planifikuara që të hargjohen gjatë gjithë vitit, që ato nuk i ka zyrtarja, kjo është shumë larg me atë që i përket realitetit. A thuhet kjo, të lutna informohu një herë, tani dil si asambleist, se nuk bën kështu me qenë kaq keq i informum apo jo i informum. Gratë amvise po thu duhet me bo, gjithsesi që duhet, unë jam për me bo ma tepër, kjo është mundësia, me gjitha ato mundësi dhe mbështetje kam pas aktivitet, e kam të përshkrum aty në detaje, se ke thanë ke paraqit pak, veç foto, nuk kam paraqit sa kam realizu, për hir se raportet duhet shumë të shkurta dhe koncizë për m'i lexu të gjithë. Raporti është kriter me qenë sa ma i shkurtë, brenda qasaj fjalie duhet me nënkuptu shumë, dhe në fillim e sqarova se ka pas ni mori te aktiviteteteve, po nuk përshkruhet në raport detaje, dhe kemi realizu aktivitete edhe me gra amvise, pajtohna që nuk është mjaft, me kaq mundësi sa kemi në Dragash, me zero OJQ të grave dhe të vajzave që kemi deri tash, se aktivitetet në teren i kryjnë

OJQ-të, komuna kontraktin kompani OJQ, realisht na veç na u ofroshin organizata jashtë Dragashit, ni herë për ni herë nuk kemi edhe ajo është ni pengesë shumë e madhe. Po thu i ke mbështet gratë e punësime, e ki fjalën për aktivitetin e asambleisteve, ju si Asamble prej fillimit të mandatit deri tash mbështeteni prej OSBE-së dhe organizatave të ndryshme për ngritje të kapaciteteve, na si zyrtar për vite të tëra dhe gjithmonë, se gjithmonë kemi nevojë dhe ka ndryshime, e lë mo për gratë e Asamblesë së komunës tonë, kur vitin e kalim e thym tabunë në vendimmarrje, edhe i kemi ndoshta për herë të parë që janë t'u përballë me jetën institucionale. Kanë nevojë shumë për ngritje të kapaciteteve, kanë nevojë për fuqizim dhe për bashkëpunim, si me ju, si me ne si institucione si te gjithë, sepse edhe ato përbëjnë 10 gishta këtu në asamble, dhe këto janë zëri i atyre grave amvise, të atyre në cep të Gorës dhe në cep të Opojës. Këto i ngrejne çështjet e tyre, sepse me votat e atyre këto janë këtu. Dhe nuk do të thotë se këto nuk duhet me i përfshi, këto janë të parat të cilat duhet me qenë të informume dhe duhet me qenë koherente me planin tem. Me mujt m'i shty, se nuk është lehtë, jemi t'u jetu në Dragash, jemi t'u jetu ni realitet, ku jemi shumë larg asaj që duhet femra të integrohet, jemi me përqindjen ma të ulët prej komunave në punësim të grave etj.etj. Kjo ishte në pika të shkurta përgjigja jem.

Uran Halimi: Faleminderit, zonja Piraj! Ni minutë replikë i takon zotit Sejdilar.

Nedžmidin Sejdilar: Zonja Piraj, unë e bëj politikën këtu, jo ju. Kjo që bëtë këtu pak më parë nuk është gjë tjetër veçse një fjalim politik. Ju lutemi përmbahuni nga kjo dhe na jepni vetëm faktet dhe statistikat specifike që kërkojmë. Keni ardhur këtu dhe më bërtitni, u tundët shumë, nuk e di pse, më thoni zonja Piraj, kur flasim për statistika, sa raste të dhunës në familje keni. Dhe herën e fundit, një vit më parë, ju nuk e keni bërë atë. Këtu keni krijuar vetëm një album me figura. Çdo faqe që hapni ka vetëm foto. Teksti nuk gjendet askund. Fakti që ju thoni se kam bërë një raport të shkurtër që të mos keni vështirësi, këtu e shihni se ka dikush që ka vështirësi, që lexon të gjitha faqet e raportit. Ka një. Jam shumë i shqetësuar për shtimin e rasteve të dhunës në familje nga të dyja palët. Ju përmendët punën dhe detyrat e një delegati. Delegatët e dinë qartë këtë. Ata janë zgjedhur politikisht dhe demokratikisht nga populli për të përfaqësuar ato gra dhe jo ju. Duhet ta vini në praktikë. Dhe mos i mbronni delegatët këtu, ata janë të aftë ta bëjnë vetë sapo të marrin votat për të ardhur këtu.

Uran Halimi: Faleminderit, zoti Sejdilar! Ni minutë replikë zonja Piraj.

Lindita Kozmaqi Piraj: Sejdilar, më fal për statistikat se s'e bona me qëllim, se s'mujta me shkru, kur po të thom kadale se me përkthim po vjen ma vonë, ti s'më kuptove. Para se me dal te statistikat, rreth qetyre fotove, tjera herë nuk i qes e t'i qes veç fjalët, po raporti konkret është kur ta pasqyron aktivitetin edhe me foto, dëshmi është fotoja. Sa i përket shkrimit, fotoja është shkrim, futu lexoje ni herë, mandej fjalja këtu është në vazhdim shih fotot, disa foto të aktiviteteve. Nejshe, kështu, në rastet e dhunës, sipas bashkëpunimit me policinë, na janë raportue gjatë vitit 2022, 15 raste të raportume, jo që ndodhin dhe jo që është kjo shifër reale, po sa paraqiten. Na e dimë shumë mirë se jemi t'u e përjetu ni realitet që është shumë i vështirë pa dyshim, edhe rastet e dhunës këtu raportohen edhe nuk do të thotë që s'ka tjera, po e dimë se kur bohet raportimi në Kosovë edhe në

Dragash. Sa i përket rastit të dhunës konkret, që e lidhe me këtë rastin e vdekjes së gruas, unë kam qenë në rrejdha që nga fillimi dhe e kam njoftu policinë, kanë marrë masa policia, QPS-ja, me aq kompetenca çka kanë, mirëpo rastet e dhunës janë qaq të komplikume dhe qa kërkojnë edhe angazhim të nivelit qendror, që konkretisht këtu ka mbet çështja e prolongimit apo e prokurorisë, në këtë rast konkret, ashtu qysh na jemi të informum. Domethënë ka qenë t'u prit vendimi i prokurorisë se çfarë me bo me rastin konkret. Kështu që, unë si zyrtare, përveç teknikisht që e organizoj punën e këtij mekanizmi, unë nuk jam institucion direkt që as jap shërbime, se në mandatin tim ligjor nuk është të jap shërbime apo të bëj mbrojtjen ndaj viktimës, janë institucionet, akterët shtetërorë që kanë mandat, përveç policisë, QPS-së, në varësi të nevojës qendra e shëndetit mjekësor, gjykata dhe prokuroria. Në rregull, veç u detyrova me dhënë sqarime, se krijon keqkuptime në opinion pa nevojë fare.

Uran Halimi: Faleminderit shumë, zonja Piraj! Në radhë është drejtori i Administratës.

Vetim Ramadani: Faleminderit kryesues, të nderuar asambleistë! Atëherë po mundohem, meqenëse ka kalue ni kohë e gjatë në seancë, po mundohem me qenë shumë i shkurtë. Marrë parasysh faktin se Drejtoria e Administratës është ura lidhëse e shërbimeve që ofrojnë institucionet lokale, qoftë me qytetarët qoftë me institucionet qendrore, munda me konstatue me gojën plotë se shërbimi i administratës komunale ka qenë jashtëzakonisht i përkushtuar në ofrimin e shërbimeve efikase ndaj qytetarëve. E tërë puna e DA-së është organizuar në pesë sektorë të veçantë; sektori i gjendjes civile apo ofiqaria siç njihet, zyra për shërbimin e qytetarëve dhe arkivi, zyra e prokurimit, shërbimet teknike. Sa i përket sektorit të gjendjes civile, ashtu siç e dini tashmë, nuk është ndonjë risi, gjithsej janë shpërndarë në tërë komunën tonë pesë zyra të gjendjes civile, pra në Dragash, Bresanë, Llopushnik, Krushevë dhe në Brod. Gjatë vitit që lamë pas, përkatësisht për të cilin është raporti, e kami gjetur situatën pak problematike në dy zyra të gjendjes civile sa i përket resurseve njerëzore, ku kemi pas zyrën në Bresanë dhe në Llopushnik me nga një punëtor, atë problem e kemi sanuar, tashmë gjenden nga dy punëtorë në secilën zyrë të gjendjes civile dhe shërbimi për qytetarët është duke shkuar në mënyrë normale, pa ndonjë pengesë siç e kemi pasur në fillim. Gjatë këtij viti gjithashtu jemi ballafaquar edhe me një ngritje të kërkesave për pajisje me dokumente, me çertifikata, me ekstrakte e me gjëra të ngjashme. Për këtë arsye, në një periudhë dymujore e kemi zgjatur edhe orarin e punës, pra gjatë ditëve të punës nga e hëna në të premte është punuar me orar të tejjgatur, përkatësisht përderisa orari i punës në komunën tonë është nga ora 07:30-15:30, ky orar ka vazhduar deri në ora 17:00, dhe gjithashtu, përmes vendimit të kryetarit, kemi zgjatur edhe orarin gjatë fundjavëve, përkatësisht ditën e shtunë është punuar përgjatë këtij dymuajshi kur kemi pas fluks më të madh të bashkëqytetarëve tanë të cilët gjenden në diasporë dhe gjetiu, kemi rritur këtë orar, pra kemi bërë nga ora 08:00 deri në ora 13:00. Po ashtu, si drejtor i Administratës jam përkujdesur edhe në përmirësimin e kushteve sa i përket shërbimit civil, ku ashtu siç e ceka edhe më herët, në lidhje me pajisjet kompjuterike, përderisa kemi pasur kontratën valide përmes OQP-së, kemi bërë furnizimin për një pjesë të stafit civil, pjesa tjetër mbetet edhe këtë vit që të vazhdojmë bashkë edhe me Asamblenë. Në periudhën janar-dhjetor të vitit 2022, në total zyrat e gjendjes civile, pra 5 zyrat e gjendjes civile, kane lëshuar 31,569 llojë të çertifikatës,

përfshirë këtu certifikata lindje, ekstrakte, certifikata martese, deklarata të bashkësisë familjare dhe dokumente të cilat ofron ky shërbim. Dëshmia e vdekjes 197, kemi bërë regjistrimin në regjistra themeltar, nuk po lëshohem në lexim të statistikave, meqenëse e posedoni materialin në detaje, regjistrime në regjistra të veçantë nga bota e jashtme, kërkesa për lirim nga shtetësia, fitim shtetësie, shkukurëzime dhe gjëra të ngjashme, të cilat i keni të regjistruara në detaje. Sa i përket të hyrave të inkasuara nga shërbimi i gjendjes civile, në periudhën janar-dhjetor 2022, totali i shumës e cila është inkasuar kap vlerën prej 38,596 euro, të hyra këto të cilat janë të dorëzuara te zyrtari i pasurisë komunale. Vlen të theksohet se dy zyrtarët ekëtij shërbimi në total kanë procesuar 24,811 lëndë, gjithashtu është bërë një punë jashtëzakonisht e mirë sa i përket miratimit dhe aprovimit apo ndryshimit të statusit të lëndëve të cilat gjende në sistemin e intranetit, dukuri të cilën e kemi trashëguar më problematike, ende ka punë për të bërë, mirëpo ne jemi duke u munduar që ta sanojmë çdo ditë e më shumë, dhe ritmi po tregon që është duke shkuar në rrugë të mirë. Sa i përket certifikatave të cilat, si pasojë e udhëzimit të ri administrativ 01/2022 për lëshimin me QPR kod, në implementimin e këtij udhëzimi kemi bërë përgatitjet e nevojshme dhe kemi filluar më 28 shkurt të vitit 2022 kemi filluar zbatimin e programit të ri të regjistrimit qendror të gjendjes civile në verzionin QPR Kod. Ndërsa programi i pagesave ka filluar nga data 1 prill i po atij viti. Sektori i dytë është zyra për shërbime me qytetarë dhe arkivi, ashtu siç edhe e dini, në shërbim të qytetarëve për t'u informuar me procedurat e nevojshme, është pak a shumë pika ku fillojnë të gjitha, edhe zgjidhjet edhe problemet në komunë, qoftë kërkesa, ankesa, tenderime, dorëzime aplikacionesh, pak a shumë gjithë puna e cila zhvillohet brenda komunës nga aty fillon dhe nga aty dalin rezultatet apo përmes tabelës së shpalljeve. Në periudhën janar-dhjetor 2022, në këtë zyrë janë regjistruar gjithsej 39,290 lëndë, në këtë zyrë gjithashtu kryhen edhe pagesat e shërbimeve komunale, sipas rregullores mbi taksat komunale për shërbime të caktuara. Gjatë vitit 2022 janë inkasuar gjithsej 12,961 euro. Sektori i tretë, zyra e prokurimit, ashtu siç e dini, funksionon me ligjin e prokurimit publik të Kosovës dhe të gjitha akteve tjera nënligjore. Ndonëse me tre punëtorë në këtë shërbim, meqenëse kemi hasur edhe në probleme sa i përket edhe zyrtarëve për trajnim, meqenëse është një fushë jashtëzakonisht e ndjeshme, zyrtarët të cilët nëse dëshirojmë ta shtojmë kapacitetet duhet t'i njedekin trajnimet nga AQP. Megjithatë, jemi munduar t'i përballojmë sa më mirë të gjitha procedurat të cilat janë kërkuar për mbarëvajtjen qoftë të projekteve të mallrave dhe shërbimeve, qoftë edhe ato të investimeve kapitale. Gjatë vitit 2022, kjo zyrë ka zhvilluar gjithsej 167 aktivitete të prokurimit, me një vlerë totale të parashikuar të kontratave prej 5,714,448.57 euro, dhe si rezultat, realizimi i projekteve të investimeve kapitale, mallra dhe shërbime, arrin vlerën prej 4,759,189.98 euro, shumë kjo e cila iu bë në formë pagese operatorëve të ndryshëm ekonomikë, qoftë vendas të cilët operojnë nga komuna e dragashit, apo qoftë edhe operatorëve tjerë nga tërë Kosova. Një faktor tjetër i cili e dëshmon edhe punën e mirë të zyrës së prokurimit dhe efikasitetin e tyre në punë, është pikërisht statistika apo përqindja e realizimit të investimeve kapitale, me të cilën dëshmojmë se afërsisht 80% e investimeve kapitale është realizuar, për dallim nga viti paraprak të cilin e kemi pasur 66%. Po ashtu, me qëllim të ngritjes së transparencës dhe llogaridhënies, të gjitha kontratat e nënshkruara nga operatorët ekonomikë janë të publikuara në ëebfaqen e komunës, janë të publikuara edhe në media të ndryshme, varësisht prej projekteve, dhe

të gjitha këto me qëllimin e vetëm që t'i mbajmë sa më afër dhe sa më të informuar qytetarët e Komunës së Dragashit, juve si Asamble dhe personat e tjerë fizikë dhe juridikë, me aktivitetet dhe mbarëvajtjet e të gjitha projekteve në kuadër të zyrës së prokurimit. Sektori i katërt është shërbimet teknike, në këtë kuadër të këtij shërbimi përfshihen autoparku i komunës, rojet e objekteve komunale, shërbimi i pastrimit të objekteve komunale dhe depoja e komunës. Sa i përket autoparkut, jemi munduar që t'i mirëmbajmë të gjitha automjetet, kemi implementuar sistemin e kërkesës ashtu siç e kërkojnë rregulloret për shfrytëzimin e automjeteve, tashmë të gjitha automjetet, siç ka qenë në planin e punës të projektuar për vitin 2022, të gjithë kërkesit apo shfrytëzuesit e automjeteve paraprakisht e bëjnë një kërkesë dhe përmes kësaj ne e evidentojmë edhe çdo lëvizje të automjeteve zyrtare, duke tentuar dhe pasur synim që të bëjmë shfrytëzimin sa më eficient të automjeteve zyrtare. Një dukuri të cilën duhet theksuar, është problematika të cilën e kemi hasur realisht na është shfaqur këtë vit, faktikisht gjatë dimrit, meqenëse DA i menaxhon edhe autobusët të cilët përdoren për transportimin e nxënësve të komunitetit, këtë vit kemi hasur në problem me autobusin i cili transporton nxënësit nga Dragashi deri në Restelicë, edhe atë problem e kemi rregulluar, e kemi servisuar dhe besoj se shumë shpejt, jo shumë shpejt po nesër besoj e kemi në qarkullim. Sa i përket sigurimit të objekteve komunale, kemi sistem rotativ të punëtorëve të cilët janë angazhuar në këtë drejtim, përkatësisht kemi tre punëtorë që merren me këtë punë. Pastrimi i objektit po ashtu është në shërbim i cili është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe pastrimin e objektit të komunës, përfshirë zyrat, hapësirat brenda objektit të komunës, jashtë objektit të komunës, meqenëse siç e dini, zyrat e gjendjes civile janë zyra mobile, të cilat janë të shpërndara në tërë territorin e komunës, me qëllim që të jenë sa më afër shërbimeve për qytetarë. Sa i përket deponëse të komunës, shërbimi është i organizuar nga një zyrtar komunal apo depoist, ky shërbim është përgjegjës për pranimin e mallrave shpenzues, menaxhimin e tyre dhe shpërndarjen sipas kërkesave të personelit. Gjatë vitit 2022, të themi se ka qenë mjaft efikas, ndonjëherë si pasojë e furnizimit të mëparshëm të komunës, kemi arritur që të bëjmë furnizim edhe për institucionet arsimore, meqenëse ka qenë një moment kur janë shkëputur të gjitha kontratat nga qeveria sa i përket furnizimit me letër, kemi bërë furnizimin nga komuna me qëllim që mos të ndalojnë mbarëvajtjen e procesit mësimor. Dhe sektori i pestë dhe i fundit është njësia e IT-së. IT është zyrë dinamike, lëvizëse, funksionon në mbarë institucionet komunale, në disa aktivitete të tyre është e gjerë, meqenëse problematika është më e gjerë, kjo zyrë ka bërë intervenime rutinore nëpër kompjuterë të administratës komunale, për mirëmbajtjen e sistemit të intranetit, mirëmbajtjen e sistemit elektronik të arkivës, mirëmbajtjen e sistemit të pasurisë, kontrollimin dhe mirëmbajtjen e përditshme të serverëve komunalë, puna e përditshme në ëbfaqen e komunës, shpallje dhe gjëra të tjera të ngjashme të cilat janë pjesë e dinamikës së përditshme të kësaj zyre. Me kaq e përfundoj pjesën e raportit tim dhe DA-së, unë jam i lirë që të më drejtoni pyetje, besoj se jemi këtu që të përgjigjemi. Edhe diçka kam, para se ta mbaroj, do të kisha në lutje edhe për asambleistët, meqenëse ma herët e diskutuam temën me kryesuesin për çështjen e furnizimit me llaptopë, meqenëse jemi shumica këtu, do të doja që ta kisha një prononcim të juajin a dëshironi llaptopë apo dëshironi tabletë, meqenëse tabletët janë më praktikë për punën e përditshme të Asamblesë, ju kisha lut që të deklaroni. Ma herët pata disa kërkesa nga asambleistët që të

furnizohen me tabletë në vend të lllaptopit, mirëpo megjithatë është në dorën tuaj që të na tregoni dhe ne t'i zhvillojmë procedurat adekuate për furnizim. Faleminderit shumë! Verzioni i regjistrit qendror të gjendjes civile, praktikisht përmes udhëzimit të ri administrativ MPB, tash me qëllim që të ecim me trendet e kohës, e ka vendos një QPR kod. Çertifikatat kur lëshohen, ka edhe QPR kod, përmes QPR kodit ti mundish që me ni pajisje elektronike standarde vetëm ta fotografosh, besoj që shumica që janë më të ri e dinë, edhe mund të kie qasje në këto. Qëllimi është që të bëjmë unifikimin me sistemin e-Kosova, meqenëse të gjitha shërbimet do të kalojnë në platformën e-Kosova. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, drejtor! Fjalën e ka kërkue zotëri Munir Jonuzi dhe pas tij zoti Nedzmidin Sejdilar.

Munir Jonuzi: Dëshiroj të vlerësoj punën e kësaj drejtorie, si dhe faktin që ata ndihmuan dhe e zgjeruan punën gjatë muajve të verës kur kishim një fluks të shtuar të qytetarëve. Drejtori është shumë energjik dhe ndoshta ishte një shembull i vërtetë për punonjësit e tij, ndaj as orari i zgjatur i punës nuk ishte i vështirë për ta. Ky është një drejtori dinamike me shumë detyrime. Ai që punon bën gabime. Dëshiroj të tërheq vëmendjen vetëm për një gabim teknik të shkruar në raport dhe ka të bëjë me vitin 2021. Shpresoj të qëndroni deri në fund dhe të prisni që unë të replikohem dhe të mos e lëshoni seancën siç bëri drejtori i arsimit. Në fjalë ishte pozita e koordinatorit për mësimdhënien e komuniteteve joshumicë. Ashtu është, zyrtari që ka punuar në atë pozitë ka shkuar në Prishtinë, ajo pozitë është i ngrirë, megjithatë ka diçka që quhet hapja e konkursit për një periudhë të caktuar kohore. Unë nuk ju kërkova punë, ju kërkova një ofertë pune për një periudhë të caktuar kohore. Ne që punojmë në arsim e dimë që nëse një punonjës shkon në pushim pa pagesë ose një mësuese në pushim të lehonisë, ne marrim menjëherë një zëvendësues për një periudhë të caktuar kohore. Imagjinoni në arsim që një punëtoare ka shkuar me leje lehonie dhe ne kemi mbetur pa 10 mësimet për 12 muaj. Pra, ky është një justifikim që nuk mban ujë. Sado që të punojë drejtori, sado të mundohet, nuk mund të zëvendësojë një punonjës. Tjetër gjë, gjatë miratimit të buxhetit të shtatorit ju tërhoqa vëmendjen dhe i kërkova drejtorit të administratës si dhe drejtorit të financave që të gjenin një mundësi ligjore, e dini si është organigrami i zyrës për barazi gjinore, sa punonjësit duhet të jenë aty, prandaj kërkoi nga ju që të gjeni një mundësi ligjore për të na mundësuar të punësojmë një punonjës më shumë nga komuniteti jo-shumicë, në mënyrë që të lehtësojmë komunikimin me gratë nga komuniteti jo-shumicë. Kemi shumë ankesa se femrat nuk janë të informuara e të ngjashme, dhe në këtë mënyrë do të rritej përqindja e të punësuarve nga komunitetet joshumicë dhe femrat në institucionet publike. Ju lutemi gjeni një mundësi ligjore për të zbatuar këtë propozim.

Nedzmidin Sejdilar: I nderuar drejtor, para disa kohësh na keni sjellë disa fotografi që tregojnë arkivat komunale që janë në gjendje katastrofike dhe jeni angazhuar për zgjidhjen e këtyre arkivave. A ju ndodh të keni foto të atyre arkivave siç i keni rregulluar tani. Dhe a keni parë arkiva të tjera të dikastereve të tjera, si është gjendja e tyre, sepse ka vende nga dalin minjtë. Një gjë tjetër

më intereson: sa vetura ka komuna e Dragashit. Jam i interesuar për përdorimin e veturave zyrtare, kush ka të drejtë të përdorë automjetet zyrtare të komunes 24 ore. Sipas ligjit dhe statutit do të thosha vetëm kryetari i komunës. E treta, a mund t'i kërkonit transportit që i kthen fëmijët në fshatin Krstac t'i sjellë në mëngjes dhe pastaj ta merrni xhipin nga shefi i zyrës së komunitetit. E shoh që shefi i zyrës për komunitete po buzëqesh, do të bëjë gjithçka, vetëm xhipin nuk e jep. I hiqeni xhipin dhe në kursejme pak në buxhet dhe shpenzime, nuk detyrojmë asnjë zyrtar këtu se jemi të gjithë të barabartë si e dikton ligji, qofte, pse ka privilegj të përdorë shefi i zyrës së komunitetit automjetet. Pyetja është nëse shefi i zyrës për komunitete kur të vinte me veturë private do t'i merrte ata fëmijë. Sa i përket tabletave dhe laptopëve, mendoj se në të gjithë kemi telefona dhe ata kanë të njëjtën madhësi si tabletët. Këshilltarët kanë nevojë për laptopë për të përgatitur materialin për seancën.

Vetim Ramadani: Faleminderit Munir edhe zoti Sejdilar për pyetjet tuaja! Përderisa drejtori i Arsimit nuk është këtu, unë, meqenëse organizimi i qeverisjes lokale është i tillë që secila drejtori ka një drejtor të vetin, unë nuk e shoh të arsyeshme, meqenëse nuk është çështje e ngutshme, është më mirë që drejtori të jetë këtu edhe të japë një përgjigje më të saktë se si qëndron problematika në lidhje me koordinatorin për arsim në gjuhën boshnjake. Sa i përket Zyrës për Barazi Gjinore, trajtimin e lëndëve apo rastet të cilat ju i parashtroni, kompetentë, ashtu siç e theksoi edhe ma herët gjatë raportimit të saj zyrtarja për Barazi Gjinore, e cila funksionon sipas ligjit në kuadër të zyrës së kryetarit, nuk është përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Ka mekanizma të tjerë, është QPS-ja dhe mekanizma tjerë përcjellës të institucioneve tona të cilat i trajtojnë këto raste. A është e mirë, jashtëzakonisht është e mirë, a e pranojmë, e pranojmë, mirëpo mbetet të shiqojmë mundësitë si mundim me realizue në të ardhmen një gjë të tillë, nuk jemi kundër që të ofrojmë shërbime sa më të mira në raport me qytetarët tanë, qofshin ata të komunitetit shumicë apo joshumicë. Sa i përket pyetjes në lidhje me arkivat që e bëri zoti Sejdilar, pasqyra ma e mirë e arkivave edhe fotoja ma mirë ilustrative e arkivave, mundish me ardhë nesër me shkue me i pa vetë, qekjo është pasqyra ma e mirë, edhe me i pa karriget, kur të dush, mujm m'i pa edhe shkëmbimet e emailave që i kemi bo për trajnimin e ni zyrtari. Sa për informacionin tënd, ne kemi marrë në punë ni person, i cili do të merret vetëm për çështjen e sistemimit të arkivës, gjë e cila nuk ka qenë në komunën tonë. Kemi kontaktuar agjencinë, kemi biseduar me ta, kanë bërë matjet dhe shumë shpejt ata do të vijnë do të bëjnë rregullimin e të gjitha arkivave, jo vetëm sa i përket zyrës së gjendjes civile, do të bëjë strukturimin e të gjithë arkivës, qoftë të çështjeve financiare, të zyrës së personelit dhe zyrave të tjera. Sa i përket pyetjes tuaj në lidhje me sa vetuar ka administrata komunale. Sa i përket numrit të veturave zyrtare, për këtë punë ekziston ni zyrë, në të cilën punon zyrtari i pasurisë komunale, ato janë të gjitha këto statistika. Unë munda më jau dhënë, Komuna e Dragashit në tërësi posedon 33 automjete, prej të cilave 7 nuk kanë targa zyrtare. Arsyeja nuk është pse s'kanë targa zyrtare për keqpërdorim, por sepse kanë qenë të dhuruara nga agjencionet, nga ndonjë ambasadë apo institucione të tjera. Sa i përket pyetjes se kush ka të drejtë të përdorë veturë, vetura kanë të drejtë të përdorin të gjithë zyrtarët komunalë, 24 orë e përdorë kryetari i komunës, por kemi edhe shoferë të autobusëve të cilët, për çështje të veprimit sa më të mirë në teren, e merr veturën në shtëpi. E kemi rastin e një shoferit i cili pikërisht i transporton nxënësat për të cilën ti, me gojën plotë, dalish këtu edhe jau u mbrojsh të drejtat, nxënësit e komunitetit joshumicë, është

person i cili në ora 05:30 del nga shtëpia, në ora 05:30 nuk ka asnjë transport të organizuar që ta sjellë shoferin në fjalë nga fshati Plavë për në Dragash. Për këtë arsye, për lehtësimin logjistik, ka përjashtime. Por qëllimi është gjithmonë transportimi i nxënësve apo kryerja e punës. Ka raste kur kemi edhe zyrtarë të cilët duhet të shkojnë në ndonjë trajnim jashtë vendit, ata pa dyshim që nisën ma herët, ne i pajisim sot për nesër. Në pyetjen tjetër që a ka mundësi me i përfundue këto punë shoferi tjetër, për rastin e transportit të nxënësve nga fshati Kërstec gjer në Rapçë dhe në Dragash. Komuna e Dragashit ka gjithsej dy shoferë të cilët merren me transportimin e nxënësve, që janë të pajisur me kategorinë D, dhe këta dy shoferë kanë dy destinacione diametralisht të kundërta, njëri Dragash-Restelicë, tjetri Dragash-Brod, aspak nuk puthiten mes vete. Orari i shkollës nuk mund të ndryshojë, për këtë arsye ne kemi bërë zgjidhje, kemi caktuar zyrën për Komunitete. Por, edhe këtu ka diçka tjetër, Zyra për Komunitete, vetura të cilën ti po i apostrofohesh, duhet ta dish edhe diçka Nexh, foltorja e komunës është turp i Zotit m'u përdorë si thikë e shpatë për inate tua personale. Hajde këtu fol për sende që duhet me folë, ngrite zërin për autobusin që është prish, po jo me i mshue ni filan zyrtarit atje që ti s'e kie qef, po supozoj se nuk e di, ndoshta keni shumë shoqëri, po nuk është korrekte. Sa i përket asaj, na kemi edhe statistika, vetura e cila i transporton nxënësit nga Kërsteci gjer në Rapçë dhe gjer në Dragash, janë dy vetura, unë i di edhe targat, nëse dush t'i tregoj edhe blloqet që i plotësojnë, është vetura 04Z 11 05 dhe vetura 04Z 13 05, mitsubishi dhe toyota. Këto dy vetura, për me ta tregue sa përdoret në mënyrë eficiente, njëra i shpenzon 1200 litër naftë në vit, tjetra i shpenzon 1400 litër naftë në vit, për të gjitha këto kemi dëshmi. Po dëshmitë nëse dush në mënyrë shoqërore t'i ofroj, nëse duosh në mënyrë zyrtare bone ni kërkesë për qasje në dokumente zyrtare . Sa i përket a kemi mundësi me largue kerrin, me e ndryshue prej Zyrës për Komunitete, unë e di që është dëshirë e jotja, po dëshirë e jemja nuk është me ia lënë Zyrës për Komunitete, as askujt, po mundësitë logjistike e bëjnë të veten, unë prej fshatit Blaç s'muj me shkue çdo mëngjes në Kërstec m'i marrë nxënësat. Hajde na ofro ti një zgjidhje, na ilumino, jemi me ty, kurdo që të kie kohë, hajde tek unë e diskutojmë, bëjmë zgjidhje. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, drejtor! E ka kërkuë ni minutë replikë zoti Sejdilar, mirëpo paraprakisht e kisha lut kryetarin që mos të del jashtë nëse ka durim me më dëgjue, se due me marrë fjalën nja dy minuta edhe unë. Është fjala të DA u cek puna e automjeteve, sa i përket raportimit në aspekte të tjera, unë nuk di që drejtori e bën, punë me të cilën ma së shumti merret është puna e automjeteve, duhet të ju tregoj edhe qytetarëve, zakonisht unë e respektoj hierarkinë edhe kur më vyn ndonjë veturë për udhëtime jashtë komunës sonë, gjithmonë ia bëj kërkesën drejtorit, bile e njoftoj edhe përmes telefonit. Në takimin që e kam pas me kryesues te komunave të Kosovës në Prishtinë, unë jam vonue gati ni orë, sepse drejtori, më kanë thënë që duhet me shkue me ni zyrtar të komunës që ka pas me shkue atë ditë. Ai zyrtari ka pas kohë mjaft, ka vozit qaq kadal saqë mu më ka vonue shumë në atë takim. Rasti i dytë që kam respektue hierarkinë ka qenë ni rast kur e kemi pas ni takim me OSBE-në, aty kanë qenë edhe disa delegatë të pranishëm, e kam thirrë drejtorin e Administratës, i kam bë kërkesë që me ma dërgue ni veturë me më sjellë deri në Dragash se e kisha të pamundshme për me sigure atë, përgjigja që mu më ka dëshpëruë keq u konë një gënjeshtër e ulët, që mu s'më ka pëlqye absolutisht, ajo më ka zhgënjue maksimalisht,

më tha që të dy fordat janë në Prishtinë, edhe për momentin s'kam as edhe shofer, mundohu tha me ndonjë inxhiner nëse është andej në teren po ta dërgoj, po që jo, bëni zgjidhje vetë. E bëj një zgjidhje vetë, kur erdha para komunës të dy fordat të parkuar, edhe shoferat duhet m'u konë aty po besoj, meqenëse veturat veç ishin të parakuara para komunës. Edhe është mirë që mos të dalim keq na si komunë edhe përpara kryesuesve të komunave të tjera, se unë u vonova edhe realisht jau tregova edhe arsyen pse u vonova, thashë që po e keqpërdorin hierarkinë, unë e respektoj hierarkinë e tjetrit, ai e keqpërdor hierarkinë e vet. Kjo është shumë e ulët drejtor, uroj që mo mos të ndodhin këto. Edhe mundësisht ni përgjigje me ma dhënë mas replikës së zotit Sejdlar. Faleminderit shumë!

Nedžmidin Sejdlar: Është ora 4:30, nëse i ka sjellë fëmijët në orën 8:00, atëherë fëmijët presin deri tani. Dhe nëse shkon për t'i marrë në shtëpi në orar të punës, atëherë dëmton punën e zyrës së komunitetit. Menaxhimi juaj është i keq. Tajmingu i juaj është shumë i keqe. Është e nevojshme të dihet se kush kryen cilin funksion. A është shofer apo është shef i zyrës së komunitetit. Nëse transporton fëmijë, duhet të bëjë vetëm atë punë. E di që nuk e bën fare punën e tij, ose i vozit fëmijët ose i shkruan statuse Kryetarit për në Facebook, ose promovon komunitetin bullgar në Kosovë. Ai bën gjithçka përveç punës së zyrës së komunitetit. Unë nuk e kam problem që ai të transporton fëmijët. Problemi im është se ai nuk po bën punën e tij. Prandaj ai është shumë i vrazhdë dhe jep një shembull shumë të keq për qytetarët kur voziten atë anije të bardhë.

Vetim Ramadani: Faleminderit, kryesues, masi ke parafolësi i fundit, po ia jap fillimisht Nexhës përgjigjen. Nedžmidin, si shok po ta jap ni këshillë, duhet me u njoftue mirë. Transporti që po thuesh ti është sepse Uzair Hamza është prej Kërstecit, në mëngjes i bjer nxënësat, është shumë e vërtetë, atë që ti po duesh me e hedhë është ndryshe, se nuk i dërgon Uzair Hamza mbrapa, po ndërkohë për t'i rikthyer prapë në Kërstec lirohet edhe Rexhep Bojaxhiu nga Brodi, dhe ai e kryen transportin. Për këtë arsye po ta jap këshillën, për me u njoftue, ai i dërgon prapë. Sa i përket kryesuesit, në lidhje me atë që e thaje, është një rregullore për shfrytëzimin e automjeteve zyrtare. Në bazë të rregullores, duhet m'u konë i sinqert kryesues edhe me i tregue këtu Asamblesë Komunale që ti je ai i pari që nuk e respekton rregulloren, sepse në rregullore duhet të njoftohesh minimum dy ditë para se të ndodhë vozitja zyrtare. I përmende takimet me OSBE-në, me aq sa ne si komunë kemi bashkëpunim, Bilali është këtu, mundet me dalë në foltore nëse ju ja jepni fjalën edhe me na pohue a i dërgojë ma herët paraprakisht, unë me sa kam përvojë, ni javë më herët i dërgojnë ftesat. Pse pritet dita e fundit me telefonue. Edhe tjetra kryesues, jeni kryesues, përmbahuni gjuhës, sepse t'i thuash ni drejtori gënjeshtër e ulët është ofenduese, unë nuk dua të lëshohem në atë zhargon, po ni gjë munda me thënë, nëse nuk kie dinakëri të mjaftueshme me gënjye, është mirë me pas guxim me thënë të vërtetën, se sa herë ke thirrë ta kemi ofrue mundësinë. Jo obligim s'e kam, se ti e kie obligim me ma dërgue ma herët ftesën, ti s'ma ke pru. Edhe tjetra, për dëshmi të lus ktrejt çka kie bujrum i diskutojmë. Duhet me pas guxim me e thënë të vërtetën, ma së pari duhet me ditë sa forda i ka komuna, forda i ka 4 komuna, mirëpo i ka dy shofera, me dy shofera unë s'mundi me i çue dy vetura, ni shofer me i vozit dy vetura në të njëjtën kohë, të kam tregue shumë mirë shoferat janë në rrugë, edhe dy forda tjerë i ka Kuvendi Komunal, por ata

s'kanë shofer. E, nëse ke kërkue unë me ardhë me të marrë prej Blaçit e me të pru këtu, e atë send harro.

Uran Halimi: Faleminderit! Më duhet me replikue, kam të drejtë. I nderum drejtor, për atë që e ke bo jam shumë i guximshëm me thën se e ke bo, sa i përket guximit duhet me pas guxim sidomos kur ta thuesh të vërtetën e kur të ka dëshmi. Ajo që është mëse e vërtetë është që thaje, po të kallxoj bash saktësisht qysh më ke thonë, nuk e kam asnjërin ford, s'është pa qare ti me ardhë me më marrë se hiç s'më pëlqen ti me ardhë me më marrë drejtor, mu më duhet shoferi me ardhë me më marrë, se unë e di që ka shofer, komuna jonë pagujmë shofer për këtë punë, ti absolutisht s'duhet me ardhë me më marrë, edhe të lutem mos e bën këtë në të ardhmen. Po atë që e thashë unë i qëndroj se është shumë e vërtetë, ta argumendoj qysh duesh edhe kur të duesh, nëse të vijnë argumente unë t'i sjelli. Realisht, kryesues të komunave që unë i takoj në Prishtinë, ata më thonë që kanë vetura dhe kanë pas vetura 24h në shërbim, edhe unë duhet ta kem 24h në shërbim, po mu s'më vyn se unë vetë s'due me e vozit atë veturën zyrtare, ju jeni të obliguar që 24h me më ofrue transport. Mënyra kur unë kërkesën e boj, unë zakonisht ta bëj ni ditë përpara kërkesën dhe këtë ta argumentoj, edhe sa i përket asaj se duhet ni javë ditë me bo kërkesën, ka raste kur thirrja na vjen ma afër sesa ni javë, unë s'un ta boj me pretendue ni vozitje në Prishtinë, se s'më vyn mu ajo, kur due me bo ni udhëtim personal unë hiç s'e kursej as veten as kërkond, absolutisht s'due me e shfrytëzue institucionin e veturën zyrtare, kurrë në jetë s'e bëj. Kjo është arsyeja pse unë due shofer. Mundesh me e marrë fjalën ni minutë replikë, pas teje z.Edin Kurt dhe pas tij z.Uzair Hamza.

Vetim Ramadani: Faleminderti, kryesues! Nuk bën me keqinterpretue, thashë ni javë ditë ma herët me bo kërkesën, thashë ni javë ditë mundish me u informue, thashë dy ditë ma herët me u njoftue kërkesa. Ka procesverbal, në seancën e ardhshme mundesh me kqyr a kam thënë kështu. Tjetra, se unë e di shumë mirë që ti s'mundish me parashikue çfarë trajnimi vjen prej OSBE-së ose prej USAID-it, po dy ditë ma herët bëhet. Tjetra, vozitje 24h veturat kush kanë komunat tjera, na bjer bazën ligjore e rregullojmë. Me ligj, vozitje 24h veç kryetari i komunës, edhe vozitës, ai madje ka vozitës të veçantë, ka staf politik të cilin e emëron, që është njeri i besueshëm i tij. Ndërsa stafi tjetër që e kemi, ne kemi gjithsej dy shoferë, arsyeja pse ndodhin këto probleme është pikërisht pse dy shoferët, kur gjenden në teren, unë nuk kam mundësi, ndonëse kam vetura të lira, unë nuk kam mundësi për t'i dërguar, unë nuk mundi me dërgue ni zyrtar komual që me ardhë me vozit dikë tjetër. Pikë së pari nuk pranojnë, pikë së dyti është kundër ligjit. Për këtë arsye. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, drejtor! Të ftoj publikisht me ma sjellë dëshminë ku shkrun që unë dy ditë përpara duhet me bo kërkesën për veturë zyrtare, ma sill udhëzimin administrativ, rregulloren, çkadoqoftë ajo, po ta kërkoj atë nëse mundesh me e bo, edhe unë do ta bëj publike nëse ti ma sjellish, edhe të kërkoj falje publikisht. Tjetra është që ajo vetura zyrtare 24h thashë që s'më vyn mu, as qe e kërkova atë, edhe nëse s'keni ju shofera edhe keni nevojë për ma shumë shofera, shtojeni numrin e shoferave, çka kam faj unë ju a keni shofer a jo, kur është diçka që ti e kie obligim me ma sigurue, mos të shkoj me këdo, unë due shofer me veturë zyrtare me më çue kur mu më kërkohet, kur është paraparë takimi, a shkoj ma herët a jo. Pa problem, ti duhesh me

ma sigurue atë udhëzimin administrativ që mu më obligon dy ditë përpara me bo kërkesën për veturë zyrtare. Kryetari e ka lyp fjalën.

Bexhet Xheladini: S' di a u dashtë m'u bo kjo replikë për automjetet, se na e kemi bisedue edhe ma herët, je kryesues i Kuvendit edhe kerrin kie me pas në shërbim, kur kie nevojë për udhëtime zyrtare. Unë e di që nuk do të kesh probleme fare, si ka ndodhë ka ndodhë, unë nuk e di, e dini ju të dy, po unë ja kam que edhe ni email zyrtar, ty s'të ka ardhë, që ata të cilët dojnë me udhëtue zyrtarisht, duhet si dëshmi me ofrue edhe emailin ku po shkon, kuje i ftuar, dhe pastaj drejtori i Administratës është i obliguet me ta sigurue automjetin. Nëse s'ka shofer, munden me ta dhënë kerrin edhe me shkue vetë, ky problem zgjidhet dhe s'kie nevojë mo me replikue edhe me hup kohë.

Uran Halimi: Sa i përket asaj, unë nuk i thashë kurgjo drejtorit, e kam respektue vazhdimisht deri kur më është keqpërdor respekti, kështu që është mirë mos me keqpërdor as unë pozitën që e kom, as drejtori pozitën, thjesht me e respektue. Unë nuk kërkoj repsektin e drejtorit në aspektin privat, munden hiç mos me më respektue, po këtu e kam drejtor, jam kryesues, e kërkoj atë që më takon. Jo s'të kam ofendue jo, e ke bo, nuk është që të kam ofendue, i qëndroj asaj. Faleminderit shumë kryetar, ni minutë replikë z.Uzair Hamza.

Uzair Hamza: Po lajmërohem në lidhje me disa të pavërteta të nxjerra nga kjo foltore nga këshilltari Nedzmidin Sejdilar, të cilat pretendohet se kanë të bëjnë me promovimin e minoritetit bullgar. Së pari, dua të theksoj se shumica e njerëzve e njohin qëndrimin tim në lidhje me përcaktimin kombëtar. Unë kam marrë pjesë në takimin zyrtar kur ishte këtu nënkryetare e Bullgarisë dhe gjatë kësaj kam paraqitur atë që e konsideroj të rëndësishme për komunitetin tonë. Në atë takim ndër të tjera përveç meje dhe drejtorave ishin të pranishëm edhe përfaqësues të tjerë të strukturave politike. Unë apostrofova se, para së gjithash, dua të falënderoj shtetin bullgar që ka mundësuar një numër të nxënësve nga komuna jonë të studiojnë, numri nuk është aq i madh sa në Zhupë, rreth pesë studentë nga komuna jonë studiojnë në Bullgari. E përmenda edhe se ky popull në Gorë është shumë i vetëdijshëm për përkatësinë e tij kombëtare. Unë kam dëshmitarë për këtë që them. Dhe se këta njerëz që jetojnë këtu nuk janë si ata në Shqipëri, ku kombi ishte i ndaluar për një kohë të gjatë, ashtu si ju që keni jetuar në Bullgari në periudhën e komunizmit. I kërkoja zëvendës-presidentes së Bullgarisë që të mos keqpërdor benefite dhe përfitimet e Bashkimit Evropian, sepse të gjithë e dimë se një numër i madh i qytetarëve tanë që kanë aplikuar për shtetësi bullgare duan ta ushtrojnë atë të drejtë pikërisht për arsye ekonomike. E përmenda, për shembull, se vetëm në fshatin Rapqë kemi rreth 1600 pjesëtarë të komunitetit tonë që kanë nënshtetësi austriake. Çka ka keq këtu? Është keq për shtetin e Kosovës sepse i kemi humbur ata qytetarë si qytetarë të Kosovës. Sepse shteti i Austrisë njeh të drejtën e vetëm një shtetësie. Dhe nëse e gjithë kjo është kështu, e pyes zotin Sejdilar me cilin ligj ndalohet të jesh bullgar në Kosovë. Kosova është shtet demokratik. Nëse nuk keni dëgjuar për ligjin kundër diskriminimit, lexoni më tej. Madje është edhe gjuha e urrejtjes, neni 147 i K.Penal, pra, para së gjithash dikush më akuzon, por unë jam krenar për këtë. Do të përdor një term sportiv, sulmohen futbollistët më të mirë si Messi,

Ronaldo dhe nuk është rastësi që sulmohem çdo ditë nga kjo foltore. E di që Nedzmidini nuk mendon kështu, por dikush i ka thënë kështu. Dhe më vjen keq për këtë.

Edin Kurt: Pershendetje. Sa i përket drejtorit të administratës, do të jetë shumë i shkurtër, dua t'ju lavdëroj ju dhe punën tuaj, mund të shihni progres në administratë, si në komunë ashtu edhe në sektorë të tjerë. Unë kam dy vërejtje për sektorin apo administratën tuaj. Nënkryetari për Komunitete Fejsal aplikoi për një laptop dhe meqë nuk mundi të merrte një laptop, ai përdor një laptop të vjetër që ishte përdorur para tij nga një nga këshilltarët që e ktheu. Gjithashtu, ka paraqitur kërkesë për një kartë zyrtare, mund të ketë qenë një vit më parë, por ende nuk është bërë asgjë, nuk ka marrë atë që ka kërkuar. Unë po ju kërkoj t'i zgjidhni këto probleme sepse janë të vogla dhe mund të zgjidhen.

Nedžmidin Sejdilar: Zoti Hamza, si dëshmi e pohimit tim, janë deklaratat që keni dhënë për mediat shqiptare në Prishtinë, kur keni thënë për djalin tuaj, sipas mediave shqiptare, se ai është i afërmi juaj. Përfaqësues të organizatës joqeveritare Bullgarët e Bashkuar të komunës së Dragashit, njëri prej tyre është djali juaj, mediat shqiptare shkruajnë se mohoni ata, jo mua. Si këshilltar aktiv lexoj çdo shtyp. Ju jeni një nëpunës publik dhe nuk keni të drejtë të zemëroheni. Dhe të paktën thuaj që unë kam një sufler këtu. Unë nuk kam nevojë për një sufler. Çfarë do të bëjë sufleri? Unë them atë që marr vesh, atë që vërej. Unë kam të drejtën e mendimit tim. Nuk është shkelje e ligjit që kam të drejtën e mendimit tim. A nuk është turp që nënkryetari i komunës nuk ka laptop. Ose për të marrë një kartë zyrtare. Çfarë lloj nikoqira jeni.

Vetim Ramadani: Faleminderti, zëvendëskryesues! Faleminderit Edin për pyetjen, sa i përket llaptopit për nënkryetarin e komunës, nuk është e vërtetë atë që e tha parafolësi këtu që Fejsali nuk ka llaptop, Fejsali ka llaptop po mund të jetë i vjetër, për atë arsye unë ju njoftova paraprakisht që kemi pas problem me furnizimin, edhe absolutisht nuk ka kurgjo të keqe, e keqe do të ishte nëse ne do të kishim në stok llaptopë të ri dhe nuk do t'i jepnim në shfrytëzim njerëzve tanë, përndryshe, gjërat tjera të cilat mund t'i porosisim, pse jo? Mirëpo ne nuk kemi marrë asnjë zyrtari tjetër, nëse ka ni dëshmi që ni zyrtar ka pas llaptop, atëherë në rregull jemi, po nuk ka pas ni gjë të tillë, në të ardhmen mbetet me bo. Sa i përket kartelave zyrtare, është fakt, nuk është vetëm Fejsali, shumë mirë që e ngritet ju, është fakt që pothuajse tërë stafi politik nuk kanë kartela të përditësuara. Kjo besoj që rregullohet shumë shpejt, zyra e personelit ka qenë jashtëzakonisht e ngarkume, nuk po due me arsyetue absolutisht, se nuk ka arsyetim mos me u ndërrue kartelat, por besoj që do të marrim hapa të nevojshëm për me rregullue edhe këtë çështje. Nuk është vetëm Fejsali, edhe një herë po e theksoj, janë thuajse i gjithë kabineti i kryetarit, përjashtim të zyrtarëve civilë, të cilët e kanë. Faleminderit!

Uzair Hamza: Dua të përsëris pohimet e TV 7, kam dhënë një deklaratë para televizionit në prani të kolegëve të mi dhe është e qartë se zëri im po mbulohet me një përkthim në shqip. Unë deklarova

se në regjistrimin e popullsisë në Kosovë të vitit 2011, në komunën e Dragashit jetojnë më shumë se 8700 Goran, 4100 boshnjakë, 202 turq dhe 300 të padeklaruar. Në takim konfirmova zyrtarisht se nuk ka bullgarë. Megjithatë, thashë në takim, që ne rast do të deklarohet dikush, jam i obliguar të përfaqësoj interesat e të gjitha komuniteteve. Ju ftoj gjithashtu, në bazë të statistikave që kemi, kemi rreth 2000 kërkesa për pasaporta bullgare. Nuk kam guxim t'i them shtetit bullgar mos u jep pasaporta. Nese ti thua keshtu le ta degjojne njerezit tane qe na thone ti merr rroga ketu, ne nuk te sherbejme si makineri votimi dhe ti na kerkon qe Bullgaria te mos na jape pasaporta qe te jemi votuesit tuaj. Nuk kam forcë ta them këtë. Unë i përfaqësoj të gjithë njëlloj, sido që të deklarohet dikush në listë, unë do ta përfaqësoj.

Uran Halimi: Faleminderit! Fjalën e fundit e ka kërkuar kryetari, edhe me sot e ndërpresim seancën për me vazhdue...le ta kryen fjalën kryetari edhe po ju tregoj.

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, vizita e personit numër dy të shtetit të Bullgarisë, ni shtetit mik të Kosovës, i cili e ka njoftë Kosovën, ka qenë një vizitë zyrtare, dhe unë jam shumë falënderues që personi numër dy ka gjet kohë me ardhë me vizitue kryetarin e komunës, kur vizitohet kryetari i komunës vizitohen krejt qytetarët e Komunës së Dragashit. Ka qenë një vizitë shumë konstruktive, shumë frytdhënëse, mirëpo disa persona këtë vizitë – ajo ka qenë vizitë zyrtare, me leje nga qendra, ajo ni ditë ma herët ka ardhë në Prishtinë, ka marrë pjesë në festimin e ditës së Pavarësisë, ajo ka ardhë me e vizitue komunën tonë me leje të presidentes së Kosovës. Ka ardhë me ni eskort jashtëzakonisht të madhe, unë jam habit, dhe e vetmja gjë që ka pyet zëvendëspresidentja,masi e kam bë një ekspozitë të shkurtë të Komunës së Dragashit, ku i kam thënë që në këtë komunë jetojnë tri komunitete, shqiptar, goran dhe boshnjak, masi e kam krye ekspozitën time, ajo e ka marrë fjalën, ka qenë shumë konstruktive në bisedë, edhe në fund të takimit ka pyet a ka në Komunën e Dragashit bullgarë. Këtu ka edhe dëshmitarë që kanë qenë aty, unë jam përgjigj që unë nuk kam njohuri që në komunën tonë ka bullgarë, zyrtarisht nuk ka, por kam njohuri se shumë qytetarë të Komunës së Dragashit kanë kërkesa për pasaporta bullgare edhe kanë pasaporta bullgare. Tash ata a janë bullgarë, a ka dyshtetësi a qysh janë ata nuk e di, atëherë e ka marrë fjalën Uzair Hamza, i cili ka qenë jashtëzakonisht konstruktiv dhe i ka mbrojt interesat e regjionit të Gorës, si të komunitetit boshnjak, ashtu edhe të komunitetit goran, dhe ka nxjerrë statistikën, i ka tregue që në komunë tonë nuk ka të deklaruar asnjë bullgar. Dhe pastaj, pas kësaj, nënkryetarja e Bullgarisë e ka vizitue fshatin Kërstec, ku do të thotë aty janë grumbullue nifare shoqate kongra 'Bullgarët e bashkuar', dhe aty flitet që kanë shkue shumë qytetarë të cilët e kanë prit atë, dhe normal, ata që e kanë prit kishin pas edhe kërkesa për pasaporta bullgare. Kështu që, nuk është mirë kjo punë të politizohet edhe t'i vishet ndonjë etiketë dikujt që është ky bullgar ose s'është ky bullgar. Nënkryetarja në fund të takimit ka thënë ju jeni shtet demokratik, shtet multi-etnik, unë këtë e respektoj, andaj mos jau kufizoni njerëzve deklarimin e tyre se çka mund ata të regjistrohen. Në atë takim ka qenë edhe asambleisti nga radhët e PDK-së, nëse don edhe ai me sqarue, ju kisha lut me ia dhënë fjalën edhe asambleistit. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit! Fjalën e ka z.Nexhat Selaj.

Nexhat Selaj: Faleminderit edhe ni herë! Kryesues, ju kisha lut radhëve tjera, këto zënkat e juaja në qeverisje njëri me tjetrin neve na konvenojnë si opozitë, po të paktën para qytetarëve mos t'i dëgjojnë këto, ju e keni kabinetin, kryeni këto mes veti, mos i qitni këtu pamjet që t'i shehë popullata. Të jeni pak më të vëmendshëm edhe ju edhe drejtori i Administratës. Sa i përket vizitës së delegacionit bullgar, unë e prita se kryetari ndoshta do të më ftoj që të flas dhe të dokumentoj sinqerisht edhe me seriozitetin më të lartë për atë takim të cilin ishte. Më vjen mirë që kryetari në atë kohë ka ftuar edhe të gjithë partitë politike, pasi që ishte në interes të Komunës së Dragashit, dhe ne si PDK gjithmonë kemi rrit karshi këtyre, gjithmonë kur ka qenë koha vendimtare që të flasim që të mborjmë interesat edhe të kombit po edhe të bashkësisë lokale të jemi bashkë. Mu po më vjen mirë, e falënderoj kryetarin që më ka thirrë, aty ni herë e përgjithmonë i është largue nga koka bullgarëve se në Komunën e Dragashit ekziston popullatë bullgare, ne e dimë shumë mirë, unë vetë jam gjeograf, që nga statistikat 51- 61-71-81, të cilët janë administruer nga qeveria ish-jugosllave, popullatë bullgare nuk ka pas. Shumë me theks të veçantë Uzair Hamza e ka deklarue atë edhe e kam dëgjue vetë, pasi që komuniteti goran, pavarësisht nga gjuha iu duk atyre bullgarëve se është ma i afërt, shumë mirë e ka precizue se në Komunën e Dragashit nuk k apasur asnjëherë popullatë bullgare. Përjashtimisht, kanë mund të janë vitet '90-ta apo pas vitit 2000, që për shkaqe ekonomike njerëzit kanë poseduar ose kanë marrë leje edhe kanë marrë pasaporta bullgare. E drejta e bullgarëve është që ta ftojë popullatën bullgare në Komunën e Dragashit dhe çdokund tjetër, por nuk është politizue diçka tjetër. Unë nuk di, në atë moment derisa kemi qenë bashkë me kryetarin këtu, me Uzairin unë nuk di çka është bisedue diçka, jashta atij momenti që unë kam qenë këtu, ndoshta ka mund diçka unë s' e di, nëse din dikush lirisht le të del le të urdhërojë. Pra ka qenë fjalë përfundimtare edhe e kryetarit, edhe e Uzairit, të cilët ne të gjithë e kemi mbështet, se popullatë bullgare gjenetkisht, në aspektin e gjuhës si e citoi Uzair Hamza. Qeshtu ka qenë. Nëse ju keni informacione që është diskutue diçka tjetër, lirisht dilni.

Uran Halimi: Faleminderit për fjalën i nderuar Nexhat Selaj! Po besoj që këtij debati veç i ka ardhë fundi, e ndërpresim seancën për me vazhdue nesër në ora 10:00.

Përsëritet të nderuar delegatë, po vazhdojmë seancën e lënë në gjysmë dje, e patëm raportimin e drejtorëve, edhe mundim pa humbur kohë me vazhdue këtu, në radhë e kemi drejtorin e Ekonomisë dhe pas tij le të përgatitet drejtori i Shëndetësisë.

Qamil Kolloni: Përsëritet për të gjithë, përsëritet kryetar, përsëritet delegatë edhe ju të tjerë të pranishëm! Unë jam munduar që në raportin tim të jem sa më i shkurtër edhe sa më konciz, që të ju jap hapësirë juve të bëni pyetje dhe bashkërisht të mundohemi ta shtjellojmë punën njëvjeçare të kësaj drejtorie. Në kuadër të DEFZH funksionojnë pesë sektorë; sektori i buxhetit, financave, zyra e tatimit në pronë, zyra për regjistrimin e bizneseve dhe njësia e thesarit. Në kuadër të njësisë së thesarit bëhet regjistrimi i pasurisë komunale. Besoj se për sektorin e parë, për buxhetin, ne gjatë vitit 2022 kemi aprovue buxhetin për vitin 2023 me vendim të Kuvendit, gjithashtu edhe KAB, të cilat kanë qenë të parapara me ligj dhe njëkohësisht me qarkoren

buxhetore 2023 1 dhe 2. Në kuadër të buxhetit edhe financave, të gjitha vendimet të cilat kanë kaluar janë miratuar në këtë Kuvend. Sa i përket sektorit të financave në këtë drejtori, para se të fillojmë punën në vitin 2022, kemi marrë për bazë të gjitha rekomandimet të cilat vijnë nga auditori i jashtëm dhe i brendshëm, dhe për ta bërë planin e kësaj drejtorie funksional, kemi filluar në bazë të planit për plotësimin e rekomandimeve të cilat dalin nga auditori i vitit paraprak 2021 dhe viteve të mëhershme. Nga të gjitha ato rekomandime, ne mendojmë se gjatë këtij viti ia kemi arrit që të plotësojmë në numër të përgjithshëm të këtyre rekomandimeve. Besoj se në pjesë të tyre i kemi të shënuara, nuk dua të ju marr kohë edhe të jau përmendi të gjitha veç e veç. Pos sektorit të buxhetit, në sektorin financiar ju e dini se kemi pas në kohën e duhur të gjitha raportet për vitin 2021, raportet tremujore, gjashtëmujor, nëntëmujor, dhe pritët që në fund të këtij muaji, realisht me daljen, me përfundimin e vitit nga SIMFK, të dalin edhe pasqyrat vjetore, do të ju sjellim edhe raportin vjetor. Sa i përket njësisë së tatimit në pronë, gjatë vitit 2022 është bërë edhe vlerësimi i pronës, që për fat të mirë ju e dini se komuna jonë ka dalë në kuptimin e përgjithshëm me rezultate pozitive, për faktin se kemi mbi pesë zona, dhe në kuadër të pesë zonave, sa i përket çmimeve, i kemi në tri zona, për faktin se kemi zonën e parë që e rrok vlerën 250 euro, të cilën gjatë vitit 2022 e kemi ulur në 240 euro, e kemi zonën e dytë e cila ka qenë 200 euro dhe e kemi ngritur në 210 euro, dhe e kemi zonën e tretë e cila ka qenë 160 euro dhe realisht kjo zonë ka qenë e padefinuar mirë, mendojmë se në vitin 2022 kemi bërë një përmirësim dhe tash ajo zonë hyn në kategorinë 200 euro. Realisht, në qoftë se e llogaritim në bazë të koeficientit që ju si delegatë e kemi votuar, na e kemi ulur koeficientin e pagesës nga 0.17% në 0.15%. Dhe kjo ka afektuar që në komunën tonë të kemi në një kategori ulje nga 17 euro në 100 metër katror në 13.50. Dhe mendojmë se çfarëdo vendimi që të marrë qeveria, ju e dini që po diskutohet për tatimin në pronë, rezultatet në komunën tonë nuk ndryshojnë. Prandaj, qytetarët e komunës sonë, falë këtij Kuvendi, falë angazhimit të qeverisë komunale, nuk janë të afektuar nga këto vlerësime sikur në komunat tjera. Pos sektorit të tatimit në pronë, gjithashtu ne kemi edhe njësinë e thesarit, ku në kuadër të kësaj themë bjer regjistrimi i pasurisë komunale. Një e gjetur kryesore ka qenë mungesa e regjistrave të inventarit të komunës, po për fat të mirë, gjatë këtij viti kemi kryer procesin e inventarizimit të gjithë pronës komunale, si në sektorin e shëndetësisë, të arsimit, po gjithashtu edhe të komunës, dhe i kemi shtuar në një regjistër të përbashkët komunal, që për fat të keq për pesë vite ka qenë rekomandim dhe vërejtje nga auditori për Komunën e Dragashit. Kjo do të thotë se të gjitha këto rekomandime nga auditori afektojnë në grantin e performancës, ku në të shumtën e rasteve komuna jonë, në vend se të ketë përqindje më të lartë të grantit të performancës, e merr me një përqindje më të ulët dhe rangohet në kategoritë më të ulëta të komunës. Në mënyrë indirekte, të gjitha këto rezultate ndikojnë në grantin e performancës dhe grantin e performancës në mënyrë automatike i kthehet boomerang komunës. Në qoftë se tregojmë rezultat me rekomandimet e auditorit, grantin e performancës rritet. Prandaj, na mendojmë se gjatë këtij viti ia kemi arrit që t'i realizojmë këto. E më tej në komunë ka qenë mosparaqitja e regjistrave të borxhit të përgjithshëm të tatimit në pronë para datës 31/12. Në faqen e Komunës së Dragashit e kemi borxhin total të tatimit në pronë, të plasuar para datës 31/12. Gjithashtu, për herë të parë është paraqit, si e gjetur që është përmirësuar, është mosdhënia e regjistrave për pronat komunale. Para 31/12 në këtë Kuvend është miratuar regjistri i pronave të

përgjithshëm dhe të veçanta, e cila përsëri edhe kjo është në ëebfaqen e komunës. Përpos këtyre, ne kemi gjetur në situatë tek bizneset një të gjetur që ka ndikuar realisht në performancën komunale, është borxhi total i komunës që ka qenë mbi 2 milionë e 97 mijë euro. Falë angazhimit të sektorit të përgjithshëm të financave dhe drejtorisë, ne kemi arritur që gjatë këtij viti t'i shlyjmë borxhet e akumuluar që nga viti 2002 deri në vitin 2013 për bizneset dhe përfundimisht në vitin 2023 kemi marrë vendimin nga MF që ky veprim është i ligjshëm dhe brenda këtij muajii do të njoftohen të gjitha 1772 bizneset të cilat kanë qenë të ngarkuara me taksë komunale, se iu shlyhet ai borxh i akumuluar, dhe ky proces gjithashtu do të ndikojë në raportin e performancës, ku komuna do të jetë në nivel pak më të lartë. Pas kësaj, ne kemi kryer gjatë këtij viti edhe vendimin e Kuvendit Komunal, i cili ka qenë i vitit 2021, për grumbullimin e borxheve të pasurisë komunale, tokës dhe objekteve, që gjatë këtij viti, i kemi në pasqyra të detajuara për secilin biznes dhe sa janë realizuar këto të hyra dhe ky vendim. Dhe njëkohësisht këtij vendimi, në këtë Kuvend, në mënyrë unanime i është shtuar edhe në vit për implementim dhe realisht zgjidhjes së problemit të akumuluar për vite të tëra për një numër të konsiderueshëm të subjekteve ekonomike. Të gjitha këto veprime janë bërë në bashkëpunim me stafin, punëtorët dhe Kuvendin. Unë mendoj se edhe ata të cilët e kanë lexuar këtë raport, kanë mundësi ta kuptinë krejt këtë filozofi, qëllimi i përgjithshëm i punës tonë ka qenë dhe është që komuna jonë të i eliminojë të gjitha dukuritë negative të cilat kanë ndikuar në uljen e performancës dhe na kanë kushtuar si e hyrë komunale nga granti i përgjithshëm, njëkohësisht edhe nga granti i performancës.

Uran Halimi: Faleminderit z.Kolloni! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën lidhur me raportin e drejtorit për Ekonomi? Nëse jo, atëherë në radhë e kemi Drejtorinë për Shërbime Publike. Ftoj drejtorin që ta marrë fjalën.

Nuhija Tairovci: Të nderuar Kruesues, Kryetar, të nderuar deputetë. Drejtoria jonë gjatë vitit të kaluar i ka koordinuar aktivitetet e saj me planet e mëparshme, kështu që unë do të kaloj shkurtimisht atë që keni pasur mundësinë të lexoni në materialin tuaj. Drejtoria është e përfshirë në punën e stafit të komunës, ku do të fillojë në mënyrë kronologjike, si dhe komisioni i sigurisë dhe komunitetit, dhe me këtë rast ne marrim pjesë aktive në çdo problem dhe japim kontributin tonë, unë jam i përfshirë drejtpërdrejt aty dhe në çdo mënyrë e mundshme kur lindin probleme të caktuara jap kontributin tim d.m.th ne, si drejtori, paraqesim atë që bëjmë dhe çfarë mund të bëjmë në atë kontekst. Në kuadër të kompetencave, komunikimi me KFOR-in ka vazhduar për çështje të rëndësishme, shpesh pyesin për projekte të ndryshme, kur them KFOR-in sigurisht e kam parasysh LMT-në që është këtu dhe CIMIK-un nga të gjitha komunat me të cilat komunikon, e mbi të gjitha italianin. CIMIK, e cila është mjaft e pranishme këtu dhe e cila bashkë me LMT-në bashkëpunon mjaft intensivisht me ne. Në kuadër të drejtorisë sonë funksionon edhe komisioni për vlerësimin e dëmeve, kështu që këtë vit kemi pasur 17 kërkesa dhe 17 dalje për vlerësimin e dëmeve për ata që janë dëmtuar në çfarëdo mënyrë nga zjarri, shiu etj. Gjatë vitit 2022, komuna jonë dhe drejtoria së bashku bënë një përparim të madh në çështjen e Ekorajonit, së bashku me JICA-n përmes projektit për përmirësimin e kapaciteteve të menaxhimit të mbetjeve drejt një shoqërie të shëndetshme, faza 2 dhe 4 pilot projekte, në mënyrë që Ekorajoni mori një deponi cilësore me kushte më normale,

për të mos thënë krejtësisht normale, e dimë që deri vonë deponi ishte një vend klasik ku sapo hidheshin mbeturinat, d.m.th. kamioni shkarkon pa asnjë trajtim dhe sot me punën e drejtorisë sigurohen buldozerë, peshore në vendgrumbullimin e mbetjeve dhe mbajtjen e mëtejshme të statistikave të sasisë së mbetjeve të prodhuara nga komuna jonë. Komuna ka bërë edhe kullimin e ujit, i cili u krijua nga ndërtimi i deponi shumë kohë më parë në vitin 2004, në mënyrë që ujërat e zeza që derdhen në vendgrumbullim të mos hyjnë në natyrë dhe të mos ndotin mjedisin dhe të mos transmetojnë dëme. efekte në zonat përreth, kështu që ka një lagunë, një mini-liqen dhe është bërë kullimi vitin e kaluar dhe uji që rrjedh tani është kulluar dhe ka çuar në atë liqen dhe përmes avullimit shkon më tej. Kjo shkallë që përmenda do të jetë domethënëse edhe në konceptin që ne nga Restelica e kemi EkoRestelicën, e cila e ka pastruar tërësisht Restelicën me kamionin e vet dhe me përpjekjet e veta, dhe me kamionin e tyre sjell mbeturina në deponi dhe me atë rast paguajnë sot. sipas kapacitetit të atij kamioni dhe nesër me kusht do të paguhet në bazë të peshës së mbetjeve, dhe rolin kryesor do ta ketë një peshore që do të shërbejë për këtë qëllim. Gjatë vitit të kaluar, me një projekt, bëmë fidane pishë, si të thuash, rrethuan landfillin në mënyrë që të mungonte ajo pak mbeturina që nuk trajtohej, që era të mos i bartte në pyjet përreth, në perspektivë. Unë supozoj se është më mirë, dhe ju që kaloni atje çdo ditë mund të shihni se ka ende shumë plehra në pyjet e afërta, gjithçka që ishte çanta dhe papirus të lehta u mor nga era. Së bashku me GIZ dhe JICA kemi analizuar të gjithë problemin me deponitë e zeza në komunën tonë, janë rreth 100 të tilla, herë më shumë, herë më pak, disa prej tyre pastrohen herë pas here, treguesi i këtyre deponive të zeza, d.m.th. janë, për mendimin tim, arsyeja themelore e mos mbulimit të pastrimit të të gjitha fshatrave të komunës sonë, kemi ende 8 fshatra që nuk janë pastruar dhe mungesën e një landfilli që do të trajtonte mbetjet e mëdha dhe të ngurta. Mbetjet e mëdha përfshijnë lloje të ndryshme mobiljesh dhe mbetjet e ngurta janë mbetje ndërtimi nga prishja dhe gërmimet. Tani për tani, e gjithë kjo është e pakontrolluar dhe ku ka shumë pak mbetje të ngurta, mbetjet e përditshme grumbullohen shumë shpejt, veçanërisht në fshatrat që nuk janë pjesë e sistemit të menaxhimit të mbetjeve. Së bashku me JICA-n, ne kemi prezantuar në dy shkolla, një në Gora dhe një në Opoje, si një projekt pilot për edukimin e fëmijëve për përzgjedhjen dhe riciklimin e mbetjeve, në mënyrë që këtu të përfshihen tapa plastike që mund të riciklohen, shishe qelqi, letra etj. të ngrihet dhe të transferohet në shkolla të tjera. Komuna e Dragashit është e vetmja komunë në rajonin tonë që ka deponinë e saj, kështu që ka më shumë obligime që të punojë në mirëmbajtjen e kësaj deponie dhe në këtë kontekst është në vazhdim e sipër projekti i elektrifikimit, furnizimit me energji elektrike, sepse edhe sot e kësaj dite peshorja për të cilën po flas që kemi dhënë nuk është në funksion, për arsye se mund të ndodhe ndonjë demtim me njesinë dhe prodhuesit nuk garantojnë asgjë nëse nuk lidhet rregullisht me rrjetin elektrik. Pra, faza e parë e këtij projekti ka përfunduar, gjatë këtij viti do të përfundojë edhe faza e dytë, kështu që do të mundohemi që deponia të jetë plotësisht funksionale. Gjatë vitit të kaluar kemi zgjidhur problemin e kanalizimit në disa vendbanime, ka pasur kërkesa në disa fshatra ku ka pasur bllokim të pusetave apo ndonjë lloj tjetër bllokimi, kryesisht e kemi bërë nga drejtoria jonë dhe nga korniza e aktiviteteve. Riparua rrugën ndërmjet Krushevës dhe Zli Potokut, e cila ende nuk ka përfunduar dhe për shkak të reshjeve të shumta, rrezikohej të mos lëshohej siç duhet. Më duhet të përmend se brenda drejtorisë kemi pasur 52

